

BIBLIOTEKA  
SH 32  
A 64  
SHETETI  
JIROKASTER



SOTIR TH. ANDONI

KUR  
ERRNIM FLUTURIM...



THE NATIONAL ARCHIVES  
COLLEGE PARK, MARYLAND  
20540

1967

## LEGJENDA E UJIT

Shat i madh e i plotë ky Shavari i Poshtëm: fushën e ka të gjërë, arat me tokë tul, vreshtat në dherat kundrejt diellit, pllajajat me lajthishte, përrenjtë me thana, kurse tashti vonë i përmyti kodrat me fidane e drurë molle, por... ç'e do, ujë për vaditje ka, për të pirë s'ka!

Devolli i gjërë, që i kalon fushës, me ato ujëra të shumta, ja bën me sy e sikur i thotë: «Për të pirë, o Shavar i Poshtëm, për të pirë dhe për të larë faqet, ja ku është tutje, në mal, ai kroi i Çobanëve, që gurgullon gjithë zulmë e shkumë. Në ke burra, o Shavar, në ke burra e djem e në ua mban, rrëmbeni kazmat e bëni për-pjetë!».

Keq e kanë njerëzia, sidomos në të korrat, kur djersa kullon si çurkë dhe dielli djeg si saç, vështirë e kanë për një pikë ujë të ftohët e të lehtë. Por të keqen e ndjejnë edhe më fort në shtëpi, kur vjen miku nga larg e kërkon «një gotë ujë». Psherëtitjnë këto nuset e zenë në gojë dhallën e bardhë të mtisë, verën e kuqe të zam-

zanes, qumështin e gavetës apo kosin e poçes së madhe... por më kot, miku kërkon ujë, pa të jetë si të jetë».

Dhe e sjellin me gjysmë zemre atë që nudothet, por duke mërmëruar:

— Ujë i thëncin, katran është, po ç't'i bësh...?

Miku e pi se është i lodhur e s'thotë gjysmë fjale, por i zoti e di ku i pikon shtëpia. Fillojnë spiegimet e kuvendimet, historitë dhe tregimet.

— Një pus të vetëm kemi në fshat, sekush e quajti egjyptian dhe ashtu i mbeti. Punon me një krah të madh druri e me një katrovë në majë të krahut; një pus për dyqind e sa shtëpi. Ujin e ka si të zjerë, të trashë si vaj, të bardhë si bozë nga gëlqerja, kur e pi të urgus; për të larë... gratë e dinë, është për fytyrën si zhur. Le halli i çupave, kush i dëgjon ato. Tashti vonë zunë sjellin ujë nga mali, nëpër shishe, për të larë faqet.

— Jaaa! Çudi!

— Dimrit e kemi keq me gjënë e gjallë. T'i shpiesh gjer në lumë nëpër dëborë është e pamundur, dëmtohen ato të imtat; kështu dalin barrinjtë e stallave me dhentë përpara dhe me kopanët e plisave në krah. Me kopanët thyejnë akujt e llokaçeve, sepse në një postaf të vetëm nuk i gazit dot gjithë bagëtinë, sidomos na dështojnë delet. S'është ujë ky, shafran është, po ç't'i bësh!

Dhe këto bisedime në Shavar të Poshtëm. për breza me radhë, kanë mbaruar me një «ç't'i bësh!».

Tregojnë pleqtë e betohen se po kështu e kanë dëgjuar nga ata më pleqtë, se qindra vjet me radhë, njerëzia në Shavar të Poshtëm, e kanë vrarë mëndjen për brengën e ujit, kanë çallëstisur se Shavari duket në mes të fushës e përmbi të shquhet që atje tej, si sqep i një përbindëshi, ai krahu i madh e i drunjtë i pusit egjiptian.

Ja, gjallë është edhe sot e kësaj dite Bido Çili. Gjithë jetën e tij ai është përpjekur për të sjellë ujë të mirë në fshat. Tashti i ka kaluar të njëqind vjetët, ka mbetur i verbër, që kur ishte shtatëdhjetë, por s'ka ndër mënd të vdesë.

Dhe aq gjatë tregohet historia e ujërave aty, në Shavar të Poshtëm, sa vetë Bido Çili e mbyll kështu:

— Ç'e pyet more bir? Përrallë arapi!

Përrallë arapi sot e përrallë arapi mot, gjer-sa këta të rinjtë që erdhën vonë, i vunë një emër tjetër.

Si u rrit e u zgjerua Shavari, domosdo edhe shkolla zgjeroi kthinat e hodhi një kat të ri për sipër. Në fillim, mësonjësit ishin të ardhur, «jambaxhinj» i quante Bidua, por tashti ata ose më mirë ato, që japin mësim, janë të gjitha shavarese. Se kështu e solli koha: gratë po ua rrëmbejnë këto punë burrave edhe andej nga Shavari dhe u thonë açik atyre, herë me shaka e herë me të vërtetë:

— Ju o djema, ju o burra merrni nga një lelek të madh, merrni edhe nga një pallamare<sup>1)</sup>

---

1) Lelek e pallamare = drapër i madh dhe një vegël druri, që ndih për të korrur.

më të madhe, dhe, o burra, në fushë se atje ka për të korrur, jo shaka!

Dhe ja, kështu, këto shavareset, përrallën e arapit tashti na e quajnë «Legjenda e Ujit». Legjenda e ujit në Shavar ka qindra vjet me radhë...

Kështu u flasin nxënësve në shkollë.

Dhe si e thamë fjalën «me sot e mot», edhe vullja e kohës së babaqemos s'do mbetej përgjithnjë.

Aty tërviti u kthye nga ushtria në Shavar të Poshtëm, Qemal Çili. Kur shkoi s'i pat dalë mustaku, tashti ka një mjekër të dendur e të fortë sa mezi i kalon brisku, edhe kur është prej atyre më të mirëve. Dhe se, si e thotë fjala, dardha bie nën dardhë, edhe Qemali i ri filloi të ecë në rrugën, që patën shkelur shumë burra të shtëpisë së tij. I ati jo, se ai kish ikur i ri, por i gjyshi që, sikurse thamë, ishte i verbër dhe e mbante mjekrën një pëllëmbë. Dhe thonë në fshat (po hyre në të thellat e po e zure mik ai të thotë vetë) thonë se Bido Çili e ka lënë mjekrën për punën e çezmave, si punë zije. Si e qysh do ta spiegojmë kur t'i vijë radha. Ka të tjerë, që e ngasin e duan ta nxjerrin se, vallaha, xha Bidua na paska lëshuar mjekrën që kur i vdiq e shoqja. Jo, besa! Të këtilla gjepura mos i besoni.

Bido Çili tregon ngjarje të lashta për punën e çezmave. Tregon e ze në gojë një aga të pasur shumë atje në Shavar, që kishte ngulur këmbë për-jo-, sepse do t'i shkonin sulinarët në-

për vreshtat. Rrëfen për një tjetër efendi, që deshi të çajnë kanalet të tjerët e ai të mbante sehir; tregon për një bej, që i vërtiti punët vjete e vjete me radhë, gjersa i hëngri paret e mbledhura nga fshati.

Bido Çili tregon edhe një rast të tillë:

«Një herë më ra në kokë një mëndje e mirë: Gjumi s'më zu dhe i shkoj herët në mëngjes Reshat beut: Bej efendi, të falem e të uroj ditën e mbarë, por sonte m'u kujtua që për punën e çezmave...

«Beu më dëgjoi gjer në fund e, pasi mbarova, këceu përpjetë e përpoqi duart. Unë u gëzuash, se e pashë që edhe atij i pëlqeu mëndja ime, por... ma ktheu duke psherëtitur:

«Bobo, gjynah o Bido, gjynah o lumëmadh, gjynah o fukara, gjynah. Ja, mëndje e mirë, e ndritur, e drejtë, po... punë që s'bëhet, vajti fir. — Po pse s'bëhet, o bej? — pyes unë. — Po s'bëhet o qyqar, — ma ktheu ai, — s'bëhet sepse e the ti. Do thonë në fshat se kjo punë u bë, sepse i shkoi ndër mënd Bidos. Ç'më mbetet mua pastaj?».

Ka qënë një kohë, jo më shumë se tridhjetë vjet të shkuara, kur fshati e kishte mbushur mëndjen top që ta sillnin ujin e kroit të Çobenëve, pa «të dalë ku të dalë». Bile ja patën nisur me të hapur kanale, ja patën filluar me të pjekur qyngje, patën zënë me të afruar gurë. E keqja ishte veç te Guri Vakëf. Jo vetëm se atje kishte shkëmbinj që s'dëgjonin fare as nga varreja, as nga qysqija, por sepse: Vend vakëf! e njeri s'afrohej. Dhe nga që shkëmbi ishte shumë i madh, atje mund të thërrisnje e oshëtima ta

kthente zërin prapë. Por Bido Çili, sado besimtar, e pati pleqësuar punën ndryshe: Ne ndonjë të keqe s'bëjmë. Kur të gurgullojë uji këtu, edhe vakëfit, edhe zotit do t'i bëhet qejfi.

Dhe Bidua vetë kishte qënë ai, që kishte futur llokumet e dinamitit nëpër brimat, që hapte vetë me qysqi. Por një fërnellë, dy, tri e dhjetë, kur arritën aty nga e njëzeta, nga gazi, nga nxitimi e nga padituria... plasi një minë fare afër dhe ja rrëmbeu Bidos dritën e syve. Fshati ishte trembur nga hieja e vakëfit. Më kot kishte thirrur Bidua vjete me radhë që ta vazhdonin punën, më kot kishte zënë be e rrufe se ishte nxituar. Ja, që atëhere, nga humbja e dritës së syve dhe nga dëshpërimi, Bido Çili lëshoi mjekër e mbeti në të errët për gjithë jetën. Kështu u mbyll atëhere ai gëzim i Shavarit të Poshtëm, ashtu si kanalet u mbyllën vetiu, se u gremisën dhe i sheshoi koha.

Por koha ndryshoi. Kur u kthye Qemali nga ushtria... Këtu e thamë një herë, kur zumë në gojë dardhën që bie nën dardhë.

Pra, u ngrit tashti Qemali me shokë e shoqe dhe atje në mbledhje të rinisë e vendosën me fjalë burri e me forcë djali që, së pari, ta bëjnë shesh atë Gurin Vakëf e t'i japin të kuptojë pleqërisë se sa para i bën lëkura atij Gurit Vakëf!

— Do ta shkatërrojmë me llokum domosdo, se kur ke mashën pse të djegësh dorën?!

Qemali me nja dy shoqe shkuan te komandanti i repartit të ushtrisë aty më poshtë dhe iu lutën për çka u duhej. Nuk ua prishi komandanti dhe u dha dinamit, u dha fitil, kapsollë.



Sa për zanatin, jo më kot Qemali. kish punuar dy vjet në ushtri me dinamite e me fitila. Se Qemali s'ishte gjyshi Abedin.

Po sido që flasim kështu, Qemali me shokë e shoqe, para se të nisnin nga puna, një mbrëmjeherë i shkuan xha Bidos për ta dëgjuar e për t'i marrë një mëndje. Ai i prit, i dëgjoi, u gëzua, por u tha: — Ta dini, t'i kemi fjalët përpara, është vështirë; duhet zemër, punë, krahë, duhen qyngje, duhen edhe para...

— Jo, babagjysh, s'ka ç'na duhen paratë, ne të gjitha do t'i bëjmë vetë, ja me këta krahë.

— Unë s'ua shoh krahët, biro, se jam i verbër, por e marr me mënd që i kini të fortë, se të rinj jini. Hapni sytë mos turpërohi, duhet punë dhe duhen para.

— Ta thamë babagjysh, paratë s'na duhen.

— Duhet, mor djema, duhen mojt vajza, se si i thonë fjalës: paraja e ngre ujin përpjetë. Ja! Ku do ta gjeni dinamitin, fitilin?

— Ato i gjetëm babagjysh. Po kur ta sjellim ujin ç'do thuash?

— Do t'u uroj, biro, do t'u uroj e do vij të laj fytyrën me ujën e kroit të Çobanëve. Kam shpresë se do më hapen sytë edhe një herë; por nxitohi, se sot jam e nesër s'jam...

\* \* \*

Në tre fronte filloi puna e çezmave. Një palë punonin kanalet, një palë shkuan në qeramidhanë për të gatuar e pjekur qyngje, kurse te Guri Vakkëf punonte vetë Qemali me pak shokë e shoqe.

Tri ditë e tre net ka gjëmuar gryka atje te Guri Vakëf. U tund jo vetëm gryka, jo vetëm Shavari i Poshtëm dhe ai i Lartmi, por edhe mali vetë. Dhe Bido Çili, kur dëgjonte ato shungullima, mbante dorën në zemër dhe qante nga gëzimi:

— Hej, u vajtët mbarë!

— Hej, sa më gëzohet zemra!

— Hej, sa zili ua kam!

Si u shkatërrua Guri dhe u bë cifla cifla, atje te gryka mund të thërrisnje sa të të hante në kokë, por oshëtima më s'ta kthente zërin. Por sado që fërnellat bënë punën e tyre dhe hapën rrugën, duhej akoma punë me krahë për të shkukur ata gurët, që kishin mbetur anës, si dhëmbë të këqinj.

Atëhere mund ta shihnje Qemalin çfarë djali ishte, veshur me një palë pantallona të shkurtëra në trup dhe me ata krahë (eh, çfarë krahësh) me gjoks prej divi e me shpatulla një pashë të gjëra. Djersa i shkonte çurkë e ai hap e ngre ata krahë me varë nër duar, bjeri e bot këtyre gurëve, si në gjë të hasmit. Çupat, që punonin aty afër, kur e shihnin atje lart, ashtu, tërë forcë e burrëri, tërë zulmë e djalëri, diç pëshpërisnin kokë më kokë.

Në këtë vërsulje për të shuar legjendën e ujit, u lëshua gjithë fshati, të vegjël e të mëdhenj. Po me që pyll pa derr s'ka, kështu ndodhet në Shavar edhe një Shaqo, Shaqo Tershi. Shaqo individi e thërresin, se ky ka bërë hyqme e rri mënjane me ato pak dynmë, me lopën, gomarin e hiç tjetër gjë.

Pra, ky Shaqo Tershi ndënji mënjane edhe në punën e çezmave. Bile, thoshte se edhe kjo vër-

sulje do të hynte në përrallën e arapit. Kur kër-  
ciste kazma kanaleve, Shaqua me gomarin shkone-  
te në mal për dru; nisej natën e kur kthehej hidh-  
te badjava ca «puna mbarë» përpjetë e tatëpjetë.  
Po kur arrinte te Guri Vakëf, Shaqos i hante në  
gjuhë po të mos lëshontë ca romuze:

— O Qemal ooo, po të paskan futur çupat në  
stllok ooo! 1)

— O Qemal ooo, atje te shkëmbi do lësh dja-  
lërinë, ooo!

Po Qemali me shokë s'ja zgjatnin e s'i flisnin  
fare dhe vetiu del fjala: «Po unë përse t'ja zgjat e  
të merrem me të?»

E rëndë ka qënë puna atje, në Shavar të  
Poshtëm, për të sjellë ujin në fshat. E vështirë  
dhe e gjatë, afro njëqind e ca ditë, por ditë behari  
nga të mëdhatë.

Por më në fund ai kanali i madh, i gjatë tre  
sahat rrugë, u ndër e gjarpëroi pyjeve, pllajave,  
livadheve, grykave e gjer në Shavar të Poshtëm.  
Kur kanalit ja shtruan qyngjet prej argjili të pje-  
kur punë e madhe, kur qyngjeve u lëshuan ujin  
dhe ky i njomi sulinarët, atëhere veç ta shihnje  
që nga maj' e malit, veç ta shihnje që nga kroi i  
Çobenëve atë ujësjellësin... Dukej si një damar  
i kuq, si një damar i gjallë, që rrihte nga ngulçi-  
met e gurgullimat e ujit.

Festë të madhe kanë bërë kësaj vjeshte në  
Shavar të Poshtëm! U tund fshati që nga theme-  
let e gëzoheshin njerëzia, kur shihnin sulinarët,

---

1) stllok-u = Kur kaut më të fuqishëm ja vendosin  
më afër kularin e zgjedhës.

që gumëzhinin e shkumbëzonin atë ujin e ftohët e të lehtë të kroit të malit.

Disa nga vajzat shkuan dhe e morën Bido Çilin pas dore. E shpunë në çezmën e mesit. Ai ecte duke kërkuar rrugën me majën e shkopit. Njerëzia mbanin mend se ai pat thënë: «Po ta sjellin ujin e malit, do pi e do lahem me të dhe do më vijë drita e syve!»

E afruan te postafi, ai u ul në të, shkopin e flaku tej.

Pas gurgullimës vetë e gjeti sulinarin. Vuri gojën dhe piu ujë me gllënka të mëdha, piu me zhurmë e potere, si ai kali kur del nga vrahu. Pastaj futi kokën nën sulinar, e hoqi, trazoi rrjedhën me dorë. E përkiste ujin sikur ishte i fortë e donte ta shtërngojë në pëllëmbë. Psherëtiu e u hoq mënjanë.

— U lumtë, o bij, u lumçin duart, moj çupa, U gëzova, por sytë s'm'u hapën. Veç ta dini, gazin tim ju s'mund ta kuptoni.

Nga sytë e verbër i kullonin lotët e i bashkeshin me bulëzat e ujit, nëpër mjekër.

## NËNKRYETAR NEXHIPI

**T**rupmadh e kokulur, Nexhip Kalaja kalonte anës arave me misër. Duart i mbante prapa, nër to kishte një porozhde që e kalonte si tespije. Fletët e gjelbra të misrit fëshfërinin nëpër mezhdat; bari i fashitur nga shiu, po ngrinte krye përsëri. Diku më lart, prapa tumbave me plepa, provonin tokën me shat, në ishte gati për të kryer mbushjen e vragjive me misër.

Shiu pat rënë që një ditë më parë, por era e teri tokën; balta nisi të thahet, në rrugë u punua dhe u ngjesh mëngjesit nga kalimi i grigjës dhe tashti i ngjiste brumit të mbrujtur.

Duke baritur, Nexhipi solli dorën mbi fytyrë, e përshkoi si erashkë njëherë, dy, tri. Më kot. Një tufë mushica, grumbull dhe nxituar i endeshin mbi ballë, fluturonin bashkë me ecjen e tij, nuk i ndaheshin, por e mërzitnin. Gjoksi i tij, i madh e leshtor përjashta, jehoi përbrënda si një guvë shkëmbi. Mushicat u davaritën nga çvendosja e ajrit e përsëri, si e kanë zakon, iu turrën njeriut, në ballë të tij, përmbi frymën e tij.

Nexhip Kalaja shkante në mbledhje.

Ai është një plak shtatëdhjetë e sa vjeç, por

njeri nuk i jep aq. Ka trup të fortë e të lidhur, prej fshatari, mustakë të thinjur, zverdhur rreth gojës, një qeleshe që dikur do të ketë qënë e bardhë, dhe ecën me një çap të rëndë e gati të rreptë.

Djali i vetëm iu vra në luftë, plaka lëngoi nga humbja e tij, shkoi edhe ajo këtu e njëzet vjet më parë, por «djali la prapa Nefon që tashti është afër të njëzetave, Zenin, që punon si agromonom asaj Tirane dhe të shoqen, nënën e fëmijëve, Havanë, që tashti merret me shtëpinë.»

Që ditën që fshati bashkoi tokat dhe gjënë e gjallë, Nexhip Kalaja u zgjodh kryetar. Por kaluan vjete, katër katundet e afërme u mblodhën në një ekonomi dhe Nexhipi mbeti nënkryetar në sektorin e vet.

Sot, ai nuk po shkon me qejf në mbledhje. Ai e di mirë se shokët e tij në kryesi do të fillojnë në përsëri si e kanë zakon: «Ç'janë këto që bën, shoku Nexhip? Ku more lejë e kush të tha? Përse nuk e shtron çështjen në kryesi, po punon sipas kokës...» Ai është në sherr me kryetarin, në grindje me nënkryetarët, me llogaritarin pëllëmbë e tym. Dhe s'mbahet mënd kur e përse plasi sherri, ashtu sikurse nuk i dihet fundi llaçimit a rrënja ferrës.

«...Ah, po e di unë. Ata flasin kundër meje poshtë e lart, shpojnë e rëmojnë, bëjnë tevaturë të paqëna, çupat në prashitjet, gratë në çezmë, kalamajtë çaireve, ata miqtë te klubi, bile një çunak më thirri një ditë që prapa ferrave: «Zbritja kalit, o Nexhip!» Hej, bela, hej!

Xha Nexhipi hyri në fshatin e qendrës, u hodhi një «njatjeta» disa shokëve të vet atje te

trari. Shokë të tij vetëm në moshë, sepse këta kanë kohë që i la dora dhe tashti ngrohen në diell, duke fërkuar këmbët që nisin t'u fryhen. Gratë, që ishin në çezmë, Nexhipi bëri sikur s'i vu re e bëri përpjetë. Arriti një qerre të ngarkuar me jonxhë. Ai i qerres u hodh nga ana tjetër e rrugës, por nënkryetari iu kanos:

— E mbyte kaun, or u mbytsht lugat, tevlig është ai...

Djali s'u përgjegj, por ja ngjeshi Çalos me hosten; kau këceu e vrungulloi, rrota u përplas te guri, boshti u thye, qerrja vaisi. Kundërmoi katran. Nexhipi hyri në kryesi, dha «njatjetën» e shkoi te dritarja. Nuk desh të hapte fjalë me shokët dhe nisi të vështrojë nga dritarja, tutje në oborr të stallave. Andej dikush po thurte një vërzomë; stallierët ndanin një çark për viçokët; një murator kishte hypur në pullaz dhe ndërronte qeramidhet, i ngrinte, i qëllonte një për një me majën e gishtit, u dëgjonte tingullin dhe pastaj i vendoste. Dikush çeli një koçek. U derdhën këtej një tufë me derkuca, duke tërfëlluar e kërritur. Nexhipi u kollit dhe i ktheu shpinën dritares.

Në kryesi kishin hyrë plot njerëz. Disa ankoheshin, të tjerë tregonin kushedi se çfarë, njëri mbante nër duar një panxhar tepër të madh e lëvdohej me të... kurse Nexhipit ja kishte qejfi të vinin sa më shumë njerëz e të ankoheshin, të bërtisnin të kërkonin.

— Sivaku m'u shtri në ugar, duhet tagji më shumë!

— S'bëhet punë te kanali, më shumë bletë meshkuj, se...

Nexhipi qëndronte hypur në sofat të dritares, kishte ngjeshur supin pas murit dhe rrinte hundë e buzë bashkë. Afër kishte Safien, anëtare të kryesisë, që kish ardhur me çorape në dorë. Nexhipi e shihte me inat gjithë atë Safie të madhe e të ashpër, që për hiç mos gjë të fuste në fund të dheut me fjalë e kanosje. Por më në fund filloi mbledhja. Shqyrtoheshin lutje. Kryetari i lexonte, por e ndërprisnin; dikush hynte dhe kërkonte një firmë, dikush nxirrte kryet te dera dhe kthehej prapa. Më në fund lutjet u mbaruan, të gjithë lëvizën nga vendi dhe vështruan nga Nexhip Kalaja. Vetëm Safia shihte punën e nisur e tundte e shkundte çorapin, duke e vështruar nëpër syzet e varura në mes të hundës. Kryetari u grrit dhe fërkoi një çast gushën e vet:

«— Shoku Nexhip, e gjithë kryesia e kooperativës nuk ka se si ta shpjegojë sjelljen tënde. Serveti mbaroi në Tiranë kursin për bletët, bletët i kemi në sektorin tënd, ti nuk e pranon të vijë atje teknikun e ri...».

Bishti i çibukut kërciti nër dhëmbët e Nexhipit dhe u tund si një pizgë gajde, ai i mbante sytë ngulur te Safia. Kësaj i shkau një buzëqeshje dhe plaku nuk ja përtoi:

— Ti moj, përse zbardh dhëmbët? Për çorap ke ardhur këtu apo...?

Ajo nuk e gjeti me vënd të përfytej me Nexhipin, por i dha një vështrim paralajmërimi, u kërrus, kapi lëmshin në dysHEME dhe e vendosi në pëqi.

— Që ta merrni vesh të gjithë, ja ku ju



them vetë. Unë Servetin nuk e qas në sektor e mbaroi!

Ai futi sërish çibukun në gojë dhe kuspullo-si buzët rreth tij.

— Këtë që thatë ju, shoku Nexhip, ne e kemi të qartë, këtë e dinim, por kryesia kërkon të dijë shkakun, arësyeën. Nëqoftëse Serveti ka ndonjë faj, ne e qortojmë; pastaj ai - edhe ju argëton, i bie edhe fisarmonikës.

— Nuk e qas dhe mbaroi!

Gjer këtu fjalët shkuan shtruar, por fjala fjalës, ujët mori uthull, zërat u ngritën, gjëmoi pëllëmba e Nexhipit përmbi një bankë. Në oborr e lanë boshtin e qerres, mënjanuan plorin e demalugut, magazinieri doli tek praku i magazinës dhe futi lapsin midis tëmthit dhe kapeles.

— Ç'djall kanë kështu?

Nëpër xhamin e thyer të kryesisë doli një gulsh pluhur si re byku, u përplas një kënatë, pastaj një tjetër, u rrëzuan leskra gëlqereje, gjersa nga praku u vërsul Nexhipi fytyrë-egërsuar, kokë-zbuluar. Pas e ndiqte kryetari me qeleshën e plakut në dorë.

— Dale, Xha Nexhip, të merremi vesh, xhanëm, dale...

Të dy burrat qëndruan te praku, sy më sy, hundë më hundë.

— Ta dish, ajo s'bëhet, ai të mbledhë bish-tin e të qethë flokët, përndryshe...

— More Nexhip...

— Përndryshe sikur dhëmbin sa të kalit ta bësh...

I rrëmbeu kryetarit qeleshën nga dora dhe bëri tatëpjetë.

Në kryesi biseda vijoi:

— Të jetë ngatërruar Serveti me Nefon?

— S'është çudi, gjëra që ngjasin.

— Sidoqoftë, Nexhipi nuk ka të drejtë. Ç'i duhet ekonomisë sonë se mbesa e Nexhipit me djalin e Dalipit... ohuuuu!!!!

Plaku s'e mbajti çapin gjëkund. Iu lut Merua atje te klubi, e kapi edhe për krahu të kthehej sa për një kupë e një shëndet, por Nexhipi ishte i egër si ari dhe nuk dëgjonte.

— Lermë, se s'ja kam vaktin!

Dielli ishte më të perënduar. Nexhipi doli nga fshati i qëndrës, por ato djall mushica si ta kishin bërë me fjalë, e kapën mu te ura e iu qepën pas.

«Hë qeni, i biri i qenit! Ç't'i bëj se ma ka fajin ime mbesë, e ka fajin ajo bushtër, që e ndjell, pa ja ndreq samarin unë. Ptua, jazëk i qoftë! Ama ajo e do një dru të shëndoshë, por hajde e dëgjo t'ëmën pastaj, mbaja gojën fshatit. Të mblidhen hallet në pleqëri. Të kisha këtu tim nip, ai mund t'ja mblidhte së motrës. Unë s'i flas dot aq, po i thashë do më priset gjaku dhe do të kërcasë kopaça. Më s'kam nderin e parë. Nuk më përfillin. Se ku i gjejnë ca fjalë, ca marifete, ca thash e theme. Sidoqoftë, nëse vjen Zeni agronom i kooperativës, edhe në qoftë shok me ta, por... s'mund të më hedhë poshtë mua. Krahu do ta kem. Kur nisnin nga qortimet ata të qytetit, me ca fjalë tjetër soj, s'u jap dot përgjigje e shkoi e vate, edhe rrëmbehem për dreq!»

Kaluan disa muaj dhe Zeni erdhi për gjithnjë. Plaku priti miq edhe urime ditë me radhë; e tepëroi duke ngritur kupa dhe dolli dhe në krye të javës u sëmur. Tashti qëndronte mbyllur në odën e tij dhe pinte kupë pas kupe, çaj me mustakë misri. Nuk i qëndrohej brenda, mend çahej nën lëkurën e vet, por halli që e zuri kaq pa prituri nuk i jepte dorë të dalë përjashta. Shtrihej mbi minder dhe zgjatte kokën nga dritarja. Në oborrin e madh Zeni shartonte bisqet e mollëve, pas e ndiqte e motra me disa fletëza në duar.

«Shartim me fletë, andej do ta ketë mësuar.»

E motra ishte gjithë gaz, qeshte e kukuriste pas të vëllait.

«Hë, pelë e djallit! Çudi, sa shumë u rrit ky djalë! Ka ngjarë në xhinsin tonë; nga e ëma janë rondokopë dhe të trashë, por gjakun e ka që andej; i butë si grua, ka shkurtuar muhabetin, mer librin nër duar dhe hajde ja shqit po deshe. Po a thua që ky të mos e dijë fillin e së motrës? Iu bënë dy javë në shtëpi... Ma ka fajin ai lart: të kisha gjallë djalin, nuk ngjisnin këto në shtëpinë time. Po a bën t'i them gjë Zenit? E përse të mos bëjë? Ai është tamam burrë. Kur të vijë në mbrëmje do ta thërres këtu.»

Por u bënë tri ditë e tri netë që djali kthehej shumë vonë në shtëpi, drekën e hante në zëmërherë, kurse për gjumë vinte pas mesnate. Disa të huaj nga qyteti ndodheshin në fshat, një «Gaz» qëndronte kaq ditë me radhë te porta e kryesisë. Një pasdite, Havaja po fshinte çardhakun, përpara odës së plakut. Pa prituri u dëgjü-

an çape të nxituara te shkallët. Dikush po ngjitej me një frymë e duke sokëllitur. Plaku u gjend qiri më këmbë, nuk e çeli derën, por vështroi nëpër plasaritjen e saj. Ishte Nefua, që i fliste s'ëmës. Zëri i saj ishte i drojtur dhe i gëzuar, ajo bënte çmos që zëri t'i delte sa më i pakët, por nuk e mbante dot. Plaku s'i shihte dot gratë, shihte veç kallëpët e kurorëve të misrit, por zëri i Nefos sikur kish të bëjë me shkëlqimin e artë të kokrrave të misrit. Ato kokrra shkëlqenin aq fort, aq shumë... Nexhipi vetë i kishte fërkuar, duke u mbledhur fijet e holla të mustakëve për hallin që e kish zënë. Plaku pa librat në dorë të vajzës, që ajo i shtërngoi pas gjoksit.

— Mama! Zenin e zgjodhën kryetar të te gjithë kooperativës!

Pa dashur, xha Nexhipi ja ngjeshi gjoksit me majën e mjekrës së vet. «Djallo punë, nipi kryetar, përmbi mua, hajde dhe e merr vesh tani!»

Në darkë, kur u shtrua sofrë, plaku uroi; dora i dridhej kur kapi lugën; ishte i mallëngjyer, por djali sillej sikur të mos kishte ngjarë asgjë e pazakontë.

— Në këtë gaz, o bir, më kujtohet yt atë, rahmet pastë, se helmi dhe gazi janë motër e vëlla; nderi t'u rritë gjithnjë, paç uratën time dhe të tyt eti, por çdo punë me mënd, çdo rrugë me krye. Unë sa isha s'jam, sa rrojta s'rroj, të më rrosh sa malet, o bir. Nuk di kush ma hoqi shkopin nga dora në këtë shtëpi, s'e di, mosha apo koha, ndofta të dyja bashkë, dhe... s'dua ta lë me kaqe.

Ai vështroi shkarazi Nefon. Ajo u bë lulekuq në fytyrë.

— Një herë, një djalë hidhte gurë në ferrat e një shtëpie. Ka ca kohë që po hedhin gurë natën në oborrin tonë...

Havasë i pikoi luga nga dora dhe fërkoj fy-tin me pëllëmbë.

— Dhe, që të kam fjalën ty djalë, ai miku hodhi edhe një natë gur e priti një plumb në ballë, këtë ta them që ta dish. Hajde, u gëdhifshi shëndoshë.

Ai u ngrit, kyçet e gjymtyrëve i kërcitën, gulçoi dhe u nis për në odën e vet.

Heshtje e thellë para sofrës, ku çorba nuk avullonte më. Havaja pandehte se erdhi ora që të hapej çështja një herë e mirë, por djali mbante librin para syve dhe shtihej sikur s'kish dëgjuar gjë. Mëmë Havaja e gjeti me vënd që të ngjitet lart «për t'i shtruar rrobat plakut». Kur doli e ëma, Zeni lëshoi librin nga dora dhe vështroi nga vatra:

— Motër!

Nga shqiptimi «motër» e jo «Nefo», ajo fërgëlloi:

— Unë nuk të kërkoj llogari, as të qortoj, por nëqoftëse edhe ti e gjen të arësyeshme, duhet të gjejmë një rrugë, që edhe plaku të mos mërzhitet, edhe ti...

— Epo ç'ti bëj plakut unë? Unë e Serveti, kur të vijë dita...

— Kuptoj, kuptoj, po përse të mënjanojmë këtu një farë fejese, një farë hyrëdalje? Mua kështu më duket edhe më thjeshtë, edhe më mirë...

— Kjo s'varet nga unë. Familja e Servetit kanë vajzën të pamartuar e s'duan. Ne po presim të lëshohet shtëpia e Fazlliut, është depo akoma, dhe pastaj...

— Po ti përse s'më ke folur mua për këto?

— Edhe ti po të ishe në vendin tim...

\* \* \*

Fusha jeton nën pluhurin, që davaritet lart. Ai merr udhë nën zinxhirat e hekurtë të traktorëve, ngjitet si fjollë apo si mullar, shkapërderdhet nëpër qiell. Poshtë ka ngjyrë bakri, pastaj bëhet i përhimtë, diku e qarkullon tymi mavi i naftit. Mëllënjat dhe gallofët e zinjtë ulen pas brazdave, duke ndjekur krimbat, që nxitohen t'i fshihen dritës dhe rrezikut.

Përsëri sot, në mbledhjen e kryesisë, parashohin grindje me Nexhip Kalanë. Zeni e ndjen më fort të keqen e një ballafaqimi me gjyshin, por detyra është detyrë dhe ai s'ka si e mënjanon këtë. Shtihet sikur ka punë me një tufë shkresash mbi tryezë e ja lë njërit nënkryetar drejtimin e mbledhjes.

Nënkryetar Nazifi ngrihet i menduar dhe flet ngadalë:

— Jemi mbledhur sot, shokë dhe shoqe, për të shqyrtuar dy kondravajtje të shokut Nexhip, i cili sikurse e dini, shokë dhe shoqe, në kundërshtim me vendimin e kryesisë, ka ndaluar traktoristin të çajë meranë në sektorin lart. Gjithashtu, shokë dhe shoqe, shoku Nexhip Kalaja e ka

kthyer në depo bërsish vatrën e kulturës në atë sektor, dhe...

Zverku i Nexhipit kishte marrë ngjyrën e gjakut dhe kupa e gjurit i tundej si prej ethesh. Por me gjithë këtë ai u ngrit dhe foli:

— Unë nuk lejova të çelet meraja, sepse u duhet fshatarëve të mi për kullotë; pastaj, ne kemi toka të tjera për të çelur. Për atë të kulturës, që thoni ju, unë vërtet e ktheva në depo, sepse gjithë ato bërsi nuk kisha nga t'i gazit. 1) Pastaj nuk është ndonjë punë e madhe që mbetnë keq ata që ja kanë ngenë e këndojnë e bërtasin gjithë natën si maluketër. Punë e madhe, ja, le të shkojnë andej nga rrëkëllehen breshkat dhe le të nxjerrin sytë...

Plaku u ul dhe nuk po dukej njeri të çohet për të folur. Vetëm Safia, anëtare e kryesisë, pomblidhte lëmshin, që i pat shkarë nën banka dhe, si e mblodhi mirë, ajo u ngrit:

— Nuk ma merr mëndja që meraja të jetë kursyer për kullotë. Meranë, more shokë, e kurseu Xha Nexhipi se është meraja e xhamisë, ja, kështu si ju them unë, këtu qëndron puna...

Nexhipi e ndërpreu:

— I lutem shumë Safies të mbajë gojën, dhe ju lutem shumë të gjithëve, të mos harroni se si i kam patur dhe si i kam unë punët me hoxhë Fazllinë. E mbani mend ngjarjen e bostaneve?...

Nexhipi fliste, por asnjëherë nuk i shtiu sytë atje ku qëndronte nipi i tij. Edhe Zenit i vinte zor të ngrerë sytë. Por të gjithë sa ishin atje,

---

1) gazit = rregulloj

prisnin qëndrimin që do të mbante kryetari. Ky e ndjente mirë këtë, e dinte se çështja e të gjyshit i ngjante tashti një plage, që ishte mahisur e mbushur për vjete me radhë. U ngrit. Por nuk mund të qëndronte atje ku ishte. Shtyu fronin dhe doli në mes të sallës. I gjyshi, si gjithnjë ulur në sofatin e dritares me çibuk në gojë, priste edhe ai me ankth mendimin e Zenit.

— Mua më duket, — filloi kryetari, — më duket se nënkryetari, shoku Nexhip, ndofta është nxituar pak në çështjen e merasë, unë jam i sigurtë... nëqoftëse ai e rishikon edhe një herë çështjen e merasë, vetë do ta thërresë traktoristin. Përsa i përket vatrës së kulturës, atë do ta zbrazim sa më parë nga bërsitë...

Safia, pa dashur të flasë apo të ngrihet, lëshoi një:

— ...Hë, më të lumtë ajo gojë!

Nexhipit s'iu durua dhe u ngrit.

— Do më kërkoni, po do mos më gjeni. Sa ja dua të mirën unë kooperativës sonë dhe ekonomisë sonë, nuk ja do njeri tjetër.

I tha këto dhe bëri të dalë. I nipi i preu rrugën dhe i vu duart mbi gjoks.

— Dale, baba! Pse nxitohesh? Dale!

— Jo, unë nuk nxitohem, nxitohi ju që kërkoni të mos më shihni përpara.

Zeni e ndaloi edhe një herë, por çasti që nuk e priste njeri, erdhi pa prituri. I zemëruar, naks dhe i papërmbajtur, ai e shtyu të nipin dhe iu lëshua derës. Ishte aq i ndezur, sa nuk mund t'i përmbledhte dot mendimet. Ikte pa vënë re njeri. Sesi u ndodh aq shpejt në shtëpi, nuk e kuptoi



dot. Futi gishtin në vrimë të kllapës, shtyu kanatën dhe u gjend në oborr. E reja e vështroi që nga dritarja, por kur e pa tërë zulmë e tërë inat nuk i doli përpara. Nexhipi shkante e vinte nëpër oborr, përmbysi çka kishte në kamaren e furrës, qëlloi me shqelmë stolin, që iu ngatërrua nëpër këmbë. Një pulë kakariste si e lebetitur mbi kalibën e qenit, Nexhipi iu lëshua asaj, pula u vërvit nga grazhdet e bagëtive, por ai iu vu pas, e ndoqi, përplasi kokën pas direktut të çarkut, por më në fund e kapi pulën, e mori peshë, varur kokëposhtë, duke ja shtrënguar të dy këmbët dhe nxitoi te ashefi. Atje rrëmbeu një kusi, ja vuri pulës sipër, diçka rrëmbeu nëpër duar dhe ua dha këmbëve përjashta.

Në zyrën e kryesisë mbledhja vazhdoi akoma. Më shumë si bisedë sesa si mbledhje. Zeni pyeste për vjetet e shkuar, për zënkat që kishin patur ata të kryesisë me të gjyshin: — Po si ka qënë ajo zënka në bostanet, që tha xha Nexhipi?

Nazifi zu të tregojë; të gjithë vështronin kryetarin, kurse kryetari nëpër fjalët e kallëzimit sikur shihte me sy ato që dëgjonte:

Në oborr të xhamisë u ndërtua vatra e kulturës. Godinë më të re e më të bukur nuk kishte në fshat. Ajo u ngrit me tulla të kuqe, me dritare të mëdha, u pajis me çka duhej, u ble një radio, orendi të tjera. Nazifi se si u ndodh çakër qejf ditën e inagurimit dhe në sy të hoxhës pat thënë: «Mirë që e ndërtuam këtë vatër këtu, në oborr të xhamisë, nesër pasnesër nga koha a nga tërmeti, minareja do të bjerë dhe xhamia do t'i shtohet vatrës së kulturës».

Këto fjalë i dëgjoi edhe mulla Fazliu, por

nuk guxoi të përgjigjet. Përgjigjen e dha ditë më vonë, në bostanet. Atje u takua me xha Nexhipin, e hoqi mënjanë dhe i foli: — Ore Nexhip, a e dëgjove atë Nazifin asaj dite? — E dëgjova. — E mirë de, me që dëgjove atë, dëgjomë edhe mua. Ai pandeh se xhamia do t'i mbetet kulturës, kurse unë them që s'është çudi dhe zoti e bëftë, ajo shtëpia e kulturës do t'i mbetet xhamisë...

Xha Nexhipi që inatosur, e kish përfshirë Fazlinë për mjekre dhe po të mos kishin rendur, bacevanët...

Zeni u nis për në shtëpi. Kur arriti atje, zogat jariçe u përhapën mu përpara portës. Ai futi majën e lapsit diku mbi portë, çoi lart kllapën, kanatën e shtyu me gju. Nën pjergullën ishte nëna e tij e thelluar në mendime. Me thikë në dorë po ja gërryente kulaçit qoshkat e përzhitura nga shpuza. Nër këmbë i silleshin dy, tri zogë vjeshtore.

— Eja të keqen nëna, t'i kam zjerë fasulet në poçe balti, ashtu si i do ti.

— Falemnderit nënë, nuk më hahet, jam i nxituar, do dal.

— Ç'është ajo! Po deshe të të jap kulaç të ngrohtë me djathë (ajo vështroi nga pjergulla) kemi edhe rrush. Sa mirë shkon!

Ajo theu kulaçin duke psherëtitur. Dy vëthët i dridheshin te bula e veshit.

— Vuratat e kulaçit vështron? Janë nga soda!

Por ai s'e kishte fare mëndjen atje.

— Erdhi plaku në shtëpi?

— Erdhi dhe iku menjëherë, ma prishi mëndjen fare. Nuk e kisha parë aqe të egër si sot, mos jeni zënë me të?

— Jo, nuk jam zënë, por nga shkoi?

— Përpjetë, mori kosorin dhe një litar.

Në odën lart, Nefoja vu mjekrën mbi tufën e fletoreve që po korigjonte, u përkul pas dritares dhe me majën e tregonjësit largoi kortinën. Dukej nëna me kulaç nër duar e Zeni i shtëngur, kokëulur, në mendim.

Havaja ngriti supet dhe s'pati kohë të flasë. kur djali hóqi pas vetes kënatën e rëndë të portës. Kllapa lëshoi zhurmën e drurit të thatë.

Zeni ikte rrugës së malit. Këtej zbrisnin karvanet me mushka e me gomarë të ngarkuar me dru; pas vinin fshatarët. Ai i përshëndeste të gjithë. Te kanali lart hodhi një sy, pastaj një «punambarë». Një tufë çunakësh po vulosnin një foletë grerash, duke përdorur shkopinj e paçavure. Djali hyri në pyll. Nëpër minjollat e reja me pulla bardhë e gri, kishte edhe ca trungje të vjetër plot gunga e shenja rrufeje, pastaj zhukë e vetulla me eshkë. Krimbat kishin punuar nëpër trunget e nër sqetullat e tyre të epërme dukeshin, aty këtu, kupe me një farë tallashi të kafenjtë, ku zakonisht ngrenë foletë kandrat e kacabujtë.

Një tringëllimë zileje. Ai e njohu. Shkoi pas tingullit. Padinën në mes të pyllit ai e njihte me pëllëmbë. Ishte plot fier, nuna, bar e rrënjë luleshtrydheje, disa si rrjeta me kulp vareshin nëpër degët e ahishteve. Në mes kulloste mushka e tyre lidhur me litar në noçkën e këmbës së djathtë. Plaku nuk dukej gjëkund. Zeni bëri më tutje.

Kaptoi lajtbinë, përruan Bigorr, Korien e Lisave. Në rrugë, gjatë përteve, shkelte përmbi lende e gogla dushku. Krahët e një shpendi gërvishtën një degë lisi. Më lart, brigje me tokë humbë, tokë e thatë trokë, leskra-leskra. Pastaj një zhurmë e mprehtë. Dikush përplaste bisqe, sikur rrihte tokën me shufër. Në mes të një cope toke të xhveshur, nën hie lisash, ai njohu të gjyshin, ulur këmbëkryq. Tashti që e pa, që e gjeti, djalit s'i erdhi mbarë që t'i afrohet. «Përse? E ku ta di unë?».

Djali u pështet pas lisit të parë, e pushtoi me krahun e majtë, pështeti gjoksin në trëngun e ashpër. Nën lëkurën lëvrinin milingona. Plaku kishte mblëdhur një vandak me purteka lajthie. Disa i kishte ngulur në tokë, në formë rrethi, e qark tyre po thurte një kosh. Lëvizjet e punës së tij ishin tepër të shpejta, gati të rrepta, të egra. Majë purtekave kishte ndonjë fletë; plaku i rrihte në erë për t'i shkundur, e atëhere dëgjohej ajo fishkëllimë tinzare: Fëëësht!

Nexhipit i duhej të përdridhte ndonjë syresh nëpër qoshkat, sepse tashti po gërshetonte fundin. Por ai ishte i shëndoshë, e kryente këtë punë me një shkathtësi të çuditshme, as që bënte ndonjë lëvizje për t'u ngritur. Në një rast, purteka që e trashë, u përdrodh me zor, gërviti sikur rënkoj, filizi i saj u çapëlye sikur u çuar në disa fije... pëllëmba e plakut lëshoi gjak. Nexhipi nxori kurtinë nga xhamandani, e lëpiu gjakun me gjuhë dhe pllakosi dorën me duhan. Por punën nuk e la dhe dukej që punonte me inat. Koshi u mbarua. Plaku përdrodh shufrat e fundit, krasiti

disa si cmaqe, që delnin anash si shtiza. Puna mbaroi, ai do të shkulte kofinin nga toka, por qëndroi një çast. Vuri duart mbi gjoks dhe treti vështrimin larg. Diçka të përbashkët kishte ai kosh i ngulur në tokë, me atë gjoks leshtor prej divi.

Plaku zbrazi frymën, lëshoi grushtet mbi kosh dhe vu shputat përfundi kofinit. Koshi nuk u shkul. Çatalli në ballë të plakut u thellua, ai ngriti këmbën dhe qëlloi barkun e koshit. Përsëri kofini nuk u shkul, por u shtrembërua. Djali u kollit dhe u dha në shesh. Nexhipi u koll e uli kryet. Koshi mori sërish formën e parë.

— Dale, babagjysh, ti mezi e sajove këtë kofin e tashti kërkon ta prishësh!

— Ty kush të ftoi këtu?

— Shiko, ke gjakosur dorën!

Djali u kërrus dhe mori pagurin. Plaku u kujtua dhe kapi mustakun me dhëmbë: «E mban mënd, shejtani».

Zeni nxitoi poshtë te burimi. Sapo arriti, dy bretkoca kërcyen tutje. Në cipën e ujit ai pa kufitë e fytyrës së vet; më shumë nuk dallonte dot se drizat mbanin hie. Futi pagurin në ujë; filluan gogësimat e ajrit që delte nga mataraja; vinte erë fletësh të kalbura; atij i dridhej dora. U ngrit dhe bëri përpjetë drizave. Plaku po mbushte çibukun duke vështruar kosorin. Zeni hodhi ujë nëpër të gjitha kokat e shufrave, që ishin ngulur në tokë, një për një. Pastaj e kapi koshin përfundi me të dy duart; ai doli menjëherë.

— Shkojmë baba?

Plaku nuk u përgjigj, por u ngrit. Kapi koshin, por djali nuk e lëshoi.

— Lerma mua baba, e marr unë.

— Lëshoje të them, ti s'ke ndonjë punë me të.

Zëri i Nexhipit dukej si i ngjyer me shafran. Djali vu re duart e plakut, i kishte të kallaisura me atë farë jeshili që mban lëkura e lajthishes. Diku shquhej çurka e gjakut.

— Mos u nxeh baba, ç'të keqe ka këtu? Ti e sajove koshin, e thure për bukuri dhe unë e marr në kurriz!

Dhe djali e hodhi në shpinë. Xha Nexhipi e pa që djali s'tundej. U kollit dhe u dha vetullave më poshtë, dy vetulla të trasha të murme, të dendura «si ferrat e burimit atje tatëpjetë». Zëri i djalit ishte i butë, i përunjur; fjala e tij i kujtoi plakut diçka të mallëngjyer, por të kredhur moteve... tutje. Po me gjithë këto, ai heshte krenar, i papërkulur, i paepur, inatçi dhe i rëndë.

— Babagjysh! Mua më kujtohet kur isha i vogël dhe vinim këtej, ti thurje kosha, i merrje në shpinë dhe mua më futje brenda në kofin, më kolovitje.

Nexhipi nxitoi të heqë çibukun nga goja:

— Pooo... kurse sot, të duket se më mban mua në atë kosh!

— Baba!

Ata qëndruan dhe u panë sy më sy.

— Baba, ti po ja ha hakun vetes. Baba, jemi vetëm këtu, mund të flasim, por me një konditë.

— Fol ç'të duash.

— Të flasëm si burra, të më pranosh si burrë.

Atij i shkau buza për nënëqeshje, por vetëm një dhëmb qestër iu duk anash e fare pak. Ishte një nënëqeshje e hidhur.

— E kush gëzohet më shumë, kur ti je burrë!

Ishin te padina. Kishte dritë më shumë. Qie-lli dukej i pjerrët e larg, matanë dukej vargu i malit. Mushka ngriti kryet dhe rrahu për tokë këmbën e majtë: një murjelë i sillej përmbi vithet.

— Ti kërkon t'u bësh qejfin atyre, ti s'e mendon se cilët janë ata e cili jam unë. Të prishim meranë! Një fjalë goje. Do ngrihet gjithë fshati më këmbë; ku do kullosim gjënë e gjallë?

— Në mal, babagjysh, në mal.

— Tamam, fët kunjën, fët shtizën, tamam.

— Por nuk është vetëm këtu puna, baba, mua më çërrit në zemër kur ty të gojosin, e di ti këtë?

— E marr me mend. Por ti nuk di një gjë tjetër. Ata mua më kanë halë në sy, mua që i kam larë malet me gjak, e di ti? e di? Luftës që shkoi, ai Nazifi i sotëm nuk gjente vërë ku të futej. Sot më këndonte si bilbil! Pooo, tashti është kollaj.

— Me ngadale baba, dale.

— Jo, jo, s'ka dale këtu. Kërkon të futësh Servetin në sektor? Mirë, qase, po ta dish, këmborën për tët motër ta varin prapa.

— Dale, baba.

— Bajgë më thuaj, bajgë.

— Përse prish gojën baba? Mos u nxito. Çështjen e Nefos unë nuk e lashë ashtu. U ndreq ajo punë, mbaroi. Këto ditë do vijë Nefoja tek ti bashkë me nënën të kërkojnë lejën. Dale baba. Sidoqoftë ti s'ke patur të drejtë. Për një çështjen tonë, çështje të familjes sonë, s'duhej të dëmtohej e gjithë kooperativa. Ne nuk e kemi fshatin mall, baba. Por sot, atje në mbledhje ti more

zjarr, jo sepse të vinte keq për meranë, por të vjen keq sepse ajo është pronë e xhamisë, e ti e quan të shenjtë. Por nuk është e drejtë që, kur ne çelim toka të reja në majë të malit, toka të pjerreta, kjo këtu të mbetet djerrë...!

— Jo, jo, ti s'do të kuptosh ku pikon shtëpia. Këto janë gjëra të vogla, ata e kanë syrin të më heqin nga kryesia.

— Po, e di, baba. Dhe në një farë mase kanë të drejtë. Mos u nxito, dëgjomë, pastaj, si të më dëgjosh, edhe goditmë. Ti po e ngatërron llogarinë. Edhe ata nuk janë të rinj, por ata nuk qëndruan me të vjetrën, mësuan, hapnë sytë. Nazifi mbaroi një shkollë bujqësore, Selahudini u bë një punëtor i mirë. Ata i venë veshin së resë, shkojnë me rrymën, kupton? Ndërroi koha babagjysh, ti e di këtë; edhe e kupton, por nganjëherë ngul këmbë dhe nuk shkëputesh dot nga e vjetra. Ti luftove për lirinë e këtij populli, kurse sot kërkon ta privosh.

— Përsëri avazi i Mukës.

— Ti e mbylle sallën e kulturës. Ku do të dëfrenjë të rinjtë?

— Ç'na ka gjetur neve që s'kishim të tilla? E di ti që yt atë s'dinte të lozë cingël? E di?

— Po, e di. E marr me mend, edhe mua ti nuk më lije. Por ndërruan kohët, baba, ju luftuat që rinia edhe të dëfrenjë; duhet të dëfrenjë sepse është rini dhe bën punën më të rëndë në fushë.

— Posiii, se të tjerët rrinë duar-kryq.

— Pastaj, ti, njeri i nderuar, njeri me merita, me përvojë, të kanë dërguar të kontrolloje pastërtinë në sektorin pranë dhe ti ke shkuar ve-



të i parruar e mos më keq. Unë të dua pa t'i them këto.

— Tashti mund të flisni çfarë të doni, por një gjë mos e harroni. Para disa vjetësh na thanë që t'i qethim dhentë dy herë në vit. E ku ishte parë kjo? Në vend malësi, të ftohët, të qethësh delet dy herë, ruana zot. Fshati afër e bëri këtë dhe i ngordhën gjithë pëllatë. E di ti këtë? Kurse unë, ja, për atë bukë e më zëntë sytë, e mora kopenë dhe ika si kaçak në mal, prapa diellit shkova, fshehur një javë të tërë, por kopenë e shpëtova. E di ti këtë?

— Po baba. E di, dhe jo vetëm unë. Për atë ke pasur plotësisht të drejtë dhe askush s'mund të ta mohojë, sikurse s'mund të mohojë njeri luftën dhe djalnin që i ke dhënë asaj. Për ato nderohesh dhe ke aq dekorata. Por duhet të kuptohemi. Duhet ta ndajmë shapin nga sheqeri. Nuk bën, nuk shkon, nuk vlen që për hir të asaj të kaluare, ti sot të bëhesh pengesë në kohën që agroteknika...

— E po, na plastë me këtë të shkretë «agrolenikë». Po gratë që ngarkoheshin si kafshët! Unë e preva atë zakon, unë, e di?

Djali fërkoj tëmthas dhe shkoi gjuhën mbi buzë.

Vështrimin e kishte tretur larg.

— Po, e di, ke bërë shumë mirë, edhe kjo ma ka ngrohur zemrën, por shiko baba, ja, shih përtej...

I tregonte malin kundrejt, që dukej si i përhimtë, me një si napë të tejdukshme e si të pudrosur me atë farë poleni, që rrethon kokrrën e kullumbrisë. Plaku ngriti kryet andej.

— Ja, që andej vjen lumi ynë, ti vetë ma ke treguar, kur ai del i shkumbëzuar nga shkëmbi Çatall. Vërsulet tërë zulmë tatëpjetë, gurgullon, përplasat brigjeve dhe shkëmbinjve, çan këtej i papërmbajtur, duke kënduar në shtratin e vet. Kalon, vadit ara, luadhe, jonxha, ve në lëvizje mullinj e centrale, ik e punon, ik e vadit, pastaj fryhet, madhohet, ze ngadalëson rrjedhjen, gjersa më në fund shkon në det e çlodhet...

— Në varr do të thuash?

Djali kapi duart e të gjyshit.

— Jo, mos ma merr ashtu baba, çlodhet, thashë.

Plaku psherëtiu fort. Ndjehej i lënduar. «Vërtet djali desh të më kujtojë vdekjen apo e kujtova unë vetë? Sidoqoftë ajo do vijë; pardje shkoi edhe Resuli; po më bien gjylet afër».

— Po fundi i fjalës: ç'kërkoni nga unë, xhanëm?

— Duam që ti të shkosh dorë për dore me ne. Ne do ta përmbysim krejt të vjetrën, edhe në jetë, edhe në punë, edhe në fshat, edhe në mal, kudo. Njerëzit do të rrojnë të gëzuar, të lumtur. Dhe pikërisht për këto ke luftuar edhe ti, për këto është vrarë edhe babai.

Xha Nexhipi kurrë s'e kishte parë të nipin kaqë të nxituar në fjalë. Dukej që ai fliste me zjarr.

— Unë s'kam qënë kundër ndonjëherë.

— Kështu të duket, baba, por dashur pa dashur, ti me paragjykimet e tua, me disa veprime të pamatura, ke bërë dëm. Ti nga një herë shkon kundër kohës, kundër rrymës.

— Jo, jo, ma thuaj më mirë, ma thuaj ç'të keqe kam bërë.

— Po, do t'i kujtoj shkurt. Meraja është çështja e fundit. Derrat i hoqe nga sektori yt. Të sollën bletët, përzure Servetin. U detyruan të heqin bletët, shpenzime të tjera. Kur dy vajzave të fshatit tonë u doli bursa, ti, në vënd që t'i nxitje të shkonin, vetë u bërë pengesë, shkove në qytet, nëpër komitete dhe je lutur që bursat të ktheheshin për djem... baba...

— Po e shoh, edhe ti e paske mbushur kupën me vrer kundër meje, të kanë folur... je bërë me ta.

— Mos mendo keq babagjysh. Ti nuk e merr dot me mënd sa m'u bë qejfi dje...

— Ç'do të thuash?

— Më thanë se ti ishe i pari në kooperativën tonë që u ngrite e kërkove dema të racës.

Nexhipi këceu:

— Edhe kjo ishte kundër rrymës?

— Jo, baba, kjo është plotësisht me të renë, por le ta lidhim fjalën të dy. Unë gjithnjë do të këshillohem me ty. Kur ta shohësh të arësyeshme, edhe ti këshillohu me mua; unë të dua, të nderoj.

Ata ishin vënë në rrugë. Iu afruan mushkës. Ajo ngriti veshët puliq dhe rrahu tokën me këmbën e majtë. Djali zgjidhi nyjen nga këmba e kafshës; litarin dhe kosorin e futi në kosh, koshin në shpinë dhe u nisën. Plaku hiqte pas kapistre mushkën gjosë. Dolën te xhadeja anës lumit dhe bënë tatëpjetë. Atje ishte një i huaj me një çantë në dorë. Çlodhej mbi mezhde. Bënë toka. Vijuan rrugën të tre.

— Ju jeni kryetari i kooperativës?

— Unë jam.

— Vij nga komiteti për çështjen e patateve

Të tre burrat shkonin pa folur. Pa pritur te Vau i madh xha Nexhipi, lëshoi kapistrën e mushkës, u turr përpara dhe çoi krahët lart.

— Ah, që s'më bëhet dora dyfek!

Një dhelpër çau nëpër lumë dhe, e bukur e tinzare si një pilivesë, përkuli kërbishtet e hyri në pyll.

— Pinte ujë — tha i huaji. Dhe s'u muar vesh në pohonte apo pyeste.

— Jo, jo — ja priti xha Nexhipi, — këtu, te Vau i madh, lumi është i cekët, vendi tatëpjetë e dhelprat ngaherë vijnë e gjuajnë peshq.

Zeni ndërroi dorën me të cilën mbante koshin. Njeriu që vinte nga komiteti u vrëjt. «Ky gërxxhua ose tallet, ose tregon përralla».

Plaku vu re buzët e të huajit, që sikur u shtrembëruan dhe foli sërish:

— Po, po... te vau ka peshk gjithnjë, sepse peshku, si punë e peshkut, kërkon të shkojë gjithnjë kundër rrymës e...

Zeni u mundua të fshehë një nënëqeshje e kafshoi buzën e poshtme, por xha Nexhipi e vu re dhe u gëlltit. Koshi u kolovit mbi kurrizin e djalit.

— Sa të ketë vajtur ora — pyeti ai me çantë.

Plaku qiti sahatin nga xheni i xhamadanit. Zeni në çast ngriti dorën dhe vështroi orën e tij, por u përgjegjën të dy njëherësh:

— Dhjetë, — mermëroi plaku.

— Tre — tha Zeni.

Njeriu me çantë kuptoi që plaku e mbante orën allaturka. Buzëqeshi.

Një tufë vajzash po ngjiteshin këtej. I lanë shakarat në rrugë dhe ndërruan çapin. Zeni bëri të zbresë koshin nga shpina. Plaku e vu re, zgjati dorën t'ja marrë, por nga një vështrim i beftë i gjyshit, djali ndërroi mendje.

Dhe të tre hynë në fshat, gjithnjë nëpër rrugën anës lumit.

## KUR MERNIM FLUTURIM

Lart qielli dukej i turbulltë. Shtëllungat e mëdha të reve si kodra të murme, hypnin në shpinë të njëra tjetrës, shkapërderdheshin ngadalë, ndërronin vend e formë orë e çast. Një tufë patash të egra po fluturonin pjerrazi në një radhë të përsosur, në formën e një shigjete. Në një çast, tufa e shpendëve sikur u lëkund, sikur u nanuris nga ndonjë dallgë e padukur e, fare pa pritur, gjëmoi shqota në hapësirë. Radha e patateve u çart, disa syresh u lëshuan me vërtik tatëpjetë, u futën nëpër gjiret e reve, të tjera u krodhën nëpër hone mjergulle, duke lëshuar klithma kundër furtunës, që donte t'i përpijë.

E vështrova këtë skenë, kur vetë isha i shtritur me shpinë mbi dëborë. Isha i lodhur, i uritur, i kapitur dhe i qullur kokë e këmbë. Tre shokët e mi çlodheshin edhe ata pranë meje. Por ata (që të tre) ishin të plagosur në gjymtyrët lart dhe më ishin besuar mua që t'i udhëheq, t'i strehoj dhe të kujdesem për ta. Isha më i ri prej tyre, pa dalë mustaku në buzë, pa m'u trashur zëri, por sidoqoftë isha djalë, me faqet e kuqe e vështrim çapkëni.

Ditëve që kishin kaluar, ne patëm luftuar, por armiku ishte më i fortë, më i shumtë. Na ndoqi gjer afër maleve, por më tutje s'ja mbante.

Pyll në dimër. Thanat, kredhur në okitë dridheshin nga e ftohta si njerëz të gjallë. Ahet e lartë, me turinj të futur në dëborë, përpiqnin degët e rënkonin, kurse toka e mbuluar me masën e bardhë, ishte bërë kallkan. Më dridhej cipa e barkut, më kërcisnin dhëmbët, s'i ndjeja fare këmbët, duart i kisha si copa patavre e acari m'i mbushte sytë me lot.

Më në fund, ne e gjetëm kalibën e druvarëve. Ishte kredhur e gjitha nën dëborë dhe n'u desh t'i vij vërdallë një copë herë. Pashë vetëm pjesën e epërme të lesës. Atje u shtriva dhe ngula sytë brenda... një pamje e çuditshme shkretie. Drita atje dukej si e hirosur, si mavi. Kalibja që prej gardhi, në patoz kishte gurë, mbi ta kanata dyersh, mbi kanatat fier i thatë, që mbante erë myk. Në një qosh ishte hedhur një thes i zi plot arne, pastaj një kosor, afër tij një kupale me qymyr. Zbritëm si në katakombë. Shtëpi dëbore me mure e çati, kurse shtroja e ngrirë top, plot vetulla të bardha nëpër arabeska akulli. Zvarrë-zvarrë hymë brenda. Këpucët i kisha plot gunga dëbore të ngurosurë në thembrat, por as gishtat as thembrat s'i ndjeja fare. Brenda ishte diçka më ngrohët, se plagët e shokëve nisën të mbajnë erë djersë e gjak.

Të plagosurit u shtritën mbi fier; vetë ndeza lecka e vendosa mbi to kalema qymyri. Nuk e mendonja e as e dinja acidin e karbonit. Tashti e di që dëborë ishte atëhere si ai sfyngjeri, që thith-te vdekjen tonë.

Ngrohët, rehati, qetësi pas furtune, domosdo edhe gjumë, gjumë me ëndra fatlume; sofrë me bukëvale, sofrë me kaçamak, me misërnike të ngrohët, me trahan të nxehtë.

Por tashti duhej shkuar në fshatin poshtë luginës. Një natë më parë kisha kaluar aty. Dhe atje një shok i terrenit në errësirën e natës, më njohu me një shoqe. U njohëm aq sa mund të njihesh në errësirë. Unë nuk e dallova fare fytyrën e saj, dëgjova veç emrin e saj. Ajo më shtërngoi dorën dhe shoku vijoi të flasë:

— Ju, shoku Vasil, do të kini lidhje me shogën, ja ejani këtej... do kaloni nëpër këtë rrugicë, do kapërxeni këtë murin, do hidheni te ky oborri dhe ja ku shquan nëpër dëborë ajo dritarja, atje do trokisni. Shoqja do t'ju japë çka duhet, lajmet, njoftimet, lidhjet...

— Është një nder për mua — foli vajza — është një nder që të kujdesem për shokë të plagosur...

Por te ai fshati poshtë luginës ishte zona ku sillej armiku. Atje qe rreziku, fare lehtë mund të bije në pritë e të ta shponin kokën tej matanë. E me gjithë këto unë nxitohesha të nisesha në çast, shokët donin bukë. Dhe bashkë me dashurinë për shokët, me dëshirën për t'i ndihmuar ata, bashkë me përgjegjësinë e detyrës, unë kisha edhe një arsye tjetër: atje poshtë do të merrnija lajme, trakte dhe njoftime për batalionin tonë dhe për vendin se nga shkonte e lëvizte ai.

Ishte mesnatë e suferinë, kur i bashkova këpucët me një të lidhur dhe i shalova në qafë. Ashtu më vareshin në gjoks si këmborë. Dola nga kalibja. Era ulërinte e grindej si përbindësh.



Dëbora qe e trashë dhe e fortë, ecja mbi të, vërsulesha nëpër të, shkisinja sipër saj. Nëpër rrëzimet shtrihesha duke u mbledhur kuspull e lëshohesha në rrokullisje tatëpjetë. Në një rast të tillë m'u përpoq koka në një thep. Tëmthi m'u ça, gjaku teptisi por u mpiks, kurse dhëmbja më sëmboi thellë. Ulërinte veriu në përrenj, era rënkonte drurëve të pyllit, trokëllinin degët e thata, por zemra ime ishte e re, zemër djali në kryengritje.

Rruga më zgjati nja dy orë. Rendja e sikur fluturonja dhe jo vetëm se ishte tatëpjetë. Pastaj lehjet e qenve më kujtuan se qeshë afruar. Hyra në fshat jo udhës së gjërë, zgjodha qoshkat, që më kishin treguar. Pas një kanate një fëshfërimë. Vura veshin. Ishte zhurma e një qerthulli. Pastaj një xham i kallajisur me okitë si i lyster me argjënd. Atje ngula vështrimin. Një llambadhe e madhe mbi buhare; flaka e saj trazohej nga afshi i zjarrit dhe dukej sikur qiriri qante, sepse derdhte poshtë pika dylli. Te qoshku, një plakë mbështille fije në një lëmsh. Më këtej një nuse e re, e përgjumur, e kërrusur me gjirin iëshuar mbi djep, si vile; dorën e mbante në për-kresen e djepit dhe flokët i vareshin në fytyrë. Dhe nëpër flokët i shquheshin faqet pak të zbeta.

Kalova më poshtë, gjeta qoshkun, rrugën, kapërxeva murin, hyra në oborr; një oborr i gjatë i mbuluar me dëborë, me një monopat të vetëm mu në mes. Por te dritarja dëbora qe hequr një herë, njihej dëbora e re që po binte akoma. Ngri-ta duart te dritarja. Ishte e vogël, kishte përpara

një rjetë të vjetër teli me forma si të hojeve, ku mund të hynte vetëm një cigare. Fillova të kaloj gishtat mbi rjetë, sikur të lozja mbi një harpë. Brenda kërcëlliti diçka, si një shtrat druri. U çel *kanata e vogël, njëra*, pastaj tjetra, nëpër muzg u duk dora e vajzës, ajo diku çkopsiti rjetën e tellit për anash (e kishte gatitur që ditën) dhe më zgjati dorën

— Vdekje fashizmit, — i pëshpërita unë. Edhe ajo m'u përgjigj ngadalë me parullën tonë të njohur. Bëmë toka dhe si nëpër mjergull dallova siluetën e fytyrës së saj.

— Paske mërdhirë shumë, — më tha — eja brenda të ngrohesh, këtu s'kam njeri, do ta ndez zjarrin, kalo andej...

— Jo, jo, në asnjë mënyrë, trupin e kam të valë, nuk vij, nuk është as koha, as vendi, as rasti; shokët presin, po sa të mundësh më shpejt.

U largua ngadalë, çeli një derë, kërcëllitën nëpër terr basamakë shkallësh. Një afsh i ngrohët delte nga dritarja, kurse mbi kryet e mbi shpinën time binte dëbora, binte gjithnjë. Pas pak ajo erdhi. Përsëri më pëshpëriti:

— Kam mbushur një palë hejbe, brenda ke ushqime, ilaçet, ke një tufë trakte, katër palë çorape, ke edhe një yll të kuq, e qëndisa unë për ty.

E falënderova dhe kuptova që buzëqeshi, sepse nëpër muzg i xixëlluan sytë.

— Ç'kemi këtej? — e pyeta.

— Gjermanët erdhën sot nëpër fshat, nuk u kuptua ç'kërkonin; po përsëri ikën. Ballistë janë nja tridhjetë vetë këtu. Po hap sytë mirë, kur hyn e del në fshat. Kujdes.

Ajo zgjati dorën e hoqi dëborën nga kapela ime, nxori hejbetë nëpër dritaren, unë i mora, pastaj i dhashë dorën, një «vdekje fashizmit» dhe u nisa. Pastaj e futa kokën në të çarën e hejbeve dhe mora përppjetë. Lart, në një çukë, qëndrova. Era m'i thante faqet, lumi shkiste nën akuq, duke i lëpirë ata.

Nuk shkova rrugëve, se në luftë lumi fle e hasmi s'fle, ai rri zgjuar e të përgjon, të ze pusi e të përmbys.

E mbaja pushkën në dorë dhe trupin kërrusur përpara, sepse era zbriste tatëpjetë. Hasja egërsira, përballja valanga ere. Ujqërit më shihnin si i shihja, hungronin e bënë mënjanë. Se, po e pate pushkën në dorë e thikën në brez, edhe ujku të bën rrugë. Pa pritur një zhurmë që pas. U ktheva në çast. Afrohej një ulkonjë me tre këlyshë pas. Të vegjlit hungruan dhe turfulluan drejt meje, por e ëma nxitoi dhe u doli përpara. Më shkoi pranë e hepoi kryqet. Ndofta e kishte shenjë se përunjë. Isha gati të tërheq këmbëzën, kur vura re sisët e ulkonjës, që zvariseshin mbi dëborë, pastaj ndjeva një erë të rëndë strofke e plehu. Por në ato net lufte ne kishim punë vetëm me ujqërit me dy këmbë. Ulkonja me gjithë këlyshë theri tatëpjetë përroit.

Përsëri qëndrova në një çukë. Që atje dukeshin xixat e oxhakëve, kurse lehjet e qenve ndiheshin gjithnjë e më larg. Dhe u vura në ikje, i ngarkuar, i kuspullosur, duke ja fshehur fytyrën erës dhe dëborës, që s'kish të pushuar.

Në një kohë zu kuqëlonte nga lindja. Në fillim ajo përskuqje mezi dallohej, por dalëngadalë dëbora zu të zbardhte më fort. Dhe unë ngjitesha pllajave, kodrave, këmbë e duar, shtigjeve, ku akulli kërciste e thyhej nga ngrica.

Pastaj fitorja! Lëshova hejbetë midis gurëve të kalibes, që ishin zbardhur si alipsane. Thëngjijtë e kuq të zjarrit ishin veshur me hi të bardhë. Shokët i gjeta pas zjarrit.

— Dëgjuam batare, u trembëm për ty.

— Ti atje, të lutem largoje këmbën nga zjarri, do të të digjet këpuca.

E bëra atë rrugë kushedi sa herë. Po ajo vër-sulje tatëpjetë, po ajo e kaluar e gishtave mbi rjetën e telit.

Por koha u ngushtua, lufta u rrit, dëbora s'desh të tundej dhe kur zbrita një natë, trokitjen time s'kisha ku ta bëj. Shtëpia e vajzës ishte kthyer në një gërmadhë. E kishin djegur armiqtë. Trarët e nxirë dhëmbë-dhëmbë nga valët e flakëve, sikur mendoheshin me kokën mbështetur në kupalet me dëborë, porta e djegur që përmbysur mbi sofat. Asnjë shenjë jete. Heshtje të gërma-dha, zi në oborr, shkreti në rrugë dhe vetëm dëbora sitej ngadale rreth e qark. Vinte erë blözë e gur i djegur. Ai rast fatkeq s'tregohet dot. Mundohu sa të duash, por fjalët s'dalin, nuk mundem ta përshkruaj. Që të mundem duhet të ngjy-  
ej penën në helmin e asaj nate, në zbrazëtirën e tmeruar të heshtjes, në zemrën që shtrydhet si sfungjer i përzhitur. Po tashti, me se do t'i ushqej shokët? Me se do t'i kujdes? Po lidhja që kishim? po lajmet...?

Dola nëpër fshat, duke u zvarrisur ngadale. Diku në rrugë, te një dritare e pakët kishte dritë, perdja ishte mënjanuar. Vështrova atje. Duke-shin veç dy gra të heshtura, që thurnin çorape ulur në një kënd. Mbi krye të tyre ishte ndehur një hu me llukanikë. Ato nuk flisnin fare, ishin në mendim, në mërzi. Afrova fytyrën te xhami dhe u fola:

— Nëna, motra, ju lutem më falni, s'kërkoj asgjë, veç diçka dua të pyes, ju lutem, nëna...

Menjëherë ato shojtën dritën. «Ah, ta marrë dreqi, u trembën e fikën edhe dritën. Eh, kohë, kohë!» Por u gabova. Diçka lëvriu mbi prevazin e kanatës, ajo u çel ngadale:

— Kush je ti?

— Jam një... partizan.

— Eja mbrenda.

— Të vij brenda?

— Po, eja, tri çape më poshtë është porta, ngadalë.

Qortova veten që mendova keq për to. «Hej budallë, s'ke besim te njerëzit e tu. Po si e sollti koha... eh, kohë e vështirë! Po sikur të futem në ndonjë grackë!»

Ngadale u hoq një lloz porte, kanata e saj kërciti lehtë e lehtë. Hyra. Njëra nga gratë më priti, e mbylli portën sërish e, duke më shtytur pas supi, më shpuri në një ashef të ngushtë e të errët. Dikush i frynte një zjarri e, sa dha flaka, u ngrit një vajzë. Më dha dorën gruaja, pastaj çupa, gruaja tjetër erdhi mu në çast. Mendova: «Mos vallë kjo është shoqja ime, që as fytyrën s'ja njoh?»

Por aty për aty u sqarua; vajzën e urdhëruan me emër të shkojë për të sjellë bukë e gjellë. pra s'ishte ajo që kërkoja. U ngroha, hëngra bukë, më pyetën, u përgjigja sa më shkurt e sipas mënyrës që më pyesnin, me zë të ulur, ngadale. I pyeta për një shtëpi më poshtë, që e pashë të djegur. Kjo më duhej. Më treguan se dy ditë më parë, patën ardhur gjermanët dhe e kishin djegur.

— Po për ç'arësye?

— S'dimë kush i ka kallëzuar, kanë thënë se ishin bazë partizanësh, pastaj edhe djalin e kanë partizan, andej nga Tirana.

— Po njerëzit e shtëpisë?

— Dje mbrëma natën erdhën partizanë, i ngritën me gjithsej; se ku i shpunë nuk dihet.

— Në ndonjë fshat të malësisë, ndofta... — u hodh e tha vajza — ose në Manëzë ose në Silë, thonë se andej janë mbledhur partizanët.

Ato më dhanë një trastë me ushqime, i falënderova, u urova gjithë të mirat dhe u nisa.

U ktheva te shokët më shpejt, por i ligështuar. Ata i gjeta në rrëmujë. Një i panjohur flinte në qosh:

— Erdhi urdhër nga komanda. Do të futemi ilegalë në qytet, natën. Atje do na mbyllën plagët fare shpejt. Do vish edhe ti; ja udhëheqësi, po fle. Ja edhe letërnjoftimet false.

U vumë në rrugë e megjithse tatëpjetë, çapet i zvarisja sikur ngjitesha përpetë. Pas disa orë rruge, te një shkëmb përpoqa këmbën dhe bërtita:

— Shokë! Udhën e mbarë, unë nuk vij! Jam

i shëndoshë, jam i fortë, jam i ri, do luftoj maleve, shokë! Vdekje fashizmit!

Ata pandehën se bëja shaka. Por unë i përshëndeta, i përqafova dhe u ktheva. Bëra përpjetë dhe më dukej sikur ikja tatëpjetë. Afër mbrëmjes u futa sërish në kaliben e malit. Natën do ta kalonja aty. Por nuk fjeta fare; vetmia më mundonte. Ndeja gjithë natën mbi zjarr me tëmblat nër duar. Medoemos duhet të gjeja shokët, të gjeja lidhjen; ishte mirë të gjeja vajzën, që kishite ikur me gjithë familje. Po nga të shkoja? Rrija e mendohesha e nuk e gjeja dot me mënd.

U gdhi një mëngjes i rëndë, i errët, me erë e dëborë, që sitej e binte pa pushim. U nisa. «Të dalë ku të dalë. Nëpër katundet e thellë maleve pa tjetër do gjej shokë.»

Kaloja dushkerave me dy pushkë krahëve, me këpucët kaliqafë. Si kapërxeva një majë mali, koha nisi të zbutet, bunaca nuk vihej re në qiell, ajo punonte në koren e tokës. Ujëra pikonin, gurgullonin poshtë, çelnin llagëme, ngadalë pikë e pikë, por gjithnjë. U duk një zabel arash rrethuar me kumbulla të egra. Dukeshin veç degët e përkulura fort, me majat ngulur në dëborë si angjistra, që kapnin peshq në detin e bardhë! Arrija një majë tjetër. Shkula dylbinë nga torba. Kisha një teke të tillë dhe e vura në sy. Për djall qelqi i saj qe mbushur me thërmia buke. E fshi-va si munda me cep të shallit. Tashti shihej mirë. Në lenten e kryqosur me vija e numra përmblihdeshin maja malesh, hiroseshin, mjegulloheshin. Rrotullova vidën gjersa pamja m'u sqarua mirë. Diku dukej një përt mbi dëborë. Më tut-

Je kishte lisniqe. Pra, atje afër ndodhej Manëza. U lëshova me vrap ngarkuar me barrën time të hekurt. Më erdhi era e tymit. Çalonja gjithnjë e më shumë duke ecur, se dëborë s'mbante më përsipër. Arrija te një kashtore me gardh. Nga thekërishtja e çatisë pikonin ujëra, nën strehët çuçurisnin harabelat me sytë e trembur. Një grua po shtynte një kosh me bar të thatë. E pyeta dhe m'u përgjegj. Pra, isha në Manëzë.

— Këtu ka partizanë sa të duash, — më tha ajo — këtu është si spital, janë më shumë të plagosur... «Pra i gjeta shokët, i gjeta, kjo ka rëndësi!» Zemra më rrahu fort.

— Po këto ditë mos ka ardhur këtu ndonjë familje nga katundet e fushës? — Gruaja pohoi me krye.

— Erdhi pardje, e sollën disa partizanë, një grua me dy tre fëmijë, më duket sikur ishte edhe një çupë e rritur.

— Po ku qëndroi ajo familje?

Gruaja më tregoi me dorë një shtëpi.

— Ja, përtej, e sheh ku është kisha? Ajo këtej, që ka atë lisnikun në krah... atje.

Ajo s'desh të më lëshojë; hyri në kashtore e u kthye dhe më vu ndër duar një ftua të madh. Ftoi lëshonte një erë të mirë, por më dukej i mavi, pastaj si jeshil. E kishin fajin sytë e mi të vrrarë nga bardhësia e dëborës.

E falënderova gruan e mirë dhe u nisa. Lart, në qiell, dëgjohej vak-vaku i patave. Vallë, a e kishin krijuar ato formën e shigjetës? Nuk ngrija kokën t'i shoh, se binte dëborë e trashë e më lagej fytyra. Shtëpinë e treguar e arrija shpejt. Hyra në oborr. Mbanë dukej një hajati i madh,



një pus e nëpër trarët ishin varur vandakë me misërishtu të thata. Rendi një kone e vogël, la gjurma mbi dëborë, por nuk lehu, bëri sikur teshtiu e me gjuhën e kuqe lëpiu buzët e buta e të murme. Doli një grua, e veshur me një xibun shajaku mavi. I thashë se kërkoja një familje nga të fushës.

— Po, këtu e ke, — m'u përgjigj ajo, — eja.

Më shpuri para një dere dhe e shyu. Kuptova se kapërxeva një prak, nuk mund të shihnja kurrgjë, vetëm dëgjova pasthirrma habie. Një kor të tërë. Midis shumë zërave njoha zërin e vajzës. Më pritën si partizan, u ngritën kaq njerëz më këmbë. Këto i kuptoja vetëm nga zhurmat, sepse sytë e mi, vrarë nga dëborat, akoma s'dallonin gjë. Por isha i mërdhirë, duart më kishin rënë për thonjsh. Më ulën në një stol, m'i futën duart në ujin e nxehtë të një legeni, më hoqën pallton, më hodhën raki në trup, më fërkuan me vrull gjoksin, shpatullat, duart. Në këtë punë merrnin pjesë më shumë se dhjetë duar, por unë dallonja vetëm një palë duar. Më në fund nisa të dalloj. M'u kujtua tava e një fotografi kur kisha qenë i vogël. Ai hidhte në tavë letrën e pozitivit dhe kur lëngu kimik bënte punën e vet, dalëngadalë nisnin e sqaroheshin fytyrat...

Pashë nënën e vajzës, dy motra të vogla, një vëlla nja dhjetë vjeç, pastaj dy partizanë. Mbi kokën time ishte shoqja, së cilës i dinja vetëm emrin; për herë të parë po e vështronja nën dritën e një zjarri të madh.

Atëhere u tregova se nga vinja, u tregova për shokët që përcolla, u fola për ata shokë, që i kisha kujdesur kaq kohë...

Vajza, që kisha mbi krye, ja dha gazet. I qeshte e gjithë fytyra, sytë, balli, faqet...

— Mama! Mama! Ky qënka, ky është ai partizani që vinte natën ndër ne, mama ky është!

Një nga partizanët më foli:

— Ne jemi korierë. Sapo erdhëm nga komanda e qarkut. Qëndruam këtu për çlodhje. Nesër nisemi. Forcat tona po grupohen... a do vish me ne?

— Do vij pa tjetër, unë dola këtej për shoqë dhe për lidhjen, që humba. — Dhe tregova me dorë shoqen përpara.

Vajza më tregoi për gjëmën, që i kishte gjetur, kurse e ëma ja preu shkurt:

— Përse i kujton ato moj bijë? Djemtë shëndoshë! Kam brengën e atij djalit që e kam larg. Sikur ta kisha këtej...

Ishim në një kthinë të errët, të nxehur fort nga zjarri, kthinë pa tavan, me trarë të zinj si abanoz, të pagdhundur, plot gunga e gdhënj. Në për ta kishin varur rroba për t'i terur. Në zjarr po zjente një poçe e madhe me fasule. Në shpuzë kishin mbuluar patate. Tashti vajza u tregonte shokëve të tjerë mbi ato netët e kaluara, kur unë shkoja në dritaren e tyre. Kalamajtë çuditëshin e hapnin sytë. Njëri prej tyre u hodh e tha se ai, një nate, diçka kishte kuptuar. Unë buzëqeshja dhe ngroheshja pranë zjarrit.

Por unë isha i lodhur, më mirë të them i kapitur. Zjarri bubullonte e kërciste, masha ndrishte me dorezën e saj si të ngjyer në argjend, dhe sa të përgatisnin diçka për të ngrënë, mua më mori gjumi me supin pas vatrës.

Vonë natën më zgjoi uria. I çela sytë dhe u ngrita shesh. Heshtje e thellë. Te dritarja, në sofatin e lyer me dhe të kuq, regëtime llamba e vajgurit me fitil të ulur. Të gjithë flinin rëndë, me frymëmarrje të rregullta dhe të përzjera. Pas meje flinin dy shokët. Në këndin tjetër, nëna me fëmijët. Përmbi trarët dukeshin disa si hie fantastike e të zeza, të përkulura, dyndur njëra mbi tjetrën. Desha të ngrihem, zorrët më gërrisnin. Psherëtita. Pa pritur vajza këceu:

— Të hahet bukë?

Kuptohej që ajo s'kishte fjetur fare. Si një motër e dhëmshur pat pritur të zgjohem unë.

— Prit të të sjell, prit!

— Vërtet, më rrëmbeu gjumi, po në ëndër s'lashë gjë pa ngrënë. — Ajo qeshi ndërsa diçka nxirrte prej magjes. Pastaj u afrua dhe te guri i vatrës lëshoi një pjatë me gjellë. Mbi mashë vuri një fetë bukë të përzhitet: Trazoi zjarrin.

— Ja, ku t'i lamë edhe patatet e pjekura. Janë të ëmbla. Vëllai im më i vogël të la edhe ai nga pjesa e vet...

Unë u vura të ha, Kurse ajo çoi dorën e hodhi në zjarr një tufë shkarpa të thata. Flakët plasën menjëherë. Ato uleshin, ngriheshin, lëpinin perustinë e hollë, lanë e ngjyen me të kuq fytyrat tona. Në një çast vura veshin: përveç ne të dyve të gjithë flinin, kurse nëpër oxhak vinte vak-vaku i patave, që silleshin lart në qiell. Duhej të qe agimi. Patat po mblidheshin, se koha po zbutej, ato po merrnin fluturim, po radhi-teshin në formën e shigjetës.

## SHTËPIA E SHERIFIT NË MAJË TË GËRXXHIT

I shte dimër i rëndë atij moti. Dëbora e trashë zu vënd me kohë dhe e mbuloi botën anembanë. E mbuloi dhe e ngjeshi aq fort sa dukej sikur i kishte zënë frymën e s'e linte të lozë vendit. Po sikur të mos ishte mjaft kjo, ja edhe pllaska të tjera të dëndura sa çaplonin drurët e korieve, mbyllnin monopetet e katundeve e bënin të rënkojnë çatitë e shtëpive.

Në xhadenë e madhe, kolona e gjermanëve me tanksa të zinj e motorë të rëndë mezi lëvizte. Kundërmonte era e benzinës e gulshe tymi të zi shfrynin nëpër xhade. Oficerët e huaj ishin strukur kabinave, veshur e ngjeshur me kapota të murme, hundët i mbanin ngritur lart sikur të nuhatnin çdo rrezik, sytë i kishin të menduar, ishin të zbetë në fytyrë, të egër në urdhërat, bër-tisnin e shanin. Vështronin anash male gjigantë të rënduar nga masa e bardhë, male e vetëm male e, përmbi ta, male të tjerë. Fshirëset nuk punonin më përmbi xhamat e kamionave, që ishin mbuluar dhe shoferët mbanin kryet përjashta. Ra na-

ta. Murlani u egërsua e s'përmbahej më. Në atë thëllim e ulërimë të natyrës, të shtihej në kokë përfytyrimi i një përbindëshi që rendëte pllajave, rrokullisej rrëpirave e, kur egërsi e tij s'kish të sosur, dukej sikur ngulte brirët e tij nëpër përrenjtë e ulërinte, përplasej, zhgrryhej dhe kuiste sikur i kishin vënë thikën në grykë.

Shtëpia e Sherif Haxhisë, mu në gërxhin, përmbi shpat, ishte më tepër një kullë se shtëpi. Kjo vihej re në frëngjitë e vogla me kafaze dru-ri, në muret e lartë pa dritare, në portën e vogël dy pash lart nga toka, ku hyhej veç me një shkallë, që lëshohej nga brënda. Afër saj s'kish bane-sa të tjera. Veç lisa të lartë shpërndareshin nëpër trollet rreth e qark e pylli me dushqe shtrihej prapa shkëmbit. Atje regëtinte burimi i ujit, ku Sherifi ditë e për ditë, me ndihmën e së motrës, zvarrë-zvarrë e me mundim, mbushte katrovat me ujë për robt e shtëpisë e për gjënë e gjallë.

Asaj nate tufani po e sulmonte këtë shtëpi-kullë e, nëpër mugëtirë, retë e dëborës dukeshin si ndoca dantella noprane e të mavijta, që u turreshin mureve e i kafshonin. i brenin dhe i kallaisnin me okitë.

I kishte dy mysafirë asaj nate Sherif Haxhia. Në odën lart, pa llambë e pa tavan, bubulonte zjarri me kërcunj lisi e në vatër po tereshin e cmurnitëshin dy palë çorape leshi të zeza. Mysafirët kishin zënë bashet, kurse Sherifi vetë qëndronte midis tyre me fytyrë nga vatra, i shtruar këmbëkryq e me mashë në duar. Mureve ishin varur edhe kapelat e mysafirëve. Kapela me ngjyrë kaki, të rrumbullakta dhe me nga një shqipe në ballë; po aty afër ishin varur edhe ar-

mët e tyre, kurse pushka e Sherifit ca më poshtë.

— Për këtu na ka nisur Azis Begu, o i zoti i shtëpisë, e hapi fjalën njëri nga të riardhurit. Ngriti kupën e rakisë dhe uroi:

— Hajde me shëndet, të të rrojë fara e fisi, dega e lisi!

Sherifi dëgjoi me dorën në zemër.

— Ta ngremë këtë dolli për shëndet të Azis Begut me shokë dhe për shëndet të gjermanit, që na ka vënë krahun dhe po na ndih! — uroi tjetri.

Kupat u shkundën me fund dhe Sherifi pyeti:

— Po ç'kemi? Ç'bëhet asaj bote? Se unë këtu, besa-besën, jam si i humbur fare.

— Thonë, — ja priti një nga mysafirët — thonë se kësaj kohe të tërbuar, një çetë e madhe komunistësh don t'i bjerë mes për mes krahinës sonë për të vrarë e për të prerë.

— Ashtu? — pyeti Sherifi.

— Po. Janë të shitur me pare flori, punojnë për të huajtë, bile nër çetat e tyre më shumë se gjysmat janë të huaj, sllavë e grekë.

— Po e lamë punën në duar të tyre, — plotësoi miku i dytë, — Shqipërinë do ta shesin, do na prishin fe e atdhe e ne do jemi robër.

Biseda reshti një çast, gjersa foli një nga të huajtë:

— Paskë shtëpi të fortë, o Sherif — dhe u hodhi një sy frëngjive dhe mureve, — shtëpi të fortë për punë luftë, këtu mund të mbash e mund të kthesh një ordhi të tërë.

— Vërtet, or burrë — plotësoi miku i dytë,  
— sikur për çudi të na kalojë sonte këtej ajo çeta e madhe e kuqove, besa-besën do t'i grijmë e do t'i bëjmë fërtele.

— Po... ç'kemi tjetër asaj Shqipnie? — pyeti sërish Sherifi.

— Si e thamë, gjermani na ka vënë krahun, forcat tona u janë vërsulur komunistëve ku janë e ku s'janë, po i ndjekin këmba-këmbës, koha po na ndih me këtë qahmet dhe, besa-besën, në krye të muajit e gjithë Shqipëria mund të rrijë qetë-qetë...

Sherif Haxhia, nja dyzet vjeç burrë, i gjatë dhe i thatë, dëgjonte fjalët e tyre e fliste pa

Dikush trokiti në dërrasat e dyshemesë. Dikush që ngjitur me shkallë nga kati i poshtëm, e u duk veç një kokë e mbuluar me një shami të hollë e të zezë. Ishte e ëma e Sherifit, që sillte darkën. Sherifi nxitoi andej dhe shkëmbeu një vështrim, si një farë shenje me t'ëmën. Kjo me shenjë i njoftoi se raki s'kishte më në zamzane dhe u nis. Ajo me fëmijët, me nusen e djalit dhe vajzën e madhe ishte futur diku në haur, afër kafshëve, ku patën zjerë trahan të thartë e patën fërguar vezë me gjalpë e piper të kuq. I zoti i shtëpisë, si mori nër duar palarenë me gjellët, i lëshoi një çast përdhe, sa të merrte edhe çanakun e madh me gorica turshi, që po ja jepte që poshtë e motra, kur... mu nën strehët e shtëpisë gjëmoi zëri i fortë i një burri të panjohur.

— O i zoti i shtëpisë! A pret miq?

Miqtë rrëmbyen pushkët e kapën frëngjitë. kurse i zoti i shtëpisë çakërdisi urët e zjarrit e hodhi mbi të katrovën me ujë.

— Hej, i zoti i shtëpisë, a pret miq?

Dhe bashkë me zërin që thërriti për së dyti, u dëgjuan zhurma edhe në anën tjetër të shtëpisë. Ishin zhurma njerëzish, që zvarriseshin e zinin vend nëpër dëborë. Sherifi s'po dinte nga t'ja mbajë, kur të dy miqtë qëlluan me armë nga frëngjitë, bërtitën e fërshëllyen disa sharje.

Sherif Haxhia jo prej frike, po prej një ndjenje të çuditshme, u lëshua nëpër shkallët e me një frymë u ndodh poshtë në stallën e kafshëve, midis kalamajve, që ja dhanë vajit e qanin duke sokëllitur.

Këto ndodhën në një çast dhe po në këtë çast gjëmuan përjashta një sërë bataresh, që i bënë fëmijët të platinin zërat e të bien përmbys. Dhe bashkë me bataretë u dëgjua një zë i fortë burri:

— Zjarr të përsëritur, sulm!

Një tufë bombash plasën mbi dëborën e çatisë e rrëzuan poshtë copa rrasash, kurse Sherifit iu duk sikur shtëpia sillej rrotull si një qerthull. Disa këmbë rendën nëpër konakun lart, krisi kanata e portës së daljes prapa, bataretë u egërsuan jashtë e papritur çdo zhurmë u pre. U pre me një herë, sikur e përpiu nata. «Vallë ç'ndodhi?»

Sherifi asgjë s'po merrte vesh. Dhe përsëri zëri i parë:

— Hej, juve brenda, dorëzohuni, përndryshe... do t'i kallim zjarr shtëpisë.

«Vallë ç'bëjnë të dy miqtë? A janë sipër apo krisën e ikën. As përgjigjen, as shtien, as poshtë nuk zbresin. Po kanata që u përplas lart? Mos



vërtet mundën e ikën. Por diçka duhet bërë, duhet folur, duhet nxituar. Këta të huaj, që çatisën kështu pa pritur, do më futin pishën e do më zhuritën me gjithsej, hej, zot, më shpëto!»

U avit te frëngjia poshtë e bërtiti:

— Kam dy mysafirë në shtëpi, ata e nisën luftën, s'kam ç'bëj.

— Vetëm dy? — pyetën që jashtë.

— Po, besa, veç dy.

Një njeri u afrua anash frëngjisë përjashta dhe foli:

— Kush je ti?

— Jam i zoti i shtëpisë, Sherifi.

— Mirë, o Sherif, po pa na thuaj ke të tjerë apo jo, fol drejt.

— Jo, besa, jo.

— Kush qëllon nga dritarja nuk ka besë, del jashtë të të besojmë.

Po bëhej gati të delte, kur e ëma iu derdh dhe e kapi për beli:

— Jo nuk të le të dalish, jo, do të të vrasin. Po dal vetë.

\* \* \*

Shtëpia u mbush me të huaj. Dhe ata sollën brenda një njeri të plagosur. Sherifi s'e pa dot, po kur kaluan ata që e mbanin peshë, ai dalloj veç këmbët e tij, pastaj një rënkim e asgjë tjetër. Dikush ndezi një pishë e tre partizanë u ngjitën lart, pasi vunë përpara Sherifin. Me të arritur lart ata e pyetën sërish:

— Ku u fshehën të tjerët?

— Ju betohem për besë, veç ata të dy...

— Ata ishin, s'janë më. Po cilët ishin ata, emrat...

— Më erdhën mbrëmë, s'i njihja më parë.

— Ballistë?

— Po.

— Po ti, ç'je ti?

— Njeri si më shihni.

— Ballist?

— Turp me rrejtë. Ballist jo, po andej kam anuar.

— Sa herë na qëllove?

— Unë? Asnjëherë.

Dikush po rregullonte urët e zjarrit, flaka u ngrit përsëri.

— Ç'njerëz ke në shtëpi?

— Nanën, gruan, motrën dhe tre fëmijë, Mos ma digjni shtëpinë, ju lutem, kam fëmijë.

— Kush të tha se do ta djegim?

Në mur u duk pushka e Sherifit. Njëri nga partizanët e rrëmbeu. Tjetri vu re që arma nuk tundej, kur që e varur në gozhdë.

— Ke qëlluar?

— Jo.

— Ja, nuhate, kundërmon barut të djegur, dhe ja vu tytën në hundë.

— Mbrëmjes që shkoi qëllova një ujk.

— Zbrit poshtë, shko te gratë.

Kthina lart u mbush plot me partizanë, kur Sherifi shkoi te fëmijët.

— Na hynë brenda nja dyqind vetë, oj nanë. Për ata mysafirët s'u muar vesh gjë, më duket se u vranë. Tashti atje lart po bisedojnë, më duket se po mbajnë një farë këshille, ndofta për fatin to-

në. Dyshojnë se mos i qëllova edhe unë. Ku dreguin doli ai ujku mbrëmë!»

Fëmijët e shihnin tanë në sy e dridheshin. Gruaja dhe e motra mbanin duart kryqosur mbi gjoks. E ëma kishte lidhur duart me njëra tjetrën.

— Mos u bën merak — foli plaka, — do kalojë, s'ka gjë.

Dikush u afrua afër familjes. Ndezi një shkrepse dhe bëri të vështrojë për rreth:

— Hej, shoku Sherif.

— Urdhëro.

— Ngjitu lart, të kërkon komandanti, unë po bisedoj pak me nënën.

I biri vështroi t'ëmën në sy dhe u ngrit. Motra dhe gruaja fshehën fytyrat pas shoshave të varura në mur, kurse partizani u shti sikur s'i vinte re. Sherifi u nis duke psherëtitur. Ktheu kryet edhe një herë prapa; partizani po përkëdhelte kokat e fëmijëve. Kjo i pëlqeu Sherifit dhe u nis. «Do zoti e nuk na djegin, do zoti e nuk më vrasin. Hej, bela, hej. Çfarë hesapësh po bënin ata mysafirët... s'del jo, s'del hesapi i shtëpisë në pazar.»

Sherifin e udhëhoqën nëpër një turmë të ngjeshur partizanësh. Ata i lëshonin rrugë, ai kalonte me zor, po përsëri kalonte. Kishte aq shumë njerëz nëpër kthinat, sa Sherifi mendoi për më shumë se dyqind vetë. Dhe të gjithë ata (kjo e habiste të zotin e shtëpisë) të gjithë ishin të veshur keq, pa le pastaj këmbët. Sherifi s'po u besonte syve. Disa kishin këpucë, disa opinga, kurse të tjerë, dhe këta s'ishin pak, kishin vetëm lecka e copa mushamash të lidhura dosido nëpër

noçkat dhe pulpët. Një nga këta filloi ta pyesë Sherifin, por ky nuk i përgjigjej pyetësit. Iu duk sikur më i madh ishte ai tjetri, që kishte çizme të shkurtëra nër këmbët. I hoqën vërejtjen:

— Përgjigju këtij shokut që të pyet, jo mua, ky është komandanti.

— Po më habisni, bre burra! E përse komandanti mbathur kaq keq?

— Sepse është komandant dhe është komunist.

«Është komunist dhe mban lecka nër këmbët!»

— Ti, o Sherif Haxhia, a do të vish me ne, të na tregosh rrugën?

— Në këtë kohë zor se kalohet, prisni të gdhihet.

— Ne do nisemi.

— Ka prita, e dini këtë?

— Po, e dimë, ti na udhëhiq e mos na fut në prita.

— Është e vështirë.

— Le të jetë, bëhu gati, po hap sytë, ne s'bëjmë shaka.

Sherifi vu re dy pushkë që i sollën komandantit. I njohu.

— Po ata? — Kjo pyetje i doli vetiu, pa dashur.

— Ata...? I ke aty prapa. U thuaj grave t'i kallin në dhe, kur të hapet dita. Ne s'kemi nge.

Afër zjarrit po mjekonin të plagosurin. Shokët e tij dukeshin shumë të shqetësuar për të. Bisedonin midis tyre, Sherifi i dëgjonte fare

shkoqur: — Nuk mund ta marrim me vete, s'du-  
het të lozë vendit. — Bisedoi komisarri me pla-  
kën e shtëpisë, do ta lemë këtu.

— Ku është goditur? — pyeti Sherifi ko-  
mandantin.

— Ku është goditur... s'ditke të qëllosh mi-  
rë, në shpatull.

— Jo, ju betohem, për besë.

— Kurse pushka jote mban erë barut të  
djegur.

— Ju betohem për besë e për nder, mos ma  
ngarkoni, jo.

— Nuk më thua, sa bashibozukë ka mble-  
dhur Balli këtej lart?

— Me sa di unë, nja njëmijë vetë, midis ty-  
re ka edhe gjermanë.

— Nisemi, eja.

Sherifin nuk e lanë të bisedojë më nge me  
t'ëmën. Veshi gunën, futi një copë bukë në xhep  
dhe u nis.

Ishte përsëri natë. Veriu s'kish të pushuar.  
Dëbora vërsulej poshtë e përpjetë e nuk merrej  
vesh nëse binte apo e pështjellonte era. Mu te  
praku i shtëpisë, komandanti i partizanëve, nën  
dritën e një shkrepseje, vështronte një hartë. E  
afroi Sherifin dhe i foli ngadalë:

— Do të na nxjerrish në stanet e Barit të  
Mirë, por... hap sytë, ne s'bëjmë shakara, çdo  
pabesi e paguan me kokë. Nisu!

Sherifin e mbanin në mes dy partizanë të  
pararojës.

«Hej zot, të qofsha falë. Kaq shpejt e kaq  
pa pritur në shtëpinë time u derdh gjak. Dhe

këta më quajnë mua tradhëtar. Po ai që u plagos, ai shoku i tyre? Ç'është ai? Veç rënkimit zë s'i dëgjova, ndofta nuk është shqiptar, edhe flokët i kishte pak të verdhë.»

Afshin e ngrohtë të shtëpisë ja rrëmbeu murlani, me të kaluar pesëdhjetë çapet e para. Shtërngoi gunën më fort pas vetes. Era rrotullohej përrenjve e nxirrte ca zhurma sikur andej përfyteshin ujqërit. «Të plagosurin ma lanë në shtëpi. Vallë çfarë folën me nënën time për atë! Ku ta dish! Hej, bela, ma lanë në shtëpi. Po nëse vjen e gjen Azis Begu me të tijtë? Do ta therë si berr. Mirë se mendoj për të, po unë vetë? Këta janë të krisur dhe të shitur, mund të ma futin një plumb në kokë; kur t'i çoj në vend s'kam ç'u duhem më. Po sikur të futemi në ndonjë puçi të keqe e të na kapin gjallë, do më vrasin ata që udhëhoqa këta. Hej, dreq! Po sikur t'i zvarris poshtë e lart? Jo, jo, atë s'e bëj, është pabesi, Jo, jo! Më mirë ngordh si qen.»

Kolona e gjatë ngjitej përpjetë, dredhonte, kaptonte përrenj, përshkonte lugina nëpër dimër, nëpër tufan e veri. Në një vend Sherifi qëndroi:

— Dua të flas me komandantin tuaj.

— Ç'ke me të?

— Ju lutem më ndjeni, le të vijë, kam disa fjalë.

Gojë më gojë kaloi fjala. Komandanti doli në krye.

— Që këtu, or zotni komandant, që këtu e tutje, zor se nuk biem në pritë.

— Mos kërkon të na trembësh.

— Jo, për besë. Dje u ngjitën kësaj ane më

shumë se njëmijë vetë, ta thashë. Kishte edhe gjermanë me mitraloza të zinj.

— Do kalojmë, nëse na qëllojnë më keq për ta. Ne do t'u vërsulemi sa të mós gjejnë vërë ku të futen.

— Unë kam një mendim tjetër... dua të shtihem sikur kërkoj cjapin. Shumë syresh më njohin mua, edhe zërin ma njohin, sidoqoftë...

Dhe në atë errësirë të pluhrosur me cikërima të mugta dëbore, zu përhapej një zë i çjerrë, një zë lutës, një zë i vetmuar. Ai zë, në atë rrëmujë tufanesh e ulërimash të bishave, ishte si një zë në shkretëtirë. Sherifit vetë i dukej sikur s'ishte zëri i tij, i dukej zë i pakët, i ngjirur, i ngordhur.

Pastaj veriu nisi ta sulmojë kolonën përballë; s'mund të hidhnin këmbë. Era i shtynte prapësht, sikur s'desh t'i lerë të futen në shtrofkën e saj. Doli urdhër për çlodhje. U ulën. Rojet afër Sherifit diç përtypnin. «Dreq o punë, ç'djall hanë kështu? U kërcasin dhëmbët sikur përtypin halica.»

— Na, do? Të hahet?

— Ç'kini kështu?

— Merr...

Partizani i lëshoi në dorë disa kokrra.

— Kafe? — pyeti Sherifi.

— Jo, çokollata, — ja ktheu me inat roja.

Ai i vu në gojë. Ndjeu shijën e misrit të pjekur. «Pofka». Futi dorën në xhep të gunës dhe qiti bukën.

— Më dha nana pak bukë, na...

— Bukën e tradhëtarëve s'e hamë ne.

— Pse, tradhëtar jam unë?

— Po ç'je ti? Ke edhe sy e faqe të flasësh, na qëlluat.

— Për besë, jo.

— Nga frëngjit e tua, shokët e tu na shtritën përdhe Skënderin.

— Skënder e quajnë atë?

— Po ç'pandeh ti se e quajnë?

— Edhe djalin tim të vogël e quajnë Skënder. «Hej, si u ngatërrua kjo punë, mua më quajnë tradhëtar, bukën s'ma kapin me dorë.»

— Mua më quani ju tradhëtar, po a e dini se edhe për juve thonë se jeni tradhëtarë.

— Ne e dimë që thonë, le të grijnë sa të duan.

— Bile thonë se jeni të shitur.

— Ashtu? Po te kush?

— Ku e di unë, te të huajtë, kështu thonë. Më fal që të them, po kështu kam dëgjuar.

— Po me se jemi të shitur ne?

— Thonë se me pare flori.

— Ashtu? Prandaj hamë pofka ne... Po kësaj nate, o Sherif, a dilet për pare? A shitet lëkura për flori, o Sherif?

U vunë përsëri në rrugë. Kalonin nëpër pyll. Sherifi zgjidhte udhën e kaq herë koka iu përplas pas aheve. Pa pritur, në errësirën përpara u dha një formë e zezë sterrë, e madhe, e shëmtuar. U bëhej sikur një shkrep mali u ngrit befaz në qiell, u zgjat e u ngrit përmbi ta gati t'i shtypë, gati t'u hidhet sipër. Dy partizanët shtangën një çast dhe shtërnguan armët.

— S'është gjë, foli Sherifi, është një re mjergulle. Në qoftë e madhe do ta kemi pisk. Kalojmë.

«Vallë për ku janë nisur këta njerëz, a ësh-



të në terezi komandanti i këtyre? Kjo do të jetë ajo çeta e madhe, për të cilën më folën mbrëmë ata merhumët.»

— Ndërrohuni, — erdhi një urdhër që pas. Erdhi pararojë një tjetër grup. Njëri prej tyre pyeti:

— Ky është udhëheqësi?

— Po, kijeni kujdes!

Që prapa dëgjohen zëra. Nga ndërrimi, kolona i ishte afruar tepër pararojës. Dikush pëshpërit:

— Sikur në këtë qahmet të kishim mundësi e t'ja merrnim këngës... e di sa mirë kalohet.

«Ky qënka fare i çmëndur. Njerëz të çuditshëm. Po ku shkojnë vallë? Për cilin ka ardhur fundi e do t'i vërsulen? Më duket se shkojnë t'u ndihin shokëve. Po ku, se?! E dëgjova këtë apo e mora me mënd? Më duket sikur e dëgjova, sikur pëshpëritën nja dy atje te shtëpia ime. Thuaj ç'të duash, po të kesh shokë të këtillë... hë?»

Marshimi i vështirë nëpër natë e dëborë vazhdoi edhe nja dy orë, kur përsëri erdhi urdhëri që pas gojë më gojë: — Qëndroni për çlodhje.

U dëgjua zhurma metalike e këmbëzave të mitrolozave. Sherifi e mori me mënd se ata zinin vend për çdo të pa pritur. Të dy partizanët e morën Sherifin në mes dhe u ulën. Të tre dukeshin si një perusti e errët mbi dëborë. Shquanin veç format e trupave të tyre e asgjë më shumë. Këtu ngrica ishte më e fortë dhe dëborë filloi të bjerë shushuleq. Kokrrat e ngrita u përcëllonin veshët e fytyrën. Për anash, tütje, angullin ujqër. Një nga partizanët e pyeti:

— Si të quajnë?

— Sherif, Sherif Haxhia.

Ata nuk e pyetën më, por ai desh të fliste me ta, i pyeti.

— Oj burra.

— Folë.

— Si është e mundun që ai komandanti juaj, s'ka këpucë?...

— ... Po ne s'kemi të gjithë këpucë, vishemi e mbathemi si mundemi, pastaj ai është komandant dhe komunist, duhet të japë shembëll edhe për ne të tjerët.

Me kaq dhe përsëri ata heshtën.

— Po a jeni lodhë, o burra?

— Lufta kështu e ka, nuk ta shtron njeri gati, o Sherif.

— Çfarë me shtrua?

— Tryezën.

— Për çfarë tryeze e keni fjalën?

— Për Shqipërinë, o Sherif. Na e kanë zaptuar të huajtë; ballistët po u ndihin të huajve që të na shtypin e të na shtrydhin.

— Po gjermanët thonë se me të mbaruar lufta do ikin.

— Pooo, sa të na kapin mirë për fyti. Ne, o Sherif, do ta çlirojmë Shqipërinë edhe nga të huajt edhe nga bejlerët. Jetë është ajo jotja, rron i vetëm në majë të malit dhe fle në një kthinë me kafshët!

Papritur u dëgjua zhurma e një daulleje përpara. Dy partizanët u çuan, komandanti rëndi me një herë aty. Edhe Sherifi u ngrit. Komandanti i vu dorën në sup:

— Ku ndodhemi?

— Besa... s'ma merr mëndja të kemi ecur  
kaq shumë, por... duhet të jemi afër Bushit,  
pranë stanit...

— Ç'është Bushi?

— Katund, këtu pa tjetër kanë prita ata...

— Sa shtëpi ka Bushi.

— Tetë.

— A ka kasolle të tjera?

— Jo, veç tetë shtëpi.

Qëllesat e daulles hera-herës largoheshin e  
s'dëgjoheshin fare. Komandanti dha urdhër aty  
për aty: — Shokë, shpejt në formacion luftimi,  
gati për sulm.

Sherifi e gjeti të udhës të ndërhyjë.

— Më fal zotni komandant, po...

— Ç'është?

— Ta dini vetë, ata janë shumë, janë më te-  
për se ju, kanë edhe gjermanë, kanë edhe asish,  
mitroloza të zinj.

— Le të kenë edhe djaj me brirë.

Sherifit i kaloi mëndja te shtëpia, te femi-  
jët, te nëna... «Ja, tashti e kam një rast të iki.  
po... e kam.» Por ai nuk u vu të iki; i erdhi turp  
dhe ecte bashkë me të tjerët. Ecte, zvarrisej, fu-  
ndoste e shkulej nga dëbora.

Disa si pece të kuqe e vulosën errësirën, pas-  
taj u dëgjuan krismat e armëve, thirrje, gjëmi-  
me bombash, urdhëra. Daullja as pipëtin. Fish-  
këllima plumbash i kaluan Sherifit përmbi krye.  
copra dëbore iu derdhën nga drurët; u rrëzuan  
edhe ashkëla, u çapluan edhe degë. Sherifi u  
zhgrrye kaq fort e kaq nxituar në dëborë, sa  
trupi i tij i çeli vetes një gropë dhe u struk në të.  
Lufta u ndez me tërsëllëmë, por sa vinte shkonte

më tutje dhe fare pa pritur e pakujtuar armët pushuan. U dëgjuan klithma grash.

«Oj, sa afër Bushit paskemi qënë!»

Sherifi nxitoi pas të tjerëve dhe hyri në fshat. Një mullar po digjej dhe flaka e tij ndriçonte shtëpitë e rënduara nga dëbora. Hyri në një shtëpi. Në kthinën e saj të parë ai vu re një partizan të plagosur shtrirë afër zjarrit. Dy shokë të tij i rrinin sipër, lekat e bardha me të cilat i kishin lidhur gjoksin, sa vinin e po skuqeshin më fort. I plagosuri vari kryet, pastaj i doli gjak edhe nga goja, pastaj dy shokët e tij i varën krahët poshtë. Por Sherifin nuk e lanë të qëndrojë, dikush e kapi për supi dhe i kërkoi të niset përpara. Kaluan nëpër rrëmujën e fshatit, nëpër vargjet e robërve, nëpër grupe partizanësh, që mbushnin çantat me fishekë e konšerva. Sherifi e kuptoi se ata, në atë sulm aq të rrëmbyer, patën kapur plaçkë lufte.

«Çfarë trimash këta djem, i morën nëpër këmbë gjithë këta burra, gjermanë e vendas.»

Në tremën e një shtëpie, nën dritën e një pishtari disa partizanë po çanin në copa një lëkurë të madhe kau, një tjetër po priste mjekrën e tij të gjatë, me një gërshërë prej atyre që qethin delet. Pastaj Sherifi vu re një grumbull të zi, disa gjuhëza flake ndriçonin që nga mullari përmbi shtëpinë dhe ai dallooi se grumbulli i zi ishin robërit e kapur. Ktheu kryet nga ana tjetër. Nuk donte t'i shihte e ta shihnin. E nxorën jashtë fshatit, dhe Sherifi u tremb:

«Ku më çojnë kështu? Medet! Tashti do më vrasin. O zot, të qofsha falë, do të më vrasin... do të më vrasin... oh fëmijët e mi». Nëpër mu-

gëtirën e agimit ai shquajti dy njerëz që prisnin.  
«Qënka komandanti».

— Zotni komandant, ju lutem, aman mos më vrisni, unë mund të ikja nëpër rrëmujën e luftës, po... ju lutem, kam fëmijë!

— Nuk të vret njeri, po përse nuk ike?

— Më vinte turp me ikë si hajdut.

— Ashtu?

Të dy partizanët hodhën vështrimet mbi njeri tjetrin aq sa mund të vështrohej në atë muzg. Heshtën një çast.

— Si thua, o Sherif, a po vjen më tutje?

— Deri këtu e kishim fjalën, zotni komandant, kam fëmijë.

— Po pse, ne s'kemi fëmijë?

— Pastaj këtej lart, s'ka më prita.

— Pse?

— Këtej as ujku nuk qëndron më e jo pastaj njeriu.

— Ku e di ti se nga do kalojmë?

— E marr me mënd.

— Ti ja fut kot, mund të kthehesh.

— Pastaj ju kini kapur robër plot, ata e dinë...

— Ata janë robër, s'kemi besim.

— Po ju thatë se edhe mua më kini rob...

— Ndryshe je ti, ti je njeri i gënjyer prej tyre. Nëna jote është grua që s'e ka shoqen, na e mbajti shokun tonë në besë!

— Po pushkën a po ma jepni o burra?

— Merre.

Ata i dhanë dorën, e falënderuan, e quajtën «shoku Sherif», pastaj u ndanë. Sherifi bëri drejt tatëpjetë. Kalonte nëpër një zabel që e hante ve-

riu, dëbora qe e fortë dhe e mbante sipër. Në një vend qëndroi dhe vështroi pas. Lart, nga maja e malit, po mblidheshin re të dëndura e të zeza si tym pishe. Zbrazi frymën dhe vështroi pushkën, nuk ishte arma që i patën marrë. Kjo sapo qe kapur në luftë, pushkë gjermani. Ai e kishte patur patickë nga të Italisë. Përsëri ktheu kryet prapa. Tashti përpjetës së malit dukej vargu i luftëtarëve dhe ai vargan shtrihej lart si një shigjetë. Te pararoja dikushi afrohej e atëhere ajo kolonë dukej si një flamur i ndërë mbi bardhësinë e dëborës.

Drita u hap fare. Përsëri vështroi pushkën, bëri ta çelë llozin. Punë e kotë, kishte ngrirë nga acari. Dalloi një vënd ku era kishte gërryer dëborën. E arriti. Për toke kishte arabeska akulli situar me cikërima të bardha. Ja, një gur. Bëri ta çkulë, por s'mundi. E qëlloi me shqelmë, por i theri një dhëmbje në majë të gishtave. Toka e ngrirë kallkan s'e lëshonte gurin. Atëhere Sherifi shkuli brezin e tij të leshtë dhe me të fërkoi hekurin. Llozi u çel. Pa pritur, Sherifi ra në rrugën nga pat ardhur.

«Tashti do ta kem më lehtë, këtej është tatëpjetë dhe rrugën ma çelën këmbët e gjithë atyre partizanëve...»

Mendimi iu pre në kokë, sepse një dridhmë i kaloi nëpër trup. U praps, pastaj u afrua, u përkul, u kërrus, ra më gjunjë. Mbi monopatin e bardhë, mbi format e ngatërruara të dëborës së ngjeshur, të gatuar, të përzierë, ai shihte gjak. «A kishte kolona të plagosur? Jo. Oj nana ime... gjak djemash, gjak partizanësh, gjak këmbësh të enjtura, të zbathura, të çara...»

U ngrit, ecte përmbi monopatin, vështronte në

të. I vinte zor të shkelte nëpër atë dëborë të gatuar me gjak. Ecte i kërrusur nga krahu i tij i majtë dhe vështronte...

«Hej, zot, çfarë djemash, çfarë burrash, si nuk dëgjova të ankohej njeri! Po ai që desh të këndojë!»

Një gjëmim dauulleje u ndje më poshtë, por fare afër. Ai ndjeu nevojën të fshihet. Rendi në pyll.

Te kthesa filloi të dukej kolona që ngjitej. I dallonte fare qartë. Në krye ecte një qen me maskë në hundë, për zinxhiri e mbante një gjerman, dylbitë i vareshin në gjoks, pastaj varg ballistë, gjermanë, xhandarë. Daullexhiu qëllonte mbi lëkurën e tendosur, por shihte anash i frikësuar. Midis tyre Sherifi dalloi edhe një hoxhë me mjekër, me sarëk të bardhë, me xhybe. Hoxha mbante nër duar një flamur kuq e zi, e mbante si ta kish hu, hedhur mbi sup. Sherifit i vinte të dalë përballë tyre dhe t'i përqueshte, t'i tallte.

«Përse më duken kështu këta njerëz? A thua se këta mund t'ja dalin me ata djema? Jo, për besë, jo. Ata të dërmojnë kur të duash dhe... të gjithë ishin shqiptarë, të gjithë. Ama, mirë thoshte baba kur qe gjallë: shih, përgjo, dëgjo e pastaj mbush kokën.»

Karvani me gjermanin në krye vijonte të ngjitej përpjetë, ngadale e me nge. Sherifi priti sa kaluan e përsëri u vu në rrugë. Tashti kishte një brengë në shpirt: si do ta gjente vallë mikun që lanë partizanët?

Ai nxitonte dhe rendte tatëpjetë, por i vinte zor të shkelte atë dëborë të gatuar me pika gjaku.

Afër mesditës, që lart ai dalloi shtëpinë e tij. OXHAKU tymoste fort. Te burimi takoi t'ëmën që mbushte katrovat me ujë.

— Gjallë është ai miku?

— Po gjallë e shëndoshë. Dale të të puth një herë, ta kisha frikën...

— A i varrose ata?

— Po.

Hynë në shtëpi, Sherifi u ngjit drejt e lart. Afër zjarrit, pështetur në kënd, ai pa dy sy gëshstenjë, të mëdhenj, të butë.

— Oj nanë, t'i japim një masë gjalpi të ngrohët, ta pijë.

— Ja dhashë vetë.

Djali i vogël i Sherifit rrinte te vatra, i ati u ul më gjunjë dhe pyeti mikun:

— Si dukesh?

— Do kalojë, po shokët e mi... gjer ku i çove?

— Deri në Bush, ramë në luftë, ama çfarë djemash trima, për besë, një sulm dhe i dërmuan...

— Patëm humbje ne?

— ...Ne nuk patëm humbje, dale... një shok...

Sherifit i mbet fjala në buzë. U habit që fare pa dashur, pa ditur, vetiu pat thënë «ne». Dhe kur partizani ngulte këmbë dhe kërkonte të mësojë më shumë për shokët, për sulmin, për humbjet, Sherifi s'po e mblidhte dot veten...

— Jo, emrin nuk ja di, e pashë në krahët e shokëve, kur po mbaronte, por ç't'i bësh? Lufta kështu e ka, edhe humbje do të kemi...

Jashtë veriu ulërinte dhe borë binte gjithnjë.



## MULLIRI I TRIMAVE

Më të dalë të Kapizës, aty nën lumë, në mes të një ormani me shelgje e plepa, në mes të një toke të lagësht e të mbuluar me bar të shkurtër e barishte të gjata, duket sot e kësaj dite një gërmadhë. Njeriu mendon se do të jetë batisur vendi e do të jetë shëmbur mulliri. Por e vërteta s'është kështu. Ata gurë të zinj e të lyer me blözë, ato plloça të dërmuara e të mbuluara me myshk, kanë një histori të tyren. Atë mulli nuk e ka shëmbur koha, porse lufta.

Sot pas njëzet e sa vjetësh, atje të ze syri shenja, që kanë të bëjnë me predhat e gjermanit. Vendin apo gërmadhën e quajnë sot, Mulliri i Trimave.

Kur dëgjon njeriu këtë emër, do të hedhë sytë aty rreth e qark të shohë ndonjë lapidar në kujtim dëshmorësh. Por lapidar atje nuk ka. E vërteta është se ai mulli ka një histori pak të çuditshme. Lexojeni dhe, ju flas me të drejtë. këtu s'ka gjë të shtuar.

Në batalionin tonë ne kishim, midis të tjerëve, edhe dy shokë: Hysenin gjashtëdhjetë e

sa vjeç dhe Josifin aty rreth të njëzetave. Duket si habi që këta qenë shokë, kur nga mosha ishin kaq larg. Por lufta ka disa veçori, disa rregulla të saja jo të zakonata. Sidoqoftë këta të dy ishin shokë e s'ndaheshin edhe në marshimet, edhe në baza, edhe në luftë, qoftë edhe në uri. «Si Kolja me Deden», qeshte ndonjëri me ta dhe ata nuk zemëroheshin.

Vjeshtës së dyzet e tresë, kompania e tyre, gjatë kalimeve nga një fshat në tjetrin, u ndodh në Kapizë. Kompanitë e tjera, ku isha edhe vetë, ndodheshin gjetiu. Ishte një vjeshtë e vonë, por dëbora edhe s'kishte rënë. Sa për të ftohët mos pyet, toka që bërë kallkan. Asaj nate, Hyseni e Josifi u lajmëruan se radhën e rojes e kishin pas mesnate. Dhe kur shkoi përgjegjësi t'i zgjojë, i gjeti gati. Ata zbritën shkallëve, dolën në rrugë dhe u nisën.

— E dini vendin?

— E dimë.

— Po parullën?

— Edhe parullën e dimë, po ti shko ku ke punë.

Ecnin të kuspullosur nga e ftohta dhe çapet e tyre dëgjoheshin fort, sikur shkelnin mbi pllaka hekuri. Hyseni kishte një pushkë gjermane, kurse Josifi, djalë i ri, trim dhe i shëndoshë, mbante një mitroloz italian. «Breda». Gjatë rrugës nuk flisnin se, përveç thellimit, sapo qenë ngritur nga gjumi, pastaj Josifi e ndjente më fort prerjen e gjumit. Kur dollën përmbi mulli, i ndaluan.

— Parullën!

Josifi u përgjegj sipas rregullit, me kundërpullën, kurse Hyseni ja ktheu pak rëndë me një: — E, mo, eee..., ne jemi.

U futën në mulli. Atje vinte erë myk dhe miell misri. Sa për të dukur, atje s'shihej asgjë nga errësira e natës. Shokët që linin rojen u treguan dritaren përpara; një dritare e gjerë karshi gurit të madh, që nga hynte një dritë e mjegulluar e që ku delte pahu i miellit.

— Vend i shëndoshë, — mërmëroi Hyseni, — vend për pusi, për luftë. Po përse ky djall mullisi nuk e ka kthyer ujën? Po kjo ç'është, o?

U dëgjua tingulli i një kombore të vogël e disa thundra kafshe, që trokëllisnin në patoz të mullirit.

— Është kali i mullisit, s'ka ndonjë orë që mbaroi së bluari e kalin e la këtu.

Të dy partizanët e parë ikën. Hyseni nxori shaminë e iu afrua kafshës, duke ndehur përpara duart. Kishte frikë mos hante ndonjë shkelmë dhe i foli kalit me kërcënim: — Ush, o, i shkretë! — E kapi për jele dhe ja vulosi këmborën, që të mos dëgjohej.

— S'bëhet roje duke i rënë komborës, jooo!

Josifi nuk iu përgjigj, por gogësiu e Hyseni e urdhëroi të dalë përjashta e t'u hedhë ujë syve.

— Jo, jo, s'vihet ujë në fytyrë në këtë ciknë.

Por shoku s'iu nda dhe Josifi e dinte që, kur ngulte këmbë Hyseni... Iu bind e doli përjashta. U kthye duke përpjekur këmbët e duke fshirë fytyrën me pëqinë e kapotit. Zhurma e ujë-

rave, që binin te penda e përplaseshin te pengorja, s'kish të sosur. Ata po kalonin çap e jak nëpër mulli, kur Josifit iu bë sikur dëgjoi një diçka si shkarje. Ngulën vështrimet nëpër dritaren e gjërë. Asgjë s'mund të dalloje. Nata ishte e plotë, retë ishin të ulura e s'dukej. Vunë veshin. Zhurma e parë u përsërit, pastaj dëgjuan qartë një bisedim me zë të ulur. Por tashti ishte açik: ata që bisedonin, flisnin gjuhë të huaj. Këtu s'kishte gjë për të pritur. Ngritën armët dhe qëlluan. Bataretë e mitrolozit s'kishin të pushuar dhe Josifinisi të ngulë e shkulë karikatorët.

As një minutë nuk kaloi dhe të dy partizanët morën përgjigjen. Plumbat e gjermanëve filluan të fishkëllojnë aq të dendur aq të egër, sa ata të dy, kokat i mbanin prapa murit e vetëm qëllonin. Duhej mbajtur zjarr i paprerë, duhej vonuar armiku, u duhej dhënë shokëve kohë. Kjo ishte e gjitha. Pas pak ata dëgjuan mitrolozat e kompanisë, dëgjuan thirrjet e shokëve, që u jepnin zemër, por më tutje gjithshka u përmbys dhe ata s'mund të dëgjonin asgjë. Armiku, i ndodhur përpara një zjarri të dendur, zuri vend dhe filloi të rrahë me mortaja të rënda. Dhe i gjithë barazhi i tyre u drejtua te mulliri. Predhat e para goditën më prapa, por të tjerat u afruan më këtej, dhe të dy partizanët e kuptuan se ishte e pamundur të mbanin vend te dritarja. Të delnin, ishte punë që s'bëhej, sepse porta ishte pikërisht kundrejt vendit, që kishte zënë armiku.

— Pas meje, — urdhëroi Hyseni.

Tashti, nga dritat e shpërthimeve, shihnin ku ishin e ku zvarriseshin. Te pengorja e ujërave Hyseni futi këmbët dhe u lëshua tatëpjetë, kapi

boshtin e saj, u mbajt pas saj, shkau nëpër të; pas tij edhe Josifi. Ky e pati më zor, sepse mitrolozit i kishin ngelur këmbëzat të çelura; mezi e çkuli nëpër brimë. Shkelën nëpër pendën që dridhej, currilat e dendur i qullën kokë e këmbë, por në ato çaste as e kishin mendjen në to. Cepikët e akullit u thyheshin nëpër këmbë, e ftohta i bëri të dridhen, të fërgëllojnë e të shkuenden me gjithsejt. Të strukur në atë brimë, Hyseni desh t'i tregonte shokut se ajo farë kubeje kishte një tavan të fortë, që mund të mbante goditje të rënda pa u shpuar, desh t'i jepte zemër, desh t'i fliste diçka, por në luftë s'ka fjalë, s'ka biseda. Në luftë njerëzit kuptohen, merren vesh me një shenjë, me një vështrim, me një përkitje.

Rrahja e mortajave që aq e egër mbi mullirin, sa e gjithë toka dridhej. Në një çast edhe kali aty sipër filloi të shkrofëtijë Ajo qënie e gjallë medoemos i pa partizanët që zbritën poshtë, ndofta edhe kafsha desh të ikë, të zbresë, të çajë diku. Kali qëllonte patozin me shkelma, mihte, turfullonte e hingëllinte me potere. Por fare pa prituri mulliri u shemb. Ishte një zhurmë e madhe e egër, një rropamë që e shkundi tokën për rreth e për një çast, nga ajo përmbysje e çatisë e nga çvendosja e ajrit, ata ngelën pa frymë. Atje sipër, kali hingëllijti me një rënkim të mbytur e të zgjatur. Pastaj kadet u çanë, ujërat vërshuan nëpër gërmadhë, zbritën që nga guri nëpër brimën e pengores, kubeja e poshtme u mbush; nëpër errësirë ata kërkonin një copëzë vendi më të ngritur, por uji i mbështolli, i për-

mbyti, u arrijti në gjunjë, në brez e gjer në gjoks, sa merrnin frymë me të vështirë. Josifi mendoi se u erdhi fundi, iu lëshua Hyseni e për-gafoi, e shtërngoi, e puthi duke gulçuar, por pa folur, pa bëzajtur, pa psherëtitur.

— Mbaruam...

Por plaku e qëlloi në ballë me dorë:

— Pusho, mor hajvan! Shpëtuam! Vendi u mbulua me gurë edhe të duan gjermanët s'mund të vijnë këtu.

— Po zjarri?

— Ujërat s'lenë zjarr.

Ujërat filluan të bien poshtë e më poshtë, tashti vinin pak e më pak, sepse vrulli i parë qe ai i kadeve të mbushura, që u shkatërruan nga predhat. Por ata i mundonte e ftohta, një ngricë e një dridhje, së cilës s'mund t'i qëndronin. Atëhere nisën të kërcejnë në vend, filluan të fërkojnë në njëri tjetrin, në kohën që, nëpër disa brima përpara nga iknin ujërat, filluan të hyjnë shtiza të holla drite. Jashtë kishte dhënë mëngjezi. Rrahja e mortajave kishte reshtur kundër mullirit, por më tutje lufta ziente e valonte. Zhurmat e saj dëgjoheshin më tutje, por thirrje në gjuhë të huaj ata dëgjonin aty më sipër dhe kjo i bën-te të heshtin dhe të durojnë gjëmën e të ftohtës, që therte e priste. E merrnin me mend se gjermanët do pandehnin se ata ishin vranë, në mos nga predhat, por të paktën nga përmbysja e mullirit.

Josifi qëndroi dhe i vu dorën në sup shokut të vet, afroi gojën e vet te veshi i tij dhe i pësh-përiti:

— Dëgjon? Ky që rreh këtu afër është mitrolozi ynë, është Bredë, gjermanët nuk mbajnë armë të huaja.

— Mund të jenë ballistë, prit.

Dhe në çast çdo gjë u sqarua! Partizanët ishin aty, zërat e tyre shquanin .Hyseni dhe Josifi kuptonin zhurmat e sulmit, thirrjet shqiptarçe me britma e kërcënime:

— Me dorë, ore! Me dorë!

Një tufë partizanësh po silleshin qark mullirit të rrëzuar. U dëgjua një zë:

— Hej, shokë, këtu është varri i trimave tanë!

— Do t'ua marrim hakun.

— Luftuan si burrat!

Pastaj u afrua një zë tjetër:

—Tatëpjetë vura re ujërat e mullirit, kishte edhe shenja gjaku.

— Duhet t'i zbulojmë!

Dhe pa pritur ata dëgjuan një zë të nëndheshëm:

— O Zalooo! O Zalooo!

— Vasil, o vëllaçkoo! Jemi gjallë, gjallë... por shpejt na hiqni gurët, se jemi gull dhe po ngordhim nga e ftohta, gurët hiqni, gurët...

## KUR HYNTE DRAPËRI NËR ARA

**A**saj vere, pa hyrë drapëri nër ara, fshati im e kishte një zjarrllëk të madh. Në çesmet ku mbushej ujë a në kishë ku meshonte prifti, gratë me be e rrufe thërrisnin e bërtisnin, sikur fshatit i kanosej flaka e zjarrit, ose i vërsulej lumi i Devollit.

Them gratë, sepse asaj kohe burrat dhe djemtë hanin kurbet tutje vëndit, nëpër malet e botës, kur sharronin dru e digjnin qymyr. Fshati rrallë e tek e kishte ndonjë burrë (por edhe ai ndonjë sakat), kurse gratë, nusët dhe çupat përbënin shumicën dhe peshonin më shumë në punët e katundit. Për punë burri nuk duhet harruar edhe kryeplaku, por këtë s'e futa nër burrat, sepse zotëri e tij ishte një mësallë me dy faqe, që rronte me ngatërresa e dallavere, që nga ryshfeti e tatëpjetë.

Ka qënë kohë, kur në qytet na shiteshin të dhjetat e katundeve. Bejlerë e agallarë, afendikonj e tregëtarë me miq e me tarafe, me para të thata në dorë e me të tjera nën dorë, rrihnin kush e kush të rrëmbejë atë fshat më të madh, që i



kishte grunjërat më të mbara, atë tjetrin që ishte plot me vreshta e s'i kishte rënë filoksera, atë më tutje që kishte selishta e pemishte, e kështu me radhë.

Jashtë kësaj valleje gjëndeje vetëm Myftar aga Pollonica <sup>1)</sup>, i cili vërtet djalë, nip e stërnip dhjetari (duket nga mbiemri), po i habiti shokët e vet atje, në prefekturë, kur kërkoi të blejë vetëm fshatin tim.

— Po ç'bën o derëzi? — i folën disa, — ai fshat është i largët...

Myftar aga Pollonica nuk qe përgjegjur fare, por më vonë u muar vesh se atij i pat shkarë syri jo vetëm pas tokave tona, por edhe pas gjithë asaj grarie, që mbushte plot e përplot fshatin tim. Pra, agai na e kishte dëshirën që, në një farë mënyre, të futte edhe gratë në «të drejtën e shenjtë të së dhjetës shtetërore».

Sikurse spiegovala më lart, fshati ishte si në ethe. Kjo ndodhte sepse gratë ndër ne e kishin vendosur ta blejnë vetë të drejtën e së dhjetës, fshatçe. Për këte u shkruan kartëra e lutje, u mblodhën pare portë më portë, u thanë fjalë e u futën miq, por më kot. Llambro kryeplaku nuk donte, se kështu i pritëshin thonjtë dhe prefekti dha një përgjigje të prerë: «Duhet dyqind napolona flori të numërohen menjëherë!»

— Po Myftar aga Pollonica a i paguan në dorë të gjitha?

— Atij ja lejon ligji të paguajë më vonë, se-

---

1) Pollonicë-a = Masë e vjetër gruri.

pse atij si njeri me kamje, me nder e me oxhak, shteti i beson dhe i jep kredi.

«Në këtë fshat të malësisë — mendonte Myftari, — mund të rrëmbej më shumë, se këtu përveç bereqetit ka bletë sa të duash, raki me bute, qereste pa masë... Pse të mos e fus edhe gjënë e gjallë në hesap?... Kush do ma mbajë dorën? Rrëmbe të rrëmbejmë e kur të vijë fundi, ata shokët e mi do të ma kenë zili.»

Kështu, një ditë na çatisi në fshat Myftar aga Pollonica, hypur mbi një gomar mashkull. Pas tij vinte ndihmësi i tij, një djalë nja njëzet vjeç, që e quanin Liçi. Sa kaloi urën e madhe të lumit, gomari i agait, i mbuluar me shilte të kuqe, me lëkurë dosbale në ballë e me kapistër zinxhiri nën hundë, ja lëshoi pallmës së tij me potere, duke na dhënë kështu atë lajmin e keq të arritjes së dhjetarit.

Myftar aga Pollonica ishte një burrë nja pesëdhjetë vjeç, i trashë dhe i qullët, me një fytyrë bullafiqe, ku më fort binte në sy hunda e tij e vogël, por e kthyer si sqep. Nën atë hundë të përskuqur kishte një palë mustakë si rrënjë preshi, që i krihte mesit me krëhër për tatëpjetë, e u hidhte pika vaji anash që t'i ngrinte përpjetë. Asaj kohe, si gjithë njerëzit e sërës së tij, Myftari mbante rroba prej stofi kaki, pantallona qillo-ta me kopsa të zeza në pulpë, një feste të kuqe në kokë, këpucë të zeza me një xhufkë në majë, por s'mund të harrohen çorapet e tij, që binin shumë në sy: i kishte prej leshi, të murme dhe në thembrat të pecosura me vaçetë. Sahat e qostek nuk mbante zotëri e tij, por kishte një

zakon (e spiegonde si trashëgim nga pleqtë): herë pas here mbyllte njërin sy, shtrembëronte njërin buzë dhe ngrinte vështrimin nga dielli për ta pikasur se ku ndodhej.

Por ju lutem të më ndjeni, se kam ndër mend ta tregoj ngjarjen për fill e për pe, me të bardha e me të zeza, ashtu si ndodhi me të vërtetë. Më duhet t'ju them se zotërinë e tij, dhjetarin, e njihte fshati që aty e nja dhjetë muaj më parë. Atëhere Myftar aga Pollonica na pat ardhur në fshat për një brengë e një nevojë. E kishte zënë dhëmbja e një arpallëku në shtëpinë e një miku, në një katund aty afër. Dhe ky mik i pat treguar se në atë fshatin tonë «na qënkesh një Nurçe, Nurçe që besa-besën vërtet ka një darë të rëndë, por dorën e ka të lehtë, të lehtë e jo sikur të çkul dhëmb, po sikur të heq një fije floku».

Në këtë rast u bë takimi i parë i agait me fshatin tim. Ama edhe Nurçja (të themi atë që është) vërtet sakat, me një dorë (tjetrën e kishte lënë në maqinat e Evropës, kur mprehnin thikat), por dorën e saktë e kishte të mbarë shumë dhe kishte fituar emër atij Devolli e gjer tutje asaj Kolonje për punë dhëmbëtari dhe xherahu. Mu atje, përpara kosheres së dhjetarëve, në mes të fshatit, vendosi një stol nën strehët dhe nxori atë darën e mbështjellë me një shami të kuqe, prej atyre që mbulonin foshnjat në djepet. Agai u ul aty dhe hapi gojën sa një kamare me sytë nga qielli. Nurçja ja rrahu dhëmbët një për një me një bigë të darëve, gjersa agai bërtiti: — Aaa!

— Duket o aga, njihet që atje tej, se të kamarrë pikë të zezë. Më të poshtëm e ke, është më lehtë edhe për ty edhe për mua, po prit ca.

Myftari u mbllaçit një herë, shkundi kryet e pështyti:

— S'ka për të pritur, po hiqma, se vallahi bilahi më lojti tepeleku i kokës.

— Jo, jo, — ja ktheu Nurçja, — dale të vijë pojaku të të mbajë kryet.

Myftari u përngrit i prekur në sedër:

— ..pse? ç'më pandeh mua ti? Të mos duroj dot çkuljen e një dhëmbi, e di ti ore se cili jam unë? Hiqma se unë s'jam si këta! — E tregoi me dorë çunat që vinin atje rrotull.

«Pas kokës edhe festen» mendoi Nurçja dhe iu qas.

— Hape gojën! — Tjetri u bind. Ja kapi dhëmbin me majëzat e kthyera të darës, një herë ja shtërngoi fort, që të mos shkiste hekuri pas koskës, por agai bërtiti si ujk dhe lëshoi një ulërimë e një kujë, sa u ngrit gjithë fshati më këmbë. Çunat ja dhanë gazit e s'mbaheshin dot, duke vështruar atë goxha burrë, që kuiste e lebetitej sikur i shkullnin gurmazin. U mblodhën aty gratë e mëhallës, pastaj erdhën edhe të tjerat dhe i sollën agait një kupë me ujë e kripë. Po me që ishte thyer dita e ai s'tundej dot nga vendi, me që rënkonte nga dhëmbja e ish përplasur në tokë si deng, gratë menduan ku ta shpien... E çuan aty te zonjëza Beronjë, që e kishte shtëpinë fare afër kosheres e buzë lumit. Dhe gjithë asaj nate, Myftar aga Pollonica na qënkesh gdhirë, duke dëgjuar gratë me thash, e themet e ujemet që, të mbledhura në kuvend për të kujdesur zotërin e tij, na tjerkëshin shtë-

llunga, na kënduakëshin këngë, dhe, dashur pa dashur, kujtokëshin edhe burrat e tij kurbeti, që i prisnin të kthehen, por që mbarë s'u bëhej.

Të nesërmen, kur u nis të ikë Myftar aga Pollonica, mbështjellë kokë e faqe me shami, vriste mëndjen udhës e çuditej se si kishte mbetur gjithë ajo femëri pa burra e djem. Bile-bile, me mëndjen e tij ai u paskësh marrë anën e u paskeshe qarë hallin të gjitha grave të fshatit tim dhe një për një. Por (le të jemi të drejtë e të mos mbajmë hatër) më shumë ja pat qarë hallin asaj zonjzës Beronjë, për të cilën na i paskeshe qarë zemra e rënkuar shpirti. Se vërtet dhëmbjen e kishte asaj nate agai, por prapë se prapë i jepte hak atij kaut plak që, kur do ta thernin, iu lut të zotit: «Kur të ma thani lëkurën, të ma hidhni të teret përmbi kurrizin e një mëshqerre».

Dhe me që e kishim fjalën te dita e parë e ardhjes së agait si dhjetar, më takon t'ju tregoj se, me të zbritur gomarin, ai çeli një defter të madh e të zi, ku na qënkëshin të shkruara tokat e arat, vreshtat e livadhet; kumbullat e egra të rakisë, sa edhe trojet e bostaneve.

— Bela e madhe — zu i ankohej kryeplakut, — bela e madhe këtu ndër ju, hajde dhe u merr vesh me gra. Gjetkë ke të bësh me burra, se në fund të fundit burri është burrë. Bela për zotin.

— Sikur s'e shoh mirë zotërinë tuaj, — i foli kryeplaku.

— Ja, vërtet e kam një hall, kam një dhëmb këtu, që vallahi më lojti trutë nga vendi, ju e dini si i kam punët me këta të shkretë... e kur shoh këtë vendin këtu më shkojnë djersë të ftohta...

— Të kishe ca raki, o aga, — ndërhyri Liçi, — rakia ta platit dhëmbjen një me një.

Kryeplaku shkoi gjer në shtëpi dhe solli një shishe raki të mbushur plot e të vulosur me kockë. Kjo ishte sa për njohjen e parë, se më tutje ata do të ishin miq e shokë për kokë, se jo më kot thotë fjala: «rrokulliset tenxhereja e gjen kapakun».

Ishte kjo dita e parë, që kaloi pa ndonjë zhurmë e të keqe, sepse, sikurse ju thashë, drapëri edhe s'kishte hyrë ndër ara. Kështu që afër mbrëmjes, pasi dha porositë e fundit, Myftar aga Pollonica ja hypi sërish gomarit, hodhi një «njatjeta», ja ngjeshi veshëgjatit me mamuz në bark dhe u nis bashkë me Liçin, që e ndiqte pas.

Më në fund hyri drapëri ndër ara. Gra, nuse e vajza u ngritën një mesnate dhe dolën në fushë. Por nuk e nisën me një herë.

— Prisni — fliste ndonjëra më e shkuar në moshë, — prisni sa të shtrohet vesa, se kur njo-men, kallinj të nuk i lëshojnë kokrrat e grurit e drapëri pret më mirë.

Dhe me të nisur puna, edhe Myftar aga Pollonica me sejmen Liçin erdhi sërish dhe e ngriti konakun tek oda, afër hambarit të dhjetarëve, duke pasur përpara atë kaçkën e madhe të fshatit me hijen e saj të rëndë.

Myftar aga Pollonica nuk kishte dëshirë ta thërrisnin aga. Po ta mbiquanin Myftar bej nuk nxirrte zë, por që t'i bëhej qejfi mal desh ta thërrisnin Myftar efendi. Efendi, sepse ai mbante kaq gazeta të kohës nëpër xhepa. Në njerën anë kishte «Akshamin» e Stambollit, në tjetrën «Yxhy-

min» e Ankarasë, kurse «Arbëninë» e Nebil Çikës s'e hiqte fare nga dora. Dhe vërtet, ashtu e shihnin njerëzia, me pagur përpara, nën hien e arrës, me gjyslykë mbi sy e me gazetë në dorë, varur hundët e trashur buzët.

— Ç'thonë, o Myftar Efendi? — e pyeste Llambro kryeplaku.

— Euh, ç'thonë, politikë të lartë thonë! More, po a e di ti? Kjo rakia për punën e dhëmbit një me një qënka!

Dhe kryeplaku, të cilit ja kishte shumë qejfi miqësinë me dhjetarin, për të xhvatur ndonjë fashë e për të lëpirë ndonjë kockë, zu e dërgonte shishen bosh herë këtu e herë atje. Ndodhte që ua kthenin bosh, por ata nuk mërziteshin, e dërgonin përsëri e përsëri, gjersa shishja vinte plot ose përgjysmë dhe me një barrë mallëkime pas. Por këto ata nuk i dëgjonin dhe dhjetari e hidhte fjalën për ndonjë çikë djathë a vezë, për ndonjë cironë të kripur a ndonjë poçe me kos. «Sa e mirë kjo raki e kumbullës zier dy herë (sikur thoshte ai vetë), por... rakia pa meze, si zabitë pa ylyfe.»

Kjo punë e rakisë dhe mezeve ishte si festa e nisjes për Myftar aga Pollonicën, sepse sapo filluan të mblidhen pollogjet në fushë dhe të shtrohen legëtyrat për duaj, ai më s'kishte nge. Shkonte e vinte gjithë ditën arave e lëmenjve, e kur perëndonte dielli ndihej aq i lodhur nga gjoksi e aq i kapitur nga këmbët, sa binte si i vdekur në konakun e kullës dhe fillonte të gërrasë e të çajë dërrasa. Veç në kohë të drekës afrohej te kolibet e lëmenjve.

— Mirsejugjeta dhe ju bëftë mirë!

Por fjalën s'e priste, se kishte ndodhur të mos marrë përgjigje, prandaj aty për aty e shtyn-te më tej:

— Mirë u bën që kurse e hani, xhanëm, po...

Dhe shtrohej këmbëkryq si pa të keq, duke zbuluar një palë dhëmbë të zverdhur nga duhani.

Ndeznë të keqen njerëzia prej këtij miku të paftuar e të pa cipë, po çfarë t'i bënin se.

— Asamani, moj — thërriste një grua andej, nga mëhalla lart, — asamani, moj, bëini një byrek me egjër që ta hajë e të pëlcasë!

Dhe kur niste matja e grurit me shinikët, Myftar aga Pollonica ishte një kusar e një neqez, që as shokun s'e kish dhe as pyeste se ku kishte marrë shishe me raki e ku kishte ngrënë byrek.

Por kaq herë, mu atje te lëmenjtë e kapte Myftarin një mall e një dëshirë, sa e ndjente veten të kallur në pranga e në zëndane. Medoemos këto ishin mendime që vetëm ai i troshaniste në trutë e veta, psherëtinte, kruante kokën e rënkonte si ta kishin zënë ethet e gushtit. Ditët kalonin dhe bashkë me ditët ai po mplekste në kokë ca mëndje e plane që do t'i shtronte jo më në lëmenjtë, që zjenin nga gjithë ajo femëri, nga gjithë ata kuaj e nga gjithë ata kalamanë, që ngisnin kuajt. Planet e veta, Myftar agai vendosi t'i çpalojë e t'i vendosë nëpër arat e fushës, nën hiet e kumbullave, nëpër drurët e krekave, pse jo edhe në ormanin e shelgjeve.

Asaj dite do të ngrinte duajt nga ara Zonjëza Beronjë. Ndryshe ishte emri i saj, por me që ishte pa fëmijë, e hieshme, e ngjeshur dhe e plo-



të, me që ishte e fjalës dhe e shakasë, se kush ja ngjiti: Zonjëza Beronjë, dhe ashtu i mbeti. Ajo s'kishte njeri në shtëpi, sepse i shoqi që tre vjet më parë kishte shkuar në kurbet. I kishte nja tri-dhjet vjet, por nuk dukej aq. Në këtë vit, në arën e saj të vetme kishte lidhur gjashtëdhjetë duaj, dhe për në këtë arë e pat vendosur Myftari volljen e tij. Ishin afruar atje te ara armanxhiu<sup>1)</sup> me një mushkë e një kalë, dhe pas tyre Beronja, kur që nga ferrat e ormanit doli dhjetari:

— Tungjatjeta, o zonjës, si je ti ore, atje? —  
Dhe pa pritur përgjigje: — Më duket se këtu është shkelur nomi e ligji.

— Ç'e ke atë fjalë, zoti dhjetar?

— Fjalën e kam se ti, moj motër, sonte natën ke ngritur duaj nga ara.

— Uuu, ç'është ajo fjalë; mos e dhëntë zoti. Unë s'jam lakute, s'e bëj kabull të vjedh mallë e gjënë time, unë gjashtëdhjet duaj lidha e ja ku janë.

— Ato s'i ha unë, këtu njihet vendi, duajt janë lëvizur.

— Jo, o aga, të betohem për kokën e atij që pres të më vijë nga kurbeti e që punon me sotpatë në duar, të betohem!

— Betohen ata që gënjejnë, po mua s'më ha malli. Pastaj ti, le që e ke shkelur, po ma ngre edhe zërin sikur i thërret fshatit për berihaj...

Këto fjalët e fundit, të lëshuara me djallëzi, bashkë me një vështrim lakmie të lëshuar shkara-zi, bënë që Beronja diç të kuptojë. Në atë çast ndërhyri edhe armanxhiu, po dhjetari ja preu shkurt:

---

1) Armanxhi-u = ai që shin vrahët.

— Ti mund të shikosh punën tënde. Pastaj, që ta marrim shtruar moj grua, më fol drejt, ke ngritur duaj natën apo s'ke ngritur?

— Jo, të thashë një herë.

— Mua s'ma kanë hedhur burra me një barrë mënd e jo pastaj gra, dhe duke vështruar armanxhiun, që nxitoi pas kafshëve shtoi: — Po mua më vjen keq se ne jemi edhe miq, është e mira që ta mbulojmë këtë se bëtet tevatur, si thua? A nuk e mbulojmë, hë?

— Unë s'kam se çfarë të mbuloj, ti mund të grish lakra sa të duash.

— Si the moj? Të grij lakra!?

— Po, ashtu thashë.

— Moj grua, a je në vete ti? Mos u nxeh kështu, se qeveria është qeveri, mos kështu se vijnë gushëkuqët e t'i ngrënë lekat me gjithsejt, se sherri të nxjerr në gjyq e gjyqi do kamje e nge, ti s'je as e ngesë as e kamjes, se ja, unë ditvë në brez e kam. Pastaj ne jemi edhe miq, unë kaq herë jam menduar të ta shpërblej nderin që më ke bërë, po ti vetë ngatërrohesh, vetë, desha të të vij nga shtëpia...

Ndërkohë u afruan atje edhe gra, nuse e vajza për t'u ngarkuar me duaj.

— Me që u gjendëm këtu, le ta mbarojmë punën.

Beronja mblodhi duart përpara dhe e pyeti:

— Folë, sa kërkon.

— Ndonjë killë e gjysmë.

— Një killë e gjysmë? Je dhjetar, apo je gjysmar?

— Po unë kërkoj një e gjysmë që të mar një, moj e uruar!

Një nga gratë, që sapo kishin ardhur, me një kosor e një litar në duar, ndërhyri:

— Ku do t'i futni gjithë këto para, more? Pse nuk mendoni edhe për fukaranë? A e dini, ore, si jetojmë dhe si rrojmë ne? Si s'kini mëshirë, pale turp që s'kini.

Këtu, Myftar efendi u ndje i prekur në sedër. U ul në deng.

— Ja, shiko sa vëngër shikoni e sa gabim flisni. Pandehni se këto haka që marr këtu do të më mbeten për vete? Jo, moj, jo, unë jam në brenjë të madhe, do dal borç e do shes shtëpinë. Dhe po nuk dhatë ju me se do laj unë dyqind napolonat, që u ble fshati? Dhe po të mos paguaj unë me se do mbahet qeveria? A kini dëgjuar, moj, se lartmadhëria e tij, Zogu i shqiptarëve (ai u ngrit me këmbë), u martua? Harxhe të mëdha, dasmë më Evropën, dasmë me krале, helbete të hyra, të dala, darova e ahengje, saze prej Parisi, ardhë krushq me tajare, me pampora.

Përsëri, ajo gruaja veshur me të zeza ja preu:

— More, mirë se ai martohet, po ç'taksirat ne?

— Ç'thua xhanëm? Po a e di ti se e ke mbret?

— Po ai sikur u martua një herë.

— Tyt, moj! Ti s'mban mend me se hëngre bukë. Ajo që u martua ishte princeshë, janë kaq princasha...

— Po pse s'u martuan një herë e mirë, të shpëtonim edhe ne?

— Atje mos fut hundët ti, kur të vijë dita, kësmeti.

— Po ku ta dish, — ndërhyri Beronja, — ndofta s'janë rritur.

Dhjetari u ndje i sëndisur dhe u përngrit:

— Aaa, ti Zonjzë, Perëndia më ndjeftë, sikur don të tallësh.

— Jo, s'u talla, thashë se vallë kanë erdhur në moshë, se po s'erdhi femra në moshë, s'ka si martohet, se sa për të bukura ato domosdo që janë, princesha!... Po... t'i lemë këto, po për hakën si do ta vendosim.

Myftar aga Pollonicës menjëherë i shkrepri në kokë një xixë.

— Lere, moj e uruar, lere, se s'merremi dot vesh, në lëmë...

Kur zonjzëza Beronjë shiu të gjashtëdhjetë duajt, kur vrahu u hodh e mbeti gruri për t'u martur, më kot priti dhjetarin të vijë e të vjelë hakën. Priti më kot, gjersa kaloi atje kryeplaku me një shinik nër duar. Ky i foli:

— Mblidhe grurin, o Beronjë, mblidhe e hidhe në hambar. Agai s'të merr hakë sepse, sikurse më tha, ti e paske mbajtur një natë në shtëpi, atëhere kur nxori atë të flamosur arpallëk. Shpjegore grurin në shtëpi (ai i shkrepri syrin, po ajo s'e vu re) dhe e hëngërsh me shëndet!

Nga këto fjalë, Beronja u skuq në fytyrë dhe u bë flakë.

\* \* \*

Ditë e për ditë Myftar efendiu mbushte hambarin, ditë e përditë sillej lëmenjve, kurse sejmën Liçit s'i zinin këmbët dhe. Ky duhej të rendte arave, të numëronte duajt, të rrinte edhe natën pa gjumë e të ruante se mos njeri ngrinte

duaj fshehur e i shpinte në shtëpi për t'i rrahur me vitel e për t'i shpëtuar së dhjetës.

Një mbrëmjeherë, pasi ra nata e u fsheh hëna, Myftar aga Pollonica kopsiti kopsat e setrës e, për të marrë zemër, e shkundi gjer në mes pagurin, që i kishte mbetur. Kishte vendosur të vështrojë hesapin me zonjzën Beronjë dhe kërrusur-kërrusur, doli jo rrugëve të fshatit, por qo-sheve e kopshteve.

Zonjës Beronjë sapo pat mjelë delet në hatat e hyri n'oborr. Portën s'e shtyu, por hyri në ashef përfund oborrit, ndezi gazanikun e i hodhi zjarrit një dorë shkarpa të thata. Vu perustinë, sipër saj lëshoi kusinë. Pastaj, si gufoi qumështi e mori valë, ajo e zbrazti në poçen e madhe, e trazoi me lugë që të ftohej sadopak, i provoi nxeh-tësinë duke kallur gishtin e vogël dhe i hodhi brenda farën e kosit. Desh të mbështjellë poçen me shkorsën e vogël, po iu duk nata e nxehtë dhe e la me aq. Me gazanik në dorë kaloi oborrrin dhe hyri në shtëpi. «Të marr punën e dorës e të shkoj te fqinjët për nja dy orë...» Kësh-tu mendoi, kur dera e sobës kërcëlliti e u dha në derë Myftar aga Pollonica.

— Mirëmbrëma, moj kokonë!

Ajo mbet mëdyzaj në mes të patozit, me punën në dorë e me majën e një shtize mu në tëmth. Pastaj maja e shtizës i zbriti më poshtë, i kaloi nëpër hundën e hequr, nëpër buzët me tul e të shtërnguara, atje iu drodh e i ngeli në dhëmbët e përparmë. Nga ajo dridhje e lehtë diç trokëlliti, por aq e nderë ishte qetësia, sa atë zhurmë të hollë midis metalit e dhëmbëve të

bardha, e dëgjoi edhe agai, me gojë të hapur, me krahët varur e me sytë si pofka.

— Mirëmbrema, ç'deshe këtu?

— Si mik të vij, o zonzjézë, a s'është portë shqiptari kjo? Njëditëzaj fola si ashpër, po sipas vendit edhe kuvendit, sonte erdha të kërkoj ndjesë e të merremi vesh.

Ai u ul në këndin mbanë vatrës e gulçoi. E zonja e shtëpisë e vështroi nga këmbët te koka, nga koka te këmbët, sikur të maste atë dhe gjendjen.

«Ky njeri ja është i krisur, ja është i pirë».

Por ajo kishte një besim të tepëruar në krahët dhe në forcën e saj dhe vendosi të përmbahet e shtruar dhe e urtë.

«Me të parë e me të bërë, — mendoi. — Dhe, në mos qofta e zonja sa për këtë surat, morti të më hajë një sahat e më parë».

Ajo u ul në këndin tjetër kundrejt tij, afroi lëmshin, hodhi perin mbi zverk e filloi të thurë fanellën.

— Me që ke ardhur si mik, urdhëro e folë!

Ai bëri të flasë, por goja iu muar, me sy vodhi gjunjët e saj dhe fërkoj mjekrën me dorë, zbrazti frymën me duf sa kundërmoi damfi i rakisë. Ngriti kryet pas murit.

— E kam një hall, o Beronjë, një hall që më djeg në shpirt e më përvëlon në zemër... ka mot-mot që më ka vdekur gruaja.

Ajo mblodhi këmbët nën vete dhe tërhoqi fundin e fustanit, sa mbuloi gjunjët gjer më poshtë, kurse ai s'po gjente dot guxim, pa shkuli pagurin e plumbtë nga brezi dhe e shkundi gjer në fund.

«E zeza unë, — mendoj gruaja, — e zeza unë ç'do bëhem me fjalë». Desh ta hidhte fjalën gjetiu.

— Si duket të kanë pllakosur hallet e shtëpisë, o aga.

— Hallet, moj hallet, po hallet më marin të keqen mua, se i pllakos me kamje; po ç'ti bëj se m'u prish shtëpia, s'kam ku mblidhem e me kë të mblidhem, djemtë më lozin kumar...

— E po kështu ndodh, o Myftar. Pula kllonit vezët e saja e i dalin zoga, gallofi edhe ai kllonit vezët e tij dhe gallofi i dalin, edhe zotrote s'mund të jesh ndryshe, se mos kllonite vezë pëllumbi e s'të dolën pëllumba.

Ai e dëgjoi përgjigjen kuturu, se mëndja i rrihte gjetiu, po përsëri s'po guxonte. Vështroi anash. Në mur ishte një fotografi. Në të dukej një goxha djalë.

— Është im shoq, — foli si me kanosje Beronja — është im shoq!

Por fare pa pritur Myftar agait i erdhën lot në sy, pastaj i erdhi një zë i trashë, si prej glyre të shurdhuar, dhe i ngjirur sikur ta kish fytyrën të ënjtur prej shytash. Me atë zë grinjar e të çjerrë, ai iu drejtua burrit të Beronjës në fotografi:

— Ti duhesh vrarë, o «kremenel!» Ti duhesh mbytur, o «kremenel!» Ti duhesh varur, o kallogjer... ti që më ke lënë këtë zonjzë të më digjet, të më zhuritet tridhjet e kusur muaj me radhë, o «kremenel!»

Në qafën e pjekur dhe të plotë të gruas, peri i leshtë u ngjye me bulëza djerse e lëshoi bojë. Ajo po e vështronte me mllëf, kur ai lëvizte e

u përmbys mbi gjunjët, festja i ra përdhe dhe lëshoi kryet në pëqi të Beronjës. Ajo bëri të prapset, por tëmthi i djathtë i agait i mbeti mu në kupë të gjurit, kurse sytë e tij të përskuqur e lutës e vështronin me sëkëlldi. Ajo ngriti grush-tin dhe e qëlloi në tëmthin e majtë, por aq me forcë, sa asaj më shumë i dhëmbi gjuri i saj se sa dora. Myftar aga Pollonicës iu duk sikur, për një çast, ja shtërngoi kokën një mengene çelniku.

— Këput qafën, i pështirë! Pa le pa, që më të gjallë më kall në dhe tët shoqe! Gremisu, mos të t'i shoh sytë!

Myftar efendiu u ngrit, duke u mbajtur pas kanatës së dollapit, e bëri të luajë kartën e fundit:

— Aman, moj virane, po ti më vrafsh e ti më prefsh, moj e uruar! Po gjithë ç'kam t'i kam falur, moj xhane...

Në vend të përgjigjes Myftar agai shihte dy bigat e një mashe të madhe, që i vërtiteshin mbi kokë. Oda i vinte rrotull, vatra i lëkundej, gruaja i tundej, patozin e kishin kapur ethet e veç ai mbahej drejt më këmbë, por kokën e kishte plumb të rëndë. Në një çast, dera që vërvitej e bënte kollotumba, iu afrua; në fillim dukej e vogël, pastaj iu bë sa një grykë shpelle. Beronja i dha duart me sa fuqi kishte dhe ai, me bërrylat, më gjunjët e me mjekrën, u rrokullis si mundi e ku mundi dhe u gjënd n'oborr. Ca zhurma qëllesash ai i dëgjonte, por çudi, dhëmbje s'ndjente. Veç në një çast, kur i krisi një rrashtë e kokës, sikur iu fut një gjilpërë në tru. Kur u gjënd në rrugë, duke u zvarrisur e shtytur si ndonjë lëmsh, ai iu qas lumit. Ndjente një etje të tërbuar dhe



një dëshirë të marrë për ujë. U fut në ujërat, por atje e ftohta e rrjedhës ja drodhi pulpët e këmbëve, sa gilcat e gjunjëve nisën t'i përpëlitën. Tashti dhëmbjet i buçitën nëpër trup e gjer në kokë. Nuk u mbajt dot e u përplas në lumë. Mundi të mbahet shesh, uji i avitej gjer në supa e duart, si t'i kish lopata, zu i tundte poshtë e lart si i gajasur.

Më në fund, kur mundi të kthehet në konakun e kullës, Liçi u tmerua prej gjendjes së tij. Liçi ja pllakosi tëmthat me qepë e kripë e ja leu trupin me vaj ulliri. Po, kur Myftari desh ta ndezë një herë, nuk gjeti nër xhepa as kutinë, as çibukun e as çakmakun. Nën dritën e llambës së vajgurit, Liçi vu re se agait i qe bërë surrati sikur t'i kishin vënë venduza nëpër faqet.

Këtë ngjarje s'e mori vesh njeri tjetër, përveç këtyre që zumë në gojë. Edhe Beronja s'desh të dëgjonte thash e theme. Vetëm kur qëllonte të shihte aganë, i përsëriste: — Po të të hajë kurri, eja edhe herë tjetër.

Liçi ndejti në këmbë të dhjetarit dhe ky thërriti edhe kryeplak Llambron, dhe i premtoi hakë e pagesë për të patur mëndjen e për të hapur sytë, se ja... «kështu ishte shkruar nga zoti, që në këtë fshat, ku erdha të punoj me dorë në zemër, në këtë fshat të rrezohem nga gomari natën e të bëhem bërlok me kokë, me kurri e me këmbë.»

Por duke shëruar plagët e duke shtypur qep e kripë, Myftar aga Pollonica vendosi të marrë hakë, se ai jo më kot i thoshte vetes aga dhe efendi, jo më kot blinte fshatra pa paguar, jo më kot naltmadhnia e tij «i kishte falur një nagante

me dorezë sedefi, me këllëf meshini e me mulli, që kur rrotullohej kërkëllinte sikur t'i kishte dhëmbët prej argjendi.

Pas dy ditësh na çatisën në fshat ca gjirinj e kushërinj të Myftarit dhe, me urdhër të prerë e të përsëritur të dhjetarit, çirreshin e kërkonin të dhjeta edhe mbi kashtën, edhe mbi bykun, bile edhe mbi kungujt e kastravecët e sa për më tutje... «kur të piqet misri, shohim e bëjmë se, si tha ai miku, duke ngrënë shija vjen vetiu.»

Dhe javës që mbeti mbyllur në konak, Myftar aga Pollonica mendoi e vuri për fije e për pe një plan, me të cilin do ta tallte fshatin tim e do ta bënte për gaz të botës.

Matanë kufirit, rronte asaj kohe një mjek i dëgjuar anëve tona, që priste të sëmurë me radhë e me sërë. «Doktor i Urupishtit» — pëshpërisnin njerëzia — «e mos shko më tutje.»

Te ky doktor shkoi (sikurse tha) Myftar Efen-diu, për të marrë hapje e sherbete për plagët që kishte marrë, kur ishte rrëzuar «nga gomari». As tri ditë s'i mbushi, kur na u këthye në fshat hy-pur në kalë, por me gjithë hien e zezë që kishte, solli edhe një lajm të mbarë.

— Kur kaloja qafën e Pisoderit, pashë karva-në e qymyrxhinjve, që ktheheshin nga kurbeti. Qëndrova dhe i takova disa syresh, më pyetnë dhe iu përgjigja. Sonte vijnë, se besa-besën mush-kat i ngisnin fort.

Graria e fshatit, përhapur nëpër lëmenjtë, çu-diteshin e hapnin sytë midis tyre: «Si është e mu-ndur moj motrani, ata e kanë të prerë të kthehen

më dy javë gusht, kështu edhe na shkrojtën. Sot kemi shën Pandelimonë, jemi më njëzet e shtatë të Korrikut, ç'është kjo e papritur?

Nja dy gra i shkuan dhjetarit atje te konaku. Kishte dalë nën hien e arrës së madhe e lante këmbët në legen: Liçi i mbante sapunin e peshqirin, ai hundë e buzë bashkë.

— Të na ndjesh Myftar Efendi, po si ishte ajo fjalë?

Ai, pa ngritur kryet, duke futur tregonjës in nëpër gishtat e këmbëve, ua pat:

— Si ishte... si ishte... u thashë një herë dhe mbaroi, mos do t'u gënjej juve, apo do t'u marr festen sihariq!

— Po a u njojtët me ndonjë syresh.

— Po pse, moj, s'është nga fshati juaj Rakua i Panxhos? Po Mina Dashi i Beronjës a s'është prej këtu? po Duro Capi a s'ka grua Eminenë atje poshtë? Vetë m'i thanë emrat, ata...

I gjithë fshati e besoi dhe u vu në lëvizje.

\* \* \*

Afër mbrëmjes koha e ndërroi fletën. Era e Gramozit, që sillte jugën e tenjoste grunjërat. rështi. Ja, doli era e Ivanit, që vuu e vuuu ngriti udhëve pluhur e byk, përshkënditi ferrave fijet e kashtës, shkuli nga stërnishtat kërcejtë e legëtyrave të mbetura, pastaj vu në lëvizje shelgje e plepa, që nisën të frushullojnë, të falen, të rënkojnë. Re të zeza u lëshuan nëpër qiell kush e kush të dyndet më parë e t'ja kalojë shoqes. Gazin e fshatit, që priste mërgimtarët e prishi kjo e

papritur. Mbetën kupet e vraheve pa hedhur, grurë e byk bashkë, se era qe e rreptë e rrëmbente ç'të gjente përpara. Filloi të pikojë shi. Të gjitha ç'kishte fshati, cerga, shkorsa e mutafë u sollën në lëmenjtë. Ashtu u mbuluan vrahët, duajt, buka e njerëzve dhe kashta e bagëtive. Medoemos, plaka e pleq do të flinin nëpër lëmenjtë, kurse gratë e nusët qeverisnin shtëpitë, lanin kalamajtë, gatuanin darkën.

Vinin burrat nga mërgimi! Vinin pas kaq vjetëve!

Një ngjarje e tillë ka qënë një festë e rrallë për të mëdhenj e për të vegjël. Festë që e shkundte fshatin me gjithsejt, që nga themelet. Kush priste djalin, kush priste vëllanë, nusët prisnin burrat, vajzat e fejuara prisnin të fejuarit, të tjera prisnin të dashuruarit, akoma të tjera prisnin ata që do të njihnin. Kaq dasma do të bëheshin asaj të diele! Një botë e tërë përftyrimesh, një botë malli e dhëmke, një rrëke lotesh për ata që i lanë këtu e s'i gjejnë më, edhe për ata që u nisën dhe i lanë kockat në dhe të huaj. Në kësi rastesh, nër nusët e në gratë ka pasur një ngashërim e një dridhje, që vinte nga koha, nga ndarja, nga motet.

Asaj mbrëmjeje, kalamajtë deshën të dalin tutje nga Përroi i Madh, për të pritur prindërit, por nënat nuk i lanë.

- Bie shi, shi behari, po përsëri të lag.
- Delni ose jo, ata njësoj do vijnë.
- Bie shi, shi behari, po përsëri të lag.
- Mojmama!
- Bir i mamasë.
- A do më sjellë babi opinga?

- Do sjellë, o bir, posi? Ja, tashti vjen.
  - Po mua a do më sjellë fustane?
  - Do të të sjellë, o të keqen, ti bjer e fli,
- kur të vijë ai unë të zgjoj.
- Po sheqer do sjellë?
  - Po rushka?
  - Po neblebi?
  - E si do mos sjellë?

Zonjëza Beronjë e përmbysi shtëpinë asaj dite. Gatoi edhe bukë me grurin e ri dhe me qiqra. Kur i mbaroi të gjitha punët e shtëpisë, kish-te një dridhmë në trup sa nuk përmbahej dot. «Prej gazit» mendonte ajo dhe me ksistër nër duar kruante dërrasat e magjes, kanatat e dyerve, dyert e dollapëve. Hera-herës i hypte një si llokoçitje në gjoks e i kërcisnin dhëmbët.

Nata thelloi. Njeri s'po dukej. Por afër mesnatës Beronja dëgjoi një tingëllimë zileje.

— Erdhi burri, e zeza unë...

U lëshua e hapi dritaren, shtyjtë kanatën e jashtëme dhe vu vesh. Vërtet tingëllinin zile, bile fare afër.

— Ai është, ai!

E la dritaren çelur, rendi në oborr, doli në rrugë. Zilja s'dëgjohej më. Vu dorën mbi gj. Zemra i rrihte fort. Në një portë afër dikush grindej.

— Moj e Stefanit, dëgjuat gjë?

— Poosi, u dëgjuan zilet!

— Edhe unë i dëgjova.

— Mos ishin udhëtarë nga të fushës, që shkonnin në mal?

— Në këtë sahat? S'e besoj.

Po zile të tjera u dëgjuan në mëhallën poshtë.

— Erdhën, erdhën!

Pastaj zilet tingëlluan më fort nga ura. I gjithë fshati u ngrit më këmbë! Zile të tjera u dëgjuan më të hyrë të fshatit, të tjera në mëhallën poshtë.

Shiu binte, era uturonte e grindej nëpër tjegullat e çative, përplasej pas oxhakëve, piklat e shiut rrëshqisnin tatëpjetë e vinin në rrezik bukën e mbetur lëmenjve. I gjithë fshati ishte në dridhërimë nga ato zile që dëgjoheshin vërtet, por zë njeriu s'pipëtinte.

Beronja shtrëngonte duart mbi gjoks, me sytë përhumbur në errësirë: «Ç'janë këto zile tinzare, që rendin si lugetër nga një qosh i fshatit në një tjetër?!»

Kur ajo u kthye në shtëpi, në dritaren e mbetur çelur, era kishte shkukur perden prej kaseje të bardhë dhe e kishte varur mbi tundësin. Përmbi pëlhurën e bardhë kacavirej një fletë e thatë ftoi.

Dhe zilet tinzare tingëlluan gjithë asaj nate, nëpër fshat. Gratë s'vunë gjumë në sy. Në mëngjes fshati ishte si i zymtë, si i vrarë. Veriu, që i pati sjellë retë, tashti po i spastronte vetë. Toka ishte qull e lagët; nëpër lëmenjtë ngriheshin avuj, shoshat prej llamarine kishin zënë ndryshk. Përsëri filloi dita e punës, por grave s'u delte e keqja e natës, që sapo kaloi. Kokë më kokë dhe vesh më vesh biseduan, kuvenduan, pleqësuan punën. Myftar aga Pollonica nuk dukej gjëkund. Po tashti e vërteta dukej si drita e diellit. S'dihet se kush bërtiti e lëshoi e para atë thirrjen për të

rrëmbyer hunjët! Gra, nuse e vajza pështytën pëllëmbët dhe rrëmbyen... çfarë rrëmbyen? Hunjët, cfurqet, lopatat, fshesat e buta të bereqetit, fshesat e ashpra të rakitave dhe u turrën nga kosherja. Myftar aga Pollonica sapo kishte dalë te hieja e arrës, por sytë i kish të përskuqur më keq se hundën. Sa vështroi turmën e grave ai s'u tund fare, po nisi të tallet e të qeshë.

— Hyyy! hahaha! (dhe shenjonte Beronjën me gisht) Hy! hahaha! Mbrëmë kjo s'gjente vend ku të futej!

Atëhere turma e grave iu derdh sipër.

— Bjerini, bjerini, t'ja bëjmë kurrizë më të butë se barkun!

— Bjerini, që ta marrë vesh se me kë ka të bëjë!

— Bjerini, që të mësohet të tallet edhe herë tjetër!

— Bjerini vitheve, që mos bëhet me gjak, bjerini!

— Moj futjani ku të mundni, pa përsesh le të bëhet! Edhe zonjzës Beronjë shoqet i bënë vënd dhe pjesë.

— Shko dhe u anko tashti, këtu t'i kam edhe kutinë e duhanit, edhe festen, edhe çakmakun; shko, do ta marrë vesh edhe jot shoqe, që e fute në dhe...

Nër këto e sipër u dha kryeplaku. Ai desh t'i merrte krahun, po urtë e butë. Liçi doli më i mënçëm e këmbët e lehta faqja e bardhë. Kryeplaku u lut, u kanos, po pastaj rrëmbeu një hu e u vu ta mbrojë, gjersa huri iu kthye pas kokës, hëngri ca të çjera faqeve, grushte vitheve e u

nis për qepë e kripë. Gratë u xhingosën më keq. Midis tyre doli njëra e bërtiti me të madhe:

— Të rrëmbejmë sopatat dhe të hapim hambarët e dhjetarit!

\* \* \*

— A ka lojtur druri vërtet asaj dite? — mund të më pyesni ju që lexoni. Besa besën, ju mund të kini parë të lozë kopaçja midis burrash, por që një turmë grash trime, si ato të fshatit tim, ta lozin hurin ashtu si e lojtën, zor se e kini parë.

Myftar aga Pollonica hëngri dru me gdhë, jo shaka.

Sa për hambarin e dhjetarit, atij do t'i vinte radha një herë tjetër.

Kur ka marrë vesh prefekti këtë gjëmë e turbullirë, tregojnë se iu drodh mjekra e cip' e barkut e bashkë me to edhe dora me gjithë telefon. Këtë të shkretë s'e vinte dot te veshi e shkoi e vate. Thirri në telefon, lajmëroi e njoftoi, por matanë telit kushedi se kush kishte rënë në mendime me kokën ndër duar. Dhe tregojnë se, pasi ishte mejtuar mirë e mirë, ai matanë kishte folur:

— Që të ngrihen burra me armë kemi parë e kemi prerë, por që të vërsulen gra me kopaçe e me çfurqe...! Shko, o prefekt, shko dhe mundohu ta platitësh punën, se përndryshe t'u shojt nami dhe ty edhe neve.



## INTERVISTË ME NJË TURIST

Jam nëpunës i turizmit; të merremi vesh, jam shoqëronjës. Punë e vështirë. Edhe delikate, domosdo. Vjen i biri i botës që nga ana e anës, i huaj, i panjohur, ka dëshirat e tij, tek, hyqet. Kartelat më bien në dorë që më parë, me postën. Janë shkruar në gjuhët më të ndryshme: «Jam filani, i biri i filanit, lindur këtu e atje, më kaq e aq. Arësyeja e vizitës? — Dëshirë për të ngrënë drekë në amfiteatrin e Butrintit, qejf për t'u fotografuar në kolonat e Apolonisë, kuriozitet, vakancë.»

Dhe ja, një ditë, një kartelë pak e çuditshme, shkruar shqip: «Turist Xheims Shajvak, lindur në Shqipëri më 1887, Banues në Alabama. . .

Arësyeja e vizitës? «Të shoh një oxhak!»

Mblodha supet për atë emër, që i kujtudo mund të ishte, por jo i një shqiptari, U hodha një sy dokumentave të tjerë. S'mund të kuptoja gjë. Pa të shohim ç'është ky Xheimsi?

Vapori iu qas portit, një manovër, një gjysmë kthese, lëkundje, urdhëra; vapori u ngjesh pas bankinës, u tund edhe pak nga ndeshja me tubat

e gomës. U lëshuan shkallët, nëpunësit, udhëtarët. Përsëhendetje. Takoj të priturin tim: Burrë vigan, moshën po ja thamë, republikë të zezë, syze me korniza të zeza në pjesën e sipërme. Është hie rëndë, nuk nënëqesh fare; ka ca vija të thella nën nofullat, qipa lëkure nën to. Në të ri do të ketë qënë fytyrëmbushur, faqekuq, edhe i pashëm, i bukur. Për besë. E përqafoj, i jap emrin, më jep të tijin: Xhafer Shajaku! — Aha, ti je Xheimsi! Tundi kryet. Flet shqipen rrjedhshëm, atë të gjyshërve tanë. Nuk ma var fort, qëndron me sytë lart, rrotullon kokën, sheh rreth e qark.

— Habitesh?

— Jo. Kam parë makara më të larta, vapore shumë më të mëdhenj.

— Po atëhere?

— Kujtoj se asi kohe këtu shkarkonin hamenjtë, shkarkonin gomarët dhe atje lart...

— Atje lart?

— Fërfëllonte flamuri me gjysmë hëne.

— Kini ardhur të shihni një oxhak?

Bëri sikur nuk dëgjoji, ndofta s'e pat mendjen. Ku ta dish! Në vënd të përgjigjes një pyetje:

— Rusë nuk keni, e di, as kinezë nuk shoh, vetë i vërtitni këto punë?

— Si e sheh.

S'munda t'i kap fillin këtij njeriu. Kur e pyes, ai ma pret më kaç, shkurt, e sytë rreth e qark. Dashur pa dashur u sëndisa. E kuptoi:

— Mos u nxito, jam i mallëngjyer. Kam ikur nga Shqipëria pesëdhjetë e pesë vjet më parë,

e di ç'do me thënë? Ti prit, do spjegohemi, më nge.

Sa ishim në rrugë e në shesh, nuk foli. Shihte, përgjonte, tundte kryet, e rrallë hidhte një sy për mbikornizat e zeza të syzevet. M'u duk tepër e amerikanizuar kjo kockë e vjetër shqip-tari, kur vura re tek përtypej paprerazi. «Chewing gum»<sup>1)</sup> mendova unë, po, kur u koll një herë (një e kollitur e fortë prej një gjoksi si shpellë) kuptova se përtype duhan.

— Zakon i vjetër — ma pat, — dhuratë nga fabrika.

Asgjë nuk kuptova.

Natë. Më ftoi në dhomën e tij në hotel, për «muhabet». Nën anën e djathtë të pizhamasë i dukej pulpa e mbështjellë me çorap llastiku.

«Po... unë jam Xhafer Shajaku. Ikur nga Shqipëria, pasi bëra një... e nejtse... ma bëri borxh. Përsë erdha, kur s'kam njerëz këtej? Për të shikuar një oxhak domosdo. Puna e oxhakut kishte zënë kore, po tashti u shkunda. Që thua zotrote, sherr atje në kurbet, sherr me grekët. Me këta gjithë jetën më thikë kam qënë, edhe këtej edhe matanë detit, që thua ti. E, nejtse: Më tha: E. dëgjove radion, o Xhafkë? E dëgjove ç'u bë union neshion? U ngrit ai i farës sate e hodhi një gur në pus, si punë e budallait, dhe tashti janë mbledhur gjithë të mënçmit e botës dhe nuk e nxjerrin dot. Kështu jini juve, grindavecë, kështu e bëri edhe ai, mjekra juaj, dyzet vjet më parë në Xhenevë...»

---

1) Anglisht: çamçakëz.

«Kec ai, gjuhën ndën të lagur. Por shamata për shqipot andej ndjehet e madhe: janë xhindosur, janë prishur nga mëntë, kanë shkatërruar pasanikët, kanë prishur parësinë...»

«Po oxhakun e Bezat Beut a e kanë shkatërruar vallë? Ja, këtu m'u hap plaga e vjetër. Mos të flihet ty?»

— Jo, ç'është ajo, të lutem.

— E nejtse. Ishim dy vëllamë asikohe në fshatin tim. Patëm bërë vëllami duke pirë gjak. Unë dhe Alekua. Të dy jetimë, pa njerëz fare, por të këngës, të dasmave, të qejfit. Edhe ai ishte trupmadh si unë, por kishte ca flokë që nuk i shtroheshin, sikur edhe një teneqe me vaj t'i hidhje sipër. Shkonim e vinim në kurbet afër, andej nga Sheheri, me kosë në sup e këngë në buzë. Moti 1901. Jepnim e merrnim me çetat e komitave, për Shqipëri. Me turqit, pëllëmbë e tym, me dhespotin e Kosturit xip më xip, Alekon edhe e patën mallkuar. Me bejlerët, mos e pyet. Ne ai oxhaku ta kam fjalën. E, nejtse. Po mban shenim?

— Interesante, s'është keq të mësojnë të rinjtë sot, si i çatë rrugët ju dje.

— Pa çka. E nejtse. Na kthehet nga Anadulli në fshat një bej me një sërë djem, gra e nipër. Kish qënë mytesarif në Brusë. Nuk di se ç'pat ngatërruar e vulën ja kishin mbajtur, por hyqet i solli këtej. Bleu çiflikun nga një shok i tij, ngriti kullë të re dhe (hajvan sa s'bëhet) ngriti edhe një si farë oxhaku përmbi kullë, si një farë minareje. Këtu ta kam fjalën. Gjithë ditën rrinte në majë të kullës, me një bilbil në dorë dhe... fërrr, bilbilit. Ngado që ishim e ngado që shkonim na ndiqte hieja

e atij oxhaku e vërshëllima e atij djall bilbili. Dha e mori, njohu gjëndjen, njerëzit, u lidh me komandarin turk, me dhespotin e Kosturit, filloi nga të tiat. Mua dhe Alekos na e pat vënë syrin. Dhe ngado që shkoni, fushës a fshatit, fërrr, bilbili i tij. Një herë na u kanos, na u kërcënua. Por ne punën tonë, me komitat, me çetat, me abetaret dhe sherrit lepe, se jo më kot e ushqenim gojën duke kositur luadhet e Sheherit. Një herë kthehej Alekua prej Manastirit me një torbë abetare. Spiun prifti, koshadhe sejmenët, komandar Bezat Beu e kapin Alekon, ja marrin ç'kishte, e lidhin, gati ta vrasin. Ishte natë sterrë. Kalonin përmbi Stenën e Madhe. Vëllami atje pa vdekjen me sy. I vdekur se i vdekur, i humbur se i humbur, vërsulet nëpër Stenë, tatëpjetë greminës. Ata ja lëshuan me batare, ai rënkoi me të madhe. U dërmua, u copëtua, por plumb as e fshiku, as e mori. «U vra, i dhanë karar ata» «U vra Alekua — hapa fjalë unë, — copë e shoshë e gjeta nën Stenën e Madhe, mërshën ja kishin ngrënë ujqërit». Por unë vëllamin e gjeta shëndoshë... mos pyet. Natën e mora nër krahë dhe vetë për vetë e shpura në fshat. E mbajta në qilar. E pllakosa me qepë e kripë, një muaj, dy, tre, u bë më mirë. «Mbahu vëllamë, — i thashë. — kaq e pat. Ngrihemi ndonjë mëngjes herët, i japim beut një shëndet në ballë dhe marrim ku sytë këmbët.» E mirëpo të ikësh nga mëmëdheu për gjithnjë dhe të mos bësh një të mirë? Ishte një jetime në fshat, si po ne. «E marr grua, — thashë, — e zoti na e bëftë mbarë.» E, nejse. Dasmë. Unë dhëndër, Alekua qilarxhi, por fshehur brenda në qilar. Miq fare pak. U habita kur shoh

edhe Bezat Beun që më vjen në dasmë. Kjo s'më pëlqeu. Kishim mëndjet dhe zakonet tona asi kohe. Thoshim: Hasmin mos e nga kur ha bukë, kur pi ujë, kur të vjen mik, ose të falet. Po e vrave në kësi rastesh ai shkon drejt e në xhenet. Por... Bezat Beut i kishte ardhur ngordhja, sepse me mëndje të ligë kishte ardhur në dasmë. Kur i vjen fundi qenit... E, nejse. Mëndjen e ligë ai e kishte sapo vuri këmbën brenda, po përsëri si më dyzaj. E mirëpo, rakia e hollë, mezeja e trashë, hidhu e këndo, si tha ai miku, duke ngrënë në vjen shija. E, nejse, kënduan gjelat e mesnatës:

— Zoti bej, efendi, të marr dor' e këmbë, dëshira juaj është dëshira e Zotit, a ta mbyllin dasmën?

Ai qëroi gurmazin, u kapardis, sytë i shkanë nga trarët e tavanit, edhe një bromp nga sejmeni, një nga kryeplaku dhe lëshoi brezin. Se çfarë i tha sejmenit në vesh, unë nuk dëgjova dot, por sytë e atij që dëgjonte u bënë sa një filxhan njëri. Beut na i pat shkarë syri te nusja e re. Më hoq sejmeni mënjanë e më thotë atë gjëmë, që nuk shkruhet në kartë. Unë s'i jap përgjigje, por vërsulem në qilar. Atje i kërkoj vëllamit shtërin e madh të mishit. — Dale, — më tha Alekua, — je në vete? hanxhari është bërë dhëmbëdhëmbë, duke prerë mish... mos u nxito dale ta shtrojmë punën dhe të mprehim hanxharin, dale... shko dhe i thuaj peqe e lepe, ikë.

— Aman zoti sejmen, — i flas atij që po priste, — pranoj por vetëm me një konditë... Si të ikin miqtë, mos merret vesh.

Iknë njerëzia. U bë zakoni, më mbyllnë me nusen, por sa hyra dola. Beu priste prapa shtëpisë, nën strehët, me dorën në silahet. Ç'u bë pastaj? Haku te i zoti. Alekua beun, unë sejmënin, nga një thikë në bark, nga një hanxhar në zverk, nusen në vithe të kalit, i kallmë zjarr shtëpisë dhe bërtitme me të madhe: — Mblidhu o fshat të mbash sehir, të hash edhe hallvë...

Kuajt në trokth. U gdhimë në qafë të Pisonderit. E kisha zor me vëllamin, se i dhimbnin plagët, mezi mbahej në kalë. Nuk ishte për rrugë të gjatë. Një ditë u ndamë. Ai qëndroi në një mik në Sheher, unë me gruan i hipa vaporit dhe kapërxeva detin e madh. Vjete e vjete me radhë njerëzit e Bezat Beut na kërkuan dhe nihatnë si zagarët, por nuk na ranë dot në gjurmët. Kur betin e pata të gjatë. Djemtë m'u bënë burra, gruaja më vdiq. Por... si punë e mëzit kur e futin në lëmë, rend e rend e përsëri te strumbullari kthehet, ja kështu edhe unë. Bëra lutjen e më erdhë kartërat. U nisa. Sosa në Romë. Këtu më punoi mëndja. Të çash detin e madh e të mos takosh vëllamin? Ndrova një pjesë të rrugës. Kondisa në Pire. Një tren këtu, një tjetër atje, sosa në Selenik. Më kishte rënë në vesh se ku pat hedhur rrënjë Alekua, por sakt nuk e kisha. Por... me të pyetur. E, nejse. Shkoj në një zyrë ku më thonë se mund të pyesësh për çdo hall e nevojë. Këtu bëra një lajthim. Kur isha i ri e bridhnja Sheherit, më thoshin «Zoti Xhafer», vetëm se isha shqiptar. Por kohët ndryshuan. Kështu, hyj në atë zyrë dhe pyes. Përballë më del një korozi zevzek, me moshë të re. — Ç'je ti?

më pyet. — Jam shqiptar, — ja ktheva. — Që nga i ke rrënjët? — Nga Korça.

Ai çeli një si penxhere të vogël në mur e hodhi sytë në një kthinë tjetër. Që andej dëgjohej një muhabet i rrëmbyer, tym duhani zu delte këtej. Koroziu i foli dikujt: Zoti qirie iks e epsillon një njeri nga Korça këtu, vjen e guxon të më thotë se është shqiptar!

Një palë sy të inatosur më panë që nga penxherja e vogël, pastaj sytë u hoqnë dhe u lanë vëndin një palë dhëmbëve gjysmë të krimbur, që vërshëllyen:

— Paloarvanit! — dhe e përplasi deriçken, sa u ngrit pluhur përpjetë. Dukesh që atje kishin zjarllëk, bisedonin për Qipron. Kështu është, kush lakmon gjënë e botës, humbet edhe të tiat. E, nejtë. Do vinte gjatë atje, në zyrë, ku shkova si breshka te nallbani, por... erdhë njerëz të tjerë për të pyetur, erdhë shumë dhe unë fësht nëpër derë e ua dhashë këmbëve.

Ja hip trenit përsëri, të dalë ku të dalë, Dolla në fushë të Sheherit. Që nga penxherja e trenit shihnja vargje me çupa, që nxitonin kushedi se ku. Barisnin dhe thurnin çorap. E, nejtë. I qemë qasur një qyteti, qëndronja në çardhakun e trenit, kur shoh dy korofillakë që shkojnë kabinë më kabinë dhe... kërkojnë shqiptar! Në atë çast treni qëndroi, dera u çel dhe unë fësht edhe një herë përpjetë qytetit, nëpër mizërinë e njerëzve, që ishin në stacion. Në të ri kisha qënë në këtë qytet, por tashti as e sillja dot ndër mënd. Bile as e mirrja dot me mënd nga ngjitej e nga zbrishte dielli, që tashti ishte mu në majët. Vapa të



mbyste, e nxehta digjte si furrë. Po tashti kë të pyes? Ku të gjej fill? Po ata që më kërkojnë? Shkoj në një dyqan të vogël, brënda ishte vetëm bakalli me këmishë të hollë e brekë të shkurtëra, qëndronte më këmbë pas banakut. Në një çengel një copë mish, një teneqe gazi po zbrazej mbi fuçinë me muslluk. Me atë greqish-te që di i jap njatjetën. Ai kishte një kryq të vogël mavi në ballë, si punë tatuazhi. Doemos ishte kucovllah. Mirë rashë, mu në të. Grek, mik më kucovllah zor se gjen. E, neipse. Sidoqoftë u ndjeva mirë se, në fund të fundit, në do të gjesh një adresë, pyet bakallin e vëndit. I flas:

— Tungjatjeta zotëri, qofsh me nder, gërqishten mirë s'e di, korofillakët më kërkojnë, zotrote a di këtu një Aleko, Aleko, shqiptar?

Ai qëlloi me dorë pjatën e pallanxës dhe ngriti kryet:

— Siurdhëron, merr këtë rrugën këtej, del jashtë qytetit... një portë e madhe...

Sytë e bakallit u shqetësuan përnjëherësh, i patën shkarë nga penxherja.

— Korofillakët, — foli i nxituar, — hidhu këtej!

Se si e kapërxeva trapezën aq shpejt, s'e mora vesh.

— Struku këtu!

U ngula nën banak. Pas kurrizit tim, dërrasa, përpara syve, siç qëndronja i kuspullosur, kisha dy gjunjët e bakallit. Një palë gjunjë të ngjeshur, prej burri. Prej burri vërtet? Pa të shohëm. U dëgjua një zë i ashpër:

— Kaloi këtej ndonjë njeri i huaj?

«Hej gjetshi belanë, po tashti?»

Gjunjët e kucovllahut u hepuan një çast, njëri i mblodh shpejt, tjetrit iu drodh kupëza.

— Hap sytë bakall! Shkoi njeri i huaj këtu?

Tashti pulpët e bakallit u bashkuan, kërcinj-të sikur iu ngurosën, një dell mavi iu zbardh, për një çast iu tendos fare.

— Jo, qirie, në dyqan s'pashë njeri të huaj, veç një si amerikan shkoi tatëpjetë.

— Tatëpjetë apo përpjetë?

— Tatëpjetë.

Korofillakët dollën. Trim bakall, edhe i besës, për besë.

— Mos u tremb — më foli, — i nisa me sho-shë për ujë.

Ishte natë, kur trokita në një portë të madhe jashtë qytetit. Nga brënda një qen nisi të lehtë me të madhe, duke kafshuar me inat dërrasat e portës. Dikush iu kanos qenit. Ænë trokita sërish.

— Kush është? — më pyesin greqisht nga brënda.

— Jam shqiptar, ja kthej shqip nga jashtë.

U hap porta. Një fytyrë e habitur prej burri të ri. Ai ngrii kandilen mbi hijen time.

— Kush je ti?

U gëlltita dhe ja preva:

— Me këto leshra që ke ti, më këta sy, me këtë ballë... ti ngjet me Alekon që u hodh nga Stena e Madhe, ti duhet të jesh i biri!

Ai çaploi gojën dhe sytë.

— Zor se nuk të ka treguar yt atë për një mik e një shok.

Ja, kaqë u bëra, kurrë nuk kam qeshur e nuk kam qarë si asaj nate. Kurrë s'isha ndodhur nën

atë strehë, por për pesëdhjetë e pesë vjet me radhë unë kisha qënë në zemrat e atyre njerëzve.

— Ky është Xhaferi! Ky është!

Dhe sytë e të gjithë atyre që ishin atje, burra, gra, fëmijë... më shihnin sikur të kisha zbritur nga qielli. E, nejtë.

Veç Alekua pat rënë shumë. Plagët e Stenës së Madhe i dhimbnin më fort tani në pleqëri. Plagët në mish edhe durohen, por plaga në zemër edhe atij i rrinte hapur akoma: A është më këmbë oxhaku i Bezat Beut? A është më këmbë ajo kullë e zezë, a kanë më vulë? He, bir, a kanë?

\* \* \*

Fshati i Xhaferit, buzë një korieje. Korieja qënkeshe e re, shtëpitë me tulla të kuqe, njerëzit shtuar dhe «Xheimsi» dyshonte se që në fshatin e vet. Takuam fshatarët. Kishin dëgjuar nga pleqtë për «një Xhafer e një Aleko,» por punët e tyre tregoheshin si përrallë.

— Unë jam Xhaferi!

Na pritën si miq. Erdhën edhe dy, tre mo-shatarë të «Xheimsit». Përqafime, përshëndetje, edhe lot domosdo. Një festë e tërë.

— Po oxhaku i Bezat Beut? Ç'u bë fara e tij?

— Morën armët të mbrojnë çiflikun, këtu e ca vjet më parë.

— E pastaj?

— Pastaj... kësaj here kopaçet u bënë me koçkorë, thikat me dy presa, u shkrumbosën me gjithsejt.

Për herë të parë, qëkurse u takova, pashë të qeshë ajo fytyrë plaku.

## LARASQINA

**N**ga lindja po vinin hordhitë dhe pluhuri, që ngrihej fushës nëpër vapë, dukej si një re breshëri në të kthjellët, kur afrohet me zhurmë e tërsëllëmë.

Hordhia kaloi Trakën, la pas Vardarin, fushën e Manastirit, fushën që kundërmonte squfur dhe iu afrua liqenit me peshq të ëmbël. Këtu mylazimet u frynë borive, daullet gjëmuuan, rrotat e qerreve ndaluan krikëllimën, ushtëria qëndroi dhe suvarinjtë u zbritën kuajve. Kafshët u lëshuan të pinë ujë, kurse buajtë, që tërhiqnin qerret, nisën të vrapojnë rëndë-rëndë, si dordolecë. U dridhej lëkura e zezë e barqeve dhe përplaseshin nëpër liqen. Sytë e tyre të çakëritur, të mëdhenj e të përdalë ndjenin kënaqësinë e ujit dhe vështrojnë qiellin me miratim. Ishin disa buaj aziatikë me brirë të përdredhur e të ngjyer me këna e bojë të kuqe. Andej nga qëndruan kuzinat ishte një lumë i madh, që shkiste mbi shtrat të ngushtë. Ngjyrat e qiellit dhe plepave të lartë lëshonin hije mbi të, ai i mirrte këto, por më shumë i pëlqente të mbajë ngjyrën e vet të zezë, si pisë e shkrirë.

Kryekomandanti i hordhisë qëndroi te qyteti me katedrale buzë liqenit. Por qyteti dukej i vdekur. Ishte mbrëmje. Malet, tej matanë, të xhveshur dhe të thatë, nisën të hirosen; u dëgjuan trumbetat në kampin e trupave. Jeniçerë dhe ushtarë, të lodhur dhe të pluhurosur nga rruga e gjatë, ranë në gjumë menjëherë. Në mbrëmjen që numëronte akoma regëtimat e fundit të dritës, ra qetësia dhe përmbi atë qetësi të njerëzve, doli si me magji zhurma e lumit të madh. Kur dolën nga Edreneja, pashai rrinte në fund të hordhisë, edhe në tokat e Thesalisë ai shtrihej në karrocë në mes të ushtrisë, kurse këtej, sapo kaluan Manastirin, komandanti ecte fill pas pararojës. Tashmë ushtarët heshtnin nga droja e ndonjë sulmi të papritur dhe të gjithë donin me doemos të vështronin sytë e pashës komandant. E kush më shumë se ai dinte mbi këto vënde!

Mustafa Pasha la çadrën e doli te Shkëmbi i Madh mbi qytet e mbi liqen. Ishte natë e plotë. Ai dëgjoi një fërfëllimë atllasi. Afrohej kirgizja e haremit. Nobetçinjtë vigjëlonin larg dhe ajo ngri-ti çemberin prej kadifeje vishnjë. Eunuku e ndo-qi pas me fener në dorë e pasha ktheu kryet. Ash-tu pa fytyrën e ëmbël të kirkizes, faqet me tul, sy-të e menduar, larë e gjitha me dritën mavi të fe-nerit. Komandanti përkëdheli mjekrën e vet la-ramane, e përkëdheli me pëllëmbë të hapur e fa-re pa pritur e shtërngoi në grusht atë shtëllungë qimesh të kreshpëruara. Diçka i lëvrinte në kokë, diç tjetër e brente në gjoks dhe për të mbuluar të dy shqetësimet (të kokës dhe të gjoksit), ai tërho-qi mjekrën, sa goja iu hap sa një kamare. Po! Në këtë rrugë që kthehej, në këtë rrugë ishte nisur,

nisur si renegat me një torbë lëkure, për të mos shkuar ushtar në mbrojtje të Arbërisë, që shkelej prej turkut. Ai kishte qenë nga derë e madhe. Pas vjete shërbimi si spiun e hafije në oborr të Sulltanit, ja ku doli një ferman: «Mustafa Arnauti, me dëshirë të padishahut, merr myhyr e bëhet pashë»! Dhe pas disa vjetësh të tjerë e thërriti Sulltani në sarajin e vet e i tha:

— O Mustafa Pashë Arnauti (dhe i rrahu supin), ti je lindur që të komandosh ushtri, je lindur të bëhesh i madh. O arnaut i përunjur, bëhu vezir!

— Po si, o padishah?

— Shtroi arnautët e tu, o Mustafa, dhe allahu të pastë në sy, si unë të kam në zemër!

Dhe ja ushtria, ja jeniçerët, që i kallën tmer edhe Evropës. Ja! I ka sot nën urdhër Mustafai i mbiquajtur pashë, «nesër me ymrin e allahut vezir, shkruar me urdhër mbretëror, mbi gjak arnautësh mosmirënjohës».

Këto qarkon në kokë Mustafa arnauti, natën, në brigjet e liqenit me ujë të ëmbël.

«Po cilin e merr gjumi në një rrethanë të tillë!? Kthehem nga një mërgim kaq i gjatë, kam shkuar djalosh pa fije mustaku, mungova tridhjetë e sa vjet dhe sot... kthehem i madh, i fuqishëm. Mijëra sklevër i kam nën urdhër, me një shënjë të gishtit tim, i flak në kasapanë që të theren, të vriten, dhe... një femër kaq e bukur rri nën gjunjët e mi. I madh je, o Allah, i madh je ti dhe mëkëmbësi yt mbi tokë. Po përse, o allah, ata male kundrejti janë kaq të egër! Medoe-

mos, në këto orë nate dhe tmeri, gjauri i madh synetlli vrapon suvari nëpër përrenjtë e llahtarisur të kësaj treve të pashtruar...»

Një hingëllimë kali u dëgjua nëpër natë. Atë britmë e pasuan plot të tjera. «Hingëllijnë kuajt, duke pritur trimat t'u vërsulen në shpinë! Medet! Përse kaqë të murmë ata male, ku do të shpalo-set fermani fatlum i vezirit?»

Mustafai psherëtiu me një lakmi të ethshme përbrenda dhe përkuli kryet mbi robinën, që e joshte me frymën dhe rrëngqethjet e saj.

\* \* \*

Këmbanat e Shënkollit të Rajcës lëshuan të parat tingujt e alarmit. Një daulle u përgjegj nga maja e Biskaljes, pastaj me radhë, këmbanat e Urakët, të Shëngjergjit, të Rodokalit, të Shënpremtes së Golikut dhe, thellë grykës së Shkumbinit, jehuan gjëmimet tejmatanë, gjer në qytezë të Sopotit. Këtu, princi la ushtrimin e djelmoshave dhe doli në bedenat e kalasë.

— Vjen kjeni turk t'i bjerë Arbërisë!

— Po vjen hordhia me Mustafa Pashë Arnautin, tradhëtorin e trollit, të besës e të gjakut!

Nëpër portat e qytezave, rrëzë mureve të lartë, nëpër brimat e frëngjive ngarendën ushtarët. Ndën kubetë e portikave të lyera me lyqyn, kalorës të ngarkuar me parzmore lëshuan armaturat e rënda, hoqën shqytat e hekurta dhe morën nër duar copëra kartërash, lajme të shkruara, të tjera të folura, me urdhër të prerë t'i tregojnë

si i patën dëgjuar. Arbëria e gjithë dëgjonte trokthin e kuajve, që shpërndante gjithandej lajmëtarët e princave të Mokrenës e Sopotit. Po përse një zot i Muzakajve doli kaq i vrerosur te cepi i kalasë? Ç'është ajo nënë që ofshan tej frëngjive?

Ishin nisur që herët në mëngjes një karvan dasmorësh, me një djalosh dhe nusën e re, të vinin kurorë në katedralen e Ohrit. Tashti askush s'mund të merrte vesh fatin e tyre.

\* \* \*

Bar i butë në livadhet e Rajcës, ku u ngritën çadrat e Pashës. Dhe Mustafa Arnauti, i lodhur nga lëkundja mbi kalë në përpjetën e Resnjës, i vrarë kërcinjsh nga lëkura e fortë e shalës, si i shkallmuar kryqesh nga koha e gjatë sipër kafshës, hyri në tendë e si calik u përplas mbi shilten jalli, te direku i mesit.

«Mbrëmje në Arbëri!» Ai gulçoi si një ka i lodhur, me këmbë të mpira, me sy të mjergulluar. Pastaj rrëkëlleu trupin e ra në shpinë me sytë në tavan të çadrës. Hieja e fletëve të lisit, që binte përmbi cohën e lartme, krijonte atje figura të ngatërruara, me të cilat Mustafai s'kishte ndër mend të merrej. Erdhi Emineja nga Konja, e dëgjuar në të gjithë Edrenenë për gjellët dhe magjen e saj. Ajo solli lëng prej mollësh Ohrie.

Nga krahu i majtë i çadrës vinin zërat e femrave të haremit. Pashai vu buzën në gaz dhe nënëqeshi me ironi. «Mos merr harem në luftë», i pat thënë një sanxhak-bej pa dhëmbë. Por Mus-



tafai s'e hante atë tek. I qe përgjigjur: «Në atë arbëri kaçakësh, në atë trevë ku mërzejnë hajdutët, na rriten portokalla të artë, rrush i ëmbël e ullinj plot lyrë; atje, o sanxhak-bej, femra të është e dashur, si uji në shkretëtirën e Saharasë!»

Vinin gjer këtej zhurmat e haremit, zëri i hollë i eunukut Zafer, si kollitja e një këndezi, fëshfëritja e atllaseve, gurgullima e lëfytit të ibrikut tek derdhte ujë, e pastaj një këngë apo një vajtim. Të mjerën Fatma Kirgizen, gjatoshe me sytë e zes, e ka marrë malli për nënonë, e ka marrë malli për mullirin me erë majë kodrës, e ka marrë malli ndofta, për gurët e Kirgizisë, që kurrrë më s'ka për t'i parë!

Gurguleja e ushtrisë vinte që larg, kurse nobetçinjtë aty afër, s'pipëtinin fare, nga droja se prishnin gjumin e pashës.

Ra nata e bashkë me natën një gjumë i rëndë, një gjumë si plumb, me hie e gulçima, si nuk është zakon as livadheve të Rajcës, as maleve të Arbërisë.

Zhurme nga përroi lart. Një suvari nxitonte këtej, duke rrahur me yzengji barkun e dirsur të kalit arab. Lajmësi i raporton dikujt nën errësirën e plotë të drurëve:

— Një karvan arnautësh ra në pritë. Rojet u grinë nga jeniçerët. Nga tufa e karvanit këtu sollën vetëm dy.

Pashai kërceu përpjetë. Kuptoi që lajmësi gulçonte si në përpjekje, ku (me sa dukej) kishte qënë edhe vetë. Mustafai doli. S'kishte nevojë të pyeste. Fryta e trupës së jeniçerëve dukej në të parë. Nën dritën e një feneri sillen dy të huaj.

— Dritë! dritë! — bërtiti ai.

Rendën njerëz t'u japin zjarr pishtarëve, dikush këputi një kopaçe sallgëmi, kurse që nga tendat e pasme nxituan këtej hie ushtarësh, duke tundur nëpër duar fenerë e kandile gjithfarë ngjyrash.

«Paska ngjarë përpjekja e parë, gjakosja e parë dhe... me emrin e Allahut, i qofshim falë, kemi këtu shënjen e fatit apo të kobit të pritmë...»

Jeniçerë me bigat e mustakëve ngritur lart, me kamat përpjetë, bëjnë çmos që t'u bjerë në fytyrë drita e fenerëve. E duan këtë që pashai t'i shohë, t'u thërresë aferim, t'u rrahë supin, por Mustafai s'e ka mëndjen te ata. Ai vështron një djalosh të lidhur. «S'ja kanë hequr mantelin e purpurtë që të duket çmimi i tij i lartë. Oj... pas tij një grua...»

Jeniçerët flasin për «byrazerin kaur», qatipi mendon për ndonjë dukeshë venetiku, por pashai i njohu në të parë. Djaloshi i lidhur bërtet e shan në gjuhën e vet, kërkon terxhuman të kuvendojë, përpjek këmbët e kërkon ndihmën e Zotit.

Mustafai hesht si i gurtë dhe me mëndje peshon vlerën e asaj koke...

— Hiqjani perçen robinës dhe nxirreni përpara!

Vajza del vetë me një çap aq të shpejtë, sa Mustafait iu kujtua një brofje e tillë femre diku në kujtesën e tij.

— Ne nuk e fshehim as fytyrën e as shpirtin tonë, o pashë i huaj. Një gjenerali s'i ka hie të matet me gra e me dasmorë!

— Përse i flet, kur ai s'të kupton, — ja preu Spani i lidhur me vargonj.

Vajza mbante krahëve një pelerinë prej cohe, me një të kuq si e ka lulja e shegës.

— S'duan të tregojnë emrat, — raportoi dikush.

«Këta sy të mëdhenj burri! Pooo; kështu i kanë meshkujt e Mokrenës.»

Mbi një tabak të argjëndë u sollën një tufë kartërash. Qatipi u krrus nën dritën e fenerit dhe lexoi: «Atit të shenjtë të katedrales së Ohrit i falem me besë për djalin tim, ta kurorëzojë me trimëreshën Larasqinë. E kemi zgjedhur për nuse këtë vajzë bariu, sepse të pesë vëllezërit e saj ranë në luftë kundër kjenit turk.»

Me të dëgjuar këto, pashai bëri të largohet e Spani gati u tërbua prej zemërimit. Pashai ktheu shpinën e Spani përpoqi këmbët. Por një sharje i përvëloi Mustafait, në çast u kthye dhe ngriti grushtin lart. Buza iu drodh, pastaj e kafshoi atë buzë tinzare, por Spani kuptoi... Kuptoi se kish-te përpara një renegat.

— Kokën time e fal për nderin e kësaj vashe, që është gruaja ime. O njeri i kësaj toke, diçka do të të ketë ngelur në shpirt nga zakonet e maleve tanë. Lere këtë femër të kthehet në shtëpi të vet dhe unë flijohem për të...

Mbi mjekrën laramane u ravijëzua një nënë-qeshje ironie.

— Asgjë të re nuk më fale, përveç atyre që i kam. Jeni të dy robër, ti po deshe hyrë në shërbimin tim dhe...

Pashai s'e mbaroi dot fjalën, sepse djali e pështyu mu në fytyrë. Këtu Mustafai nuk u përmbajt. U lëshua përmbi Spanin e qëllloi me grush-

te, me shkelme, me gjunjë. Por ai s'ju përunj. Sa herë qëllohej ai i bërtiste: — Bjerë, o kjen turk, bjerë o kjen tradhëtar! — Vajzën e përmbanin jeniçerët, edhe ajo shante e bërtiste, por pashai s'kish ndër mend të hiqej. Rrahu e qëlloi, sa edhe ushtarët e tij ulën kryet e s'pipëtitën.

\* \* \*

«Si më tha sanxhak-beu në Edrene? Mos e merr haremin pas? Po ku do ta mbanja tani këtë kumbull arbërie?»

Komandanti mori vendim dhe i diktoi qatipit: Shkruar në kufi të Arnautistanit kryengritës, më gjashtëmbëdhjetë të Prillit. I përunjuri shërbëtor i padishahut ju dërgon si fillim, kokën e një trimi arnaut...» Pastaj, si rrahu pëllëmbët, hungëroi ngadale:

«Robina të kallet në harem, djalit t'i hiqet koka, t'i kripet fort, të mbështillet me fletë pjer-gulle e të çohet në Edrene, në pallatin perandorak.

\* \* \*

Natë në Arbëri. Pashai i kaloi dy të tilla në livadhet e Rajcës. Kishte lëshuar hafijet natën, të vërtiten nëpër vëndet e armikut, dhe priste kthimin e tyre. Dhe sa të vinin spiunët...

Robinën e re e solli para tij eunuku Zafer, që u hoq menjëherë. Larasqina, veshur me rrobat e nusërisë, me fytyrën të ngrirë nga kobi i

saj dhe nga fati i panjohur i Spanit, qëndronte si e gurtë përpara tij.

— Ti je në haremin tim dhe mund të bëhesh gruaja ime!

Ajo mbuloi fytyrën me duar dhe u drodh:

— Unë gruaja jote? Ti je turk!

— Që këtu i kam rrënjët, ndaj dua të kem grua një çupë të këtyre anëve. Unë jam arbër, a nuk më dëgjon si flas?

— Dhe komandon një ushtri të huajsh!

— Përse çirresh si mace e egër!?

— A s'janë mjaft këto që ke brenda?

— Atëhere zgjidh, ose gruaja ime (grua pashai) ose nesër të dorëzoj te nobetçinjtë irakenë...

Ajo e vështroi me mllef dhe i erdhi ndoht prej atij njeriu. Mustafai rrahu duart dhe u duk eunuku Zafer.

— Merreni! — urdhëroi ai, — do zbutet vetiu.

Sa hyri në çadër të haremit, gratë iu derdhën. Dëshën ta pyesin, deshën diç të mësojnë, por gjuhën s'ja dinin. Kur Larasqina u qas te feneri, ata ja panë tiparet e ngurosurat të fytyrës, veshja e saj s'kishte asnjë shënjë rrudhe dhe kokën e mbante lart.

— Do ta pësosh keq! — iu çuar eunuku.

— Keq do ta pësosh, — përsëritën gratë, që iu mblodhën rreth, — edhe ne...

Secila pëshpëriti në gjuhë të saj, Larasqina s'i kuptoi, por çka thoshin i mori me mënd. Pëllëmbët e pashës rrahën përsëri, eunuku doli duke rendur e po ashtu u kthye. Çoi dorën lart e ngriti tregonjës, mënga e gjërë e këmishës së

lirtë iu çpërvesh e u duk llëra e tij e ngordhur. e rreshkur, me lëkurë si të bretkosës. Ai shenjon-te kirgizen!

Jashtë, nobetçinjtë po ndërroheshin: Yjtë jepnin e merrnin duke regëtirë, ushtria flinte. Flladi i maleve ushtinte nëpër lisat mbi Rodokal; kuajt hingëllinin, kurse buajt e qerreve, të zinj e të shëmtuar, përçapeshin ngadalë e u xixëllonin sytë në errësirë, si të ishin maçokë përrallash.

Mërzitur, pashai doli nga çadra dhe hodhi disa çape. Tutje nxinin malet e Mokrenës. «Mes tyre kalon Shkumbini e gjëmon lugina. Pa dale... gjuhëza flake lozin valle këtu, te shpati pranë. Hej! hej! Qënkan shumë, qënkan varreza ushtrie. Këtu u thye Firuz Pasha vitin që shkoi, dhe ato dritëza noprane lozin mbi varret e ushtarëve, që prehen atje. Medet! Armiku im është i fortë. Firuzin e mundi jo se ishte plak, por se ishte kokëlopë. Firuzi u kall në pritë si një loço. Por unë... o Allah, të qofsha falë, do të nuhas si dhelpër dhe do të luftoj si asllan. Grykat ja njoh këtij vëndi, po a është e mundur? Emri im a s'ka shkuar gjer në krahinën time? A thua njerëzit e mi do të luftojnë kundër meje? Cili do të jetë i pari syresh, që do të rendë në këmbët e mia? Po kush gjer më sot i ka shpëtuar zemërimin të padishahut? Askush. Ndofta Allahu më ka caktuar mua të jem hobeja e fundit mbi kokën e të pabesit synetlli, që mbretëron mbi arnautët. Çudi! O Allah, përse hieja e atij gjauri të pabesë i ka bërë për vete malësorët e këtyre shpellave? Ja, gjaurët po gatiten... «Mustafai vu pëllëmbën mbi vesh e ngriu në përgjim. Tutje, thellë Mokrenës, që nga majat e Biskaljes, tringëllinte gjithnjë një

këmbanë alarmi. Çape u dëgjuan në gurët atje pranë, pas tyre edhe zëra.

«Po vijnë zabitët për këshillin ushtarak.»

Krikëllitën zhurma metali, disa shpata hëngrën hekur e dolën nga këllëfët. Nobetçinjtë kërkonin parullat.

Komandanti u kthye në tendë. Atje dritat sapo qenë ndezur e kirgizja ishte larguar. Mbi këndet dhe divanet qenë shtruar qilima të trashë. Perdja me atllas mavi rrudhej pala-pala, kur që prapa erdhi gjer këtej era e mishit të pjekur. Pashai u kujtua: «Më parë do hamë darkën.»

U derdhën brënda shërbenjësit, sollën sofren e madhe, mbi të lëshuan tepsitë, që avullonin. Emineja nga Konja rendte dhe nxitonte, tundte vithet, duke kukurisur nëpër tendën e madhe të pashait. Njerëzit u shtruan këmbëkryq në heshtje, sepse Mustafai s'po hapte gojën i pari. Ai vu re rregullin ushtarak. Të parët që u shtruan ishin yzbashët e jeniçerëve, bimbashët, mylazimët, kurse një bashçaush, ai që mbante kartërat ushtarake, qëndronte më këmbë si qiri. Priste urdhërin e pashës.

— Ulu edhe ti!

Mustafai pati shijë prej ujku dhe lakmoi të gllabërojë veshkat e ngrohta të një shqerre të pjekur, pastaj çkuli një zverk dashi dhe e preu në thella të holla me satër. Një mylazim u çudit me shkathtësinë e komandantit, kurse një bimbashi plak ja mbuluan nënëqeshjen, dy bigat e mustakëve të livarur rreth gojës. Mbaruan së ngrëni të gjithë, por Mustafai jo. Ai hante me bullçitë e fryrë, e ngrinte me hov poçin me ujë,

rënkonte një çast e përsëri derdhej si ujë, me thonj e me thikë, përmbi dashin e skuqur. Yzbashi i jeniçerëve, që kishte bisedë me komandan-tin, i pëshpëriti: — Edhe unë, kur shkoj në Konjën time, s'nginjem dot së ngrëni...

Pashai iu këthye një gjeli të zier, që lëshonte aromë limoni, kullufiti samarnikun, e xhveshi të tërin dhe koskën ja flaku Eminesë nga Konja.

— Pa e shih!

Ajo e rrëmbeu, qeshi për nderin që iu bë, e çoi lart dorën kundrejt dritës, ndërsa i ndritnin thonjtë nga lyra e mishit.

— Allahu është një dhe i madh, i qofshim falë! Padishahu është mëkëmbësi i tij në tokë dhe i qofshim falë. Shenja flet açik. Fitorja është jona!

Tenda e madhe përshkundi në erë fletët e veta, sepse brohoritë dhe thirrjet u ngritën deri lart. Të gjithë qëllonin me thika e lugë përmbi tepsitë e mëdha të revanive, kurse sytë e tyre të ndezur ëndëronin karvane me robër arnautë, lidhur me pranga. Gratë e haremit flinin. Eunuku ishte strukur në një qoshe e dridhej si zagat nga e ftohta e natës. Veç Larasqina s'mund të vinte gjumë në sy. Ajo ishte afruar te fleta që ndante çadrat, e nëpër filiçen e një kopse vërente orgjinë e shtabit turk. Çka flitej turqisht ajo s'e kuptonte, por çka fliste pasha ajo sikur e merte me mend.

«Mos vallë nga shënjat apo mënyra e të folurit të tij?»

Por fare pa prituri pasha u prish në fytyrë



dhe sokëlliu fort, u kthye nga e majta e diç mundahej të kapë me lugën e vet. Larasqina u çua më fort në majat e gishtave.

— Shihni, vini re, — bërtiste Mustafa Pashë Arnauti. — Ja, një kandër e çuditshme!

Pasha rrahu pëllëmbët dhe kërkoi një kaci me prush. Ja sollën menjëherë, me gjithë çka duhej. Ai me mashë në dorë, sajoi një çark me thëngjij në mesin e një tepsie. Pastaj lëshoi akrepin në mes të kongjijve të ndezur.

— Shihni këtu!

Të gjithë u çuan më gjunjë dhe hapën sytë. Edhe Larasqina po ashtu. Kandra e shpejtë, lavrake e tinzare, desh të ikë, të largohet. U lëshua në një anë, në tjetrën, u kthye prapa, përsëri nga e djathta, nga e majta... thëngjij e zjarr nga çdo anë. U kthye në qëndër të rrethit, çoi lart bish-tin e vet të helmët, me të shpoi shpinën e saj e në çast ngordhi në vënd. Zabitët, që ishin më gjunjë lëshuan ofshamje habie dhe ranë mbi vi-thet e tyre:

— Akrep i çuditshëm! Trim akrep: ku e gjen atë kurajë!

Por habia nuk vijoi më tutje. Kur njeri nuk e priste, nga gurmazi i Mustafait dolli një rënkim i thellë. Ai mbante barkun me dorë, balli iu zbeh, bulçitë iu mavijosën, i dridhej nofulla. Pashai ishte sëmurrur aq pa pritur. Vallë çfarë i ra rëndë Pashës? Mishi i pjekur, gjeli i zier, uji i malit, era e Arbërisë apo të gjitha bashkë?

— Jashtë, të gjithë jashtë, — bërtiste yzba-shi i jeniçerëve, — çelni fletët e çadrave. Të vijë mjeku!

Një rrëmujë e tërë hyredaljesh, një buluritje

e zallahi. Secili nxitonte të marrë armët e veta e të bëjë përjashta, i kërkonte e s'i gjente dot. Shërbenjësit nxitonin të hiqnin sofrat, lugët, thikat. Këto zvariseshin shtyheshin më tutje, rrëmbeheshin, përmbyseshin mbi kanistrat. Emineja nga Konja për t'i mbuluar të gjitha u hodhi përsipër një qilim të ri. Më në fund ndjehej vetëm rënkimi i Mustafait, që, i zverdhur e grinjar, s'mund të qëndronte në vënd. Dridhej, pështynte, rrëkëllehej dhe mbliidhej kutullaç.

— Kujdes, shtoni rojet, — bërtiste yzbashi, — ndofta gjauri i pabesë ka futur hafije e na ka helmuar komandantin, pret fundin e tij dhe na vër-sulet në errësirë!

Arrijti mjeku. Pas e ndiqnin jeniçerë me pishtarë në duar.

— Zhdukeni këtë tym të mallkuar! — Ata i ngulën pishtarët në tokë.

Mustafait ja zbuluan barkun, gjoksin. Mjeku e shihte mbarë e prapë, por komandanti s'mund të rrinte dot pa u përpëlitur. Nga fjalët që thuheshin, Larasqina atje tek përgjonte, asgjë nuk kuptonte, por... nga rënkimet po. Se mund të flasësh gjuhë të huaja, mund të mësosh gjuhë të tjera rrugëve të botës, por rënkimin e ke tëndin, të gjuhës sate.

Larasqina u habit. «Çudi ky njeri kaq trup-madh, ky njeri kaq i fuqishëm, paska një bark kaq të bardhë, kaq të ngushtë e kaq të butë?»

— Ka lakmuar tepër, — foli mjeku, — duhet të vjellë. — E duke iu kthyer ndihmësit: — Shpejt gatit ujë me sapun...

Larasqina s'kuptoi çka do të bëhej, kur pa-

shai kërceu si epileptik, zgurdulloi sytë, përplasi kryet mbi shiltenë e butë dhe rrahu tokën me grusht:

— Nënë, o nënëza ime!

«Qeni, qeni s'duroi dot, s'u mbajt dot, kujton nënën në gjuhën e vet, bërtet arbërisht, lutet arbërisht... Kështu të pafsha, o renegat dhe, nëse të kanë helmuar, kush është ajo dorë fatlume!»

Një pëllëmbë e thatë dhe e fortë ra në krye të saj, e kapi për flokësh dhe e tërhoqi.

— Arnaute, gene, bjer në shtrat se të dermova.

Ishtë eunuku Zafer që, duke dashur të pëshpëritë, nxirrte një zë të mekur e të çuditshëm, që Larasqina s'e pati dëgjuar kurrë. Ajo hyri në shtrat dhe filloi të falet. Pëllëmba e eunukut ja pati prishur flokët e ata tashti i derdheshin gjoksit e përmbi gjunjë.

\* \* \*

Larasqina vu veshin. Për çudi, tashti kishte rënë një qetësi e plotë. «Pa dale... Errësirë. Vetëm era ulërin, po s'është erë, veç një fillad i hollë, që tund lehtë barqet e çadrave, zbret tatëpjetë, ze fishkëllon lehtë në grykat e maleve. Kam dy ditë që s'e kam parë qiellin, e kuptoj që qielli është i pastër, pa re, pa hënë, pa dritë, por me yj të dëndur që xixëllojnë larg». Eunuku flinte e gërhiste i strukur diku. Ajo u ngrit ngadalë për të mos ndenjtur duarkryq. U zvarris me duar e me këmbë drejt perdes prej atlasit mavi. U mu-

ndua ta gjejë brimën e njohur. Më kot. «Edhe matanë errësirë. Pashai nuk qënka atje? E kanë hequr? Ka vdekur?» Larasqina vu veshin. Matanë një frymëmarrje, vetëm një. «Po. Është frymëmarrja e tij. Ai është shëruar? Si është e mundur? Po unë do ta vras, do ta ther, do t'i ngul shishin në trup e do ta bëj shoshë atë trup të urryer prej tradhëtari.»

Asaj i ngeli mendimi përgjysmë. «Dhe për çudi, ai burrë aq i fuqishëm, paska një bark aq të bardhë, aq të ngushtë dhe aq të butë». Larasqina u kërrus, ra për tokë, kërkoi fundin e atllasit, e gjeti. E çoi lart, hyri matanë. Tashmë ajo kishte marrë një vendim. «Po sikur të zgjohet tashti eunuku Zafer?» Ndjeu nëpër rrëmba gjakun e malësorës arbëreshe. Por tashti i duhej një armë. I duhej me doemos. Ishte errët. «Po a gjendet armë në errësirë? Po. Kur arbërit i është dashur arma në errësirë, ai e ka gjetur.»

Ra më gjunjë, jo për t'u falur. Filloi me të gjithë gishtat e duarve të kërkojë, të rëmojë, qilimeve, shilteve, këndeve pëllëmbë pas pëllëmbë, qosh pas qoshku. Diku, mollëza e butë e Larasqinës, preku hekur të fortë. Ishte një shish i shkurtër jeniçeri. «Ja thika, arma! Vegla e vdekjes. Nga dashuria që kemi për të, disa na urrejne, na shajnë, na mallkojnë, na përbuzin: çifuti paranë, arbëreshi armën! Po! Armën. Veç me armë mund të çlirohesh.»

Dhe Larasqina u lëshua me shishin nër duar dhe me një urrejtje të tërbuar në shpirt.

Kur u kthye, gryka i lloçoiste, fytyrën ja rrahu drita mavi e një feneri. Atllasi ishte për-

ngritur, dukej koka e shëmtuar e eunukut Zafer; ky ishte zgjuar. «Mos vallë ai bërtiti si derri, kur i ngula shishin në bark?... Ndofta. Ku ta dish! Unë as pashë, as dëgjova gjë, veç nuhata dhe qëllova.»

Zaferi pa majën e shishit ngritur lart, që kullonte gjak.

— Arnautë! Ç'ke bërë?

Pas tij, fërfëllimat e atllaseve, dhe një pas një u dukën fytyrat e lemerisura të grave të harmit. Me duart e bardha plot bylyzykë, ato kapnin faqet dhe çaplonin sytë.

— Ç'bëre arnautel?

Por askush s'guxonte t'i afrohej, se shishi i vogël akoma kullonte gjak. Por tashti ishte agimi. Kishte rënë vesë. E për rreth ishte një qark i hekurt. Qarku i një ushtrie të tërë. — «Ç'mund të bëj unë tashti për atdheun tim? Po. Për atdheun bëra gjithshka. Kur presim kokën e një përbindshi, krahët e tij bien vetiu. Po për vete ç'mund të bëj? Asgjë tjetër, veçse të shpëtoj ndërin tim. Një arbëreshe e gjallë në dorë të armikut? Jo! Jo».

Asaj iu kujtua akrepi në qarkun e zjarrit.

«Po, unë jam akrepi në qarkun e zjarrit, unë...»

## TE SHKRONJA K E ALFABETIT

**A**saj kohe ne kishim një copë vreshtë. Trua-lli i saj shtrihej në faqen e një kodre, ku dielli rrihte gjithë ditën. Ngastra ishte me tokë të dobët dhe shihte vetëm Jugën, kurse Veriut, sikurse thoshin, i pat kthyer shpinën. Vreshta që e vogël, kishte aq vend sa mund të zhgrryhej një pelë dhe ishte e rrethuar anembanë me gjëmba e manaferra, si kala.

Si thashë, dheu ishte i varfër dhe i kuq, por lavdi krahëve dhe vullnetit, për hir të gazit të fëmijëve, motra ime e madhe dhe babai mbushnin thasë me plehë, i ngarkonin në kurriz dhe o burra përpjetë. Kështu vreshti ynë ishte një gëzim, që mbahej me djersë të ballit e mundim të krahëve. Në pranverë, atje punonte dikeli për rëmihje dhe gërsëra për krasitje. Që të mos mbetesh prapa edhe vetë, ngarkonja qerren time me dy-tri lopata fushki dhe ua çoja hardhivë. Kur s'kishte njeri aty pranë, unë e vendosja plehun tim mu te kërcelli i një hardhie, që e quanim «leckapane» dhe hyja në bisedë me të. E këshilloja që ta thithte mirë ushqimin, që i sillnja, i premtonte edhe fushki delesh në pranve-

rë, i premtanja edhe stomna me ujë në verë, por me kushtin e vetëm që vjeshtës tjetër të mëpiqte ca xhigerë të mëdhenj e të ëmbël, të cilët kisha qejf t'i pres me gërshërë, bashkë me kërcëj, e t'i var nëpër trarët e shtëpisë.

Kur vinte Gushti, unë dhe shoqja ime fqinjë, shkonim lart në vreshtat. Por gazi më i madh i yni ishte jo që ta ruanim, por që të futëshim në kaliben prej kashte e të përgjonim njëpër një ato kokrrat e vileve, kur nisnin e merrnin ngjyrë të ndezur. Prisnim të skuqen rrush-të e zinj ose të marrin ngjyrën e dyllit ata të bardhët. Pastaj u vinim afër një shami bojëvishnje. Skuqej një xhiger... ne mënjanonim dy-tri fletë që ta shihnin edhe xhigerët e tjerë, se jo më kot thuhet: sheh rrushi rrushin e skuqet! Por e mbaj mënd fare mirë, thanim gojën gjithë ditën e nuk sillnim në vresht kumbulla. Kjo sepse, sikurse na thoshin, rrushi është sa i mirë aq edhe krenar. Ai fyhet nga kumbulla e thartë e prej mërisë dhe inatit mund të vendosë e t'i hedhë poshtë gjithë kokrrat e fletët e të bëhet copë e trokë.

Pra, një ditë të atij gushti unë isha shtritur me shoqen time në mes të kërcëjve me xhigerë; fletët e gjelbra na lëmonin faqet, kurse rrushtë na e bënë me sy. Ne ishim atje për t'i ruajtur e jo për t'i ngrënë, por askush s'mund të na e mohonte të drejtën tonë për t'i provuar e për t'i bërë me shëndet. Këtë të drejtë s'mund të na e mohonte dot as kryetari i komunes, Frroku, megjithë ligjet e dëfterët e tij. Atëhere pa shkuar fare ndër mënd se po hanim, shtrydhnim në gojë kokrrat e shijshme e shiheshim sy më sy:

— A janë të ëmbël?

— Po.

— A u poqën?

— Mjaltë e sheqer.

Anembanë vinte era e kashtës, e bykut dhe e stërnishtave, se ishte koha pas lëmit. Ajri ishte i freskët, kurse nëpër kaçkat aty pranë, pëllumbeshat ngjyrëhiri guisnin e cyteshin me njëra jatrën. Duke provuar kokrrat e rrushit ne përjashtoheshim nga e drejta, e drekës dhe më zëmërherë mund të shkundnim për të ngrënë ndonjë kokërr arrë. E qëronim me duar nga çoçaniku, aq sa gishta e buzë na nxiheshin nga ai lëngu i athët, që vjen erë si jod.

Kështu ishte jeta jonë asaj kohe. E thjesh-të dhe e varfër. Le që ne asaj kohe as dinim më shumë, ishim çiliminj shtatë vjeçarë dhe qemë mësuar ta shohim veten tonë me bukë e pa bukë, mbathur ose zbathur. Mbret e zot për ne, asaj kohe ishte Froku, kryetari i komunes aty te fshati afër, po për këtë do të flasim më tutje.

Pra, atij moti, mbaj mend se kisha në zemër një shqetësim të tillë, sa shpesh herë më bënte të më thahen buzët e të më dridhet diçka në lugun e gjoksit. Më thoshin se isha rritur, isha bërë goxha djalë e do të shkoja në shkollë. Në agim herët kaloja nga pellgu i madh i lumit e, sa zbardhej kubë e qiellit, ulja sytë dhe vështronja veten time në ujërat. Euh! sa burrë më tregonte hieja e mëngjesit. Besa-besën s'kishte shok të më delte përpara, unë isha rritur, isha bërë tamam djalë.



Me këto fjalë u lëvdohesha në shtëpi. Babai e motra më jepnin hak, gjyshi më shtonte edhe veti të tjera, aq sa më dhanë edhe lugë në sofër.

— More qeratai, — tundte kryet babagjyshi, — shiko si e mbush lugën me dhallë... vesh më vesh, more qeratai.

Pa, si më pranuan në sofër si të madh, fustanen ma hoqën e ma kthyen në pantallona e, pas gjithë këtyre, më thanë se burrat s'mbajnë prazhdë prej litari, leqe prej komi e as llastika prej llastiku. Këtu u zura ngushtë, dhe... ç'është e drejta, unë e di si pranova. Psherëtiva dhe i vështrova gjithë të shtëpisë sy më sy, sikur u kërkoja mëshirë. Lashë çka më kërkonin e i këmbeva me një libër të hollë, që unë asaj kohe e quaja «kapedare».

Dhe me që e sollëm fjalën larg e larg, më takon, t'ju them se, pasi folëm për kohën, për moshën e për gjendjen... këtu merr fill edhe ngjarja, që kam ndër mend t'ju tregoj.

Një pasdreke, kur unë e shoqja ime po qëronim nga cipa disa thelpij arre, rrahën disa çape në rrugicën e vreshtave. Dukesh që ishin çape prej këmbe të vogli e të zbathur. Prej të vogli, sepse ishin të shpejtë; të zbathur, sepse përplaseshin pas patozit të udhës, me një zhurmë që e njuh vetëm ai që ka rendur zbathur rrugëve me gjëmbe. Tej manaferrave u duk shoku ynë, Ceni, me sytë e çapluar, me gjunjët plot gërvishtje, i nxituar dhe i paduruar.

— Erdhi mësuesja, erdhi... erdhi...!

Ai s'pritti t'i japim as arra e as rrush, po ja dha vrapit tatëpjetë, duke ngritur lart dorën, si

për të na kujtuar se ja kishim borxh një herë tjetër.

Në oborrin e Risto Blirit ishte një rrëmujë e tërë. Atje do të banonte mësuesja e posaardhur, sepse ajo shtëpi ishte pa njerëz fare, i zoti i saj i vetëm kishte vdekur me kohë. Tashti atje po hynin vajza e gra, po për të dalë s'dukej njeri. Kalamaj si unë silleshin poshtë e lart, por s'mund të hynin. Hyrja jonë bëhej vetëm atëhere, kur nëna e secilit vinte atje dhe mernte fëmijën me vete. Se ishte një oborr i pashkelur, bari ishte rritur, borziloku ishte rrëzuar, kurse lule të verdha kishte aq shumë sa duke kaluar njerëzia i shkelnin me këmbë. Ishin disa lule të verdha me kurorë të dendur, me petale të shumta, që kishin formën e gjuhës së zogjve. Edhe sot e kësaj dite, sa herë shoh lule të verdha më kujtohet mësuesja dhe ato ditë të vegjëlisë simë, që s'kthehen më.

Dilja në rrugë, shihja kush afrohej, këmbën e zbatuar e rrihja pas tokës, sepse nëna ime kishte vdekur me kohë, unë kurrë s'e njoha atë dhe prandaj s'kishte kush të më futte te mësuesja. Nderin asaj dite do t'ja dinja një tetoje nga babai, e cila kur më pa të ligështuar, u kërrus e desh të më futë brenda, duke më mbajtur më krahë. Unë s'mund të pranoja një poshtërim të tillë dhe gjunjët e mi dhanë disa përpëlitje t'ëgra, sa tetoja e mirë u skuq e u ndez në fytyrë më keq se unë... e më lëshoi përdhe sikur t'isha calik. Fill atëhere u duk në oborr motra ime e madhe dhe dy hapa para saj (por nën hien e saj) hyra. Atë fytyrë të ëmbël e të hieshme të mësuese, s'kam

për ta harruar kurrë. Ajo që kisha përpara ishte një vajzë e rritur me flokë të zes, me sy të zes, me fytyrë të bardhë e vezake, kurse në zërin e saj kishte një timbër të tillë, sa edhe sot e kësaj dite (ka dridhjetë e sa vjet që s'e kam hasur), pra edhe sot e kësaj dite atë zë e mbaj mënd e mund ta dalloj në të folurin e një turme të tërë. Ajo u përshëndosh me motrën time e, megjithëse kurrë s'ishin parë, u puthën buzë më buzë, u qafuan e kur sytë e motrës sime shkanë një çast nga unë — eh, çfarë çasti ishte ai! — mësuesja u përkul, më mbështolli fytyrën me duart e saj të bardha e të buta, më kapi ashtu sikur unë të isha një tufë me lule e ajo do ta çonte lart. M'i puthi faqet, ballin, kurorën e flokëve në ballë, që e kam si erashkë, më shtërngoi në krahët e saj e bile më puthi edhe në duart. Unë desha t'i fsheh ato duar lugati të nxira prej çoçanikëve, po... Diçka e papritur për mua: ajo hapi vend afër saj e më mbajti atje. Këtë s'e bëri për asnjë tjetër. Vallë çfarë i pëlqeva unë? Mos vallë shpirti i saj i ndjeshëm parashikoi se, pas tridhjetë e sa vjetëve, unë me duart e zeza, unë me këmbët e palara, unë me gjunjët e gërvishtur, unë... do shkruaja me kaq mall e dhëmshuri për atë mësuese, që në një farë mase zuri vendin e nënës sime! Ku ta dish? Ndofta. Dhe ju betohem se brenga ime në ato çaste ishte shumë e madhe, s'dinja ku t'i fut gishtat e nxirë dhe gjunjët e palarë. Nuk di nëse do të më besoni, por ju flas me të dy duart në zemër: atë pasdite i fërkova gishtat pas gurëve të lumit, i lava këmbët me sapun e i krojta aq fort, sa i gjakosa. Të nesërmen

në mëngjes isha para shkollës i pastër si një pëllumb.

Fillova të shkoj në shkollë. Por veç këtij ndryshimi të madh, në jetën time ndodhi edhe diçka tjetër. Një ditë, kur mbaruam mësimin, mësuesja urdhëroi të dalin të gjithë jashtë e veç unë të mbetesha në bankë. Sa të gjata m'u dukën ato çaste gjersa u zbraz klasa... e ku nuk më shkoi mendja? Ku? Ç'do më thoshte vallë? Mos kisha bërë ndonjë faj? Por minutat kaluan, mësuesja m'u afrua e më ndejti pranë; tashti e kisha aq afër fytyrën e saj, zërin e saj! E kuptova që s'ishte fjala për ndonjë të keqe. Dhe sa shumë kisha dëshirë që ajo të më mbante afër! Sa shumë! Unë isha pa nënë dhe e ndjenja fort mungesën e saj. Mësuesja më pyeti më nge për njerëzit e shtëpisë sime, më lëmoi ballin dhe, kur në një rast, ajo zu ngoje nënën time, mua m'u drodh buza gati për të qarë. Atëhere ajo më tha:

— Shko i thuaj motrës sate të vijë tashti këtu.

— Po unë të vij sërish?

— Po deshe eja.

Time motër e gjeta në kopsht; po mblidhte domate. Gërsheti i madh i qe varur pas shportës dhe e kërrusur si ishte më pa drejt në sy:

— Mos ke bërë ndonjë faj?

— Jo, moj, jo... po shpejt, tashti.

— Po dale, se kam kusinë në zjarr.

— Lere moj, lere, tashti... tashti...

U vendos që çdo natë unë të flija te mësuesja ime. Kjo më habiti dhe, dashur pa dashur, i thashë tim gjyshë se mësuesja më donte afër.

mua, sepse kishte frikë prej hajdutëve, prej luge-terve ndofta, edhe prej minjve. Im gjysh, që më shkonte gjithë pas voljes, por që në këtë rast tallej pa e kuptuar unë, më tha se fjalët e mia ishin me vënd e se s'duhej bërë tevaturo poshtë e lart... kjo për shkak të emrit të mirë të mësonjësës sime.

— Po a s'të kam thënë, more bir, se ti je goxha djalë, trim e sypatrembur? Kështu je sot e trim më i madh do jesh nesër. Ti fare mirë mund ta mbrosh mësuosen edhe nga një div!

Pastaj ngjau diçka që më vuri në mendime të thella, më vu në dëshpërim e në habi e sado që mundohesha t'i hyj brenda arësyes dhe ngjarjeve, kurrë s'isha në gjendje të kuptoj të vërtetën. Asaj dite kishim arritur te shkronja K e alfabetit, kur dikush, pa trokitur, çeli derën e shkollës e hyri brenda. Këtë njeri unë e kisha parë edhe herë të tjera. Ishte Frrok Çali, kryetari i komunes. Ne, në çast, djem e vajza u ngritëm më këmbë, si e desh mirësjellja, por ai mblodhi buzët si të na përqueshte e u drejtua nga mësuësja.

Frrok Çali ose zotni Frroku, si e thërriste Hysen pojaku, po e vështronte mësonjësën me ca sy të ndezur dhe i veshur fringo me rroba të reja. Frroku i kishte nja tridhjetë vjeç, ishte me shtat të lartë e të hedhur, kurse në fytyrën e tij binte në sy më fort ajo hunda e tij e hollë dhe me majë të ngritur përtpjetë.

Asaj kohe ishte moda për zotërinjtë që kostumi me stofë të shtrenjtë angleze të kishte edhe një jelek. Dhe ky jeleku qepej me mostra, si xhaka-

të. Pantallonat duhej që, përbrenda së kthyerës, të kishin një copëzë zinzhir fermuari. Dhe ja, kështu i kishte edhe Frrok Çali. Ai kishte edhe mustaqe të holla e flokë të ndritshëm, të zes e të krehur me kujdes. Për flokët e tij thoshin shumë fjalë dhe unë, duke i dëgjuar ato fjalë, për një gjë habitesha: «Si është e mundur xhanëm, si ka pranuar ky goxha Frroku të ulet gjunjazi te dritarja e maçoku t'ja lëpijë leshrat!»

Një grua u fliste një ditë shoqeve të saja, në çezmë: «— Frroku, kur sheh çupat tona, hap buzët e vërtit gjuhën nëpër dhëmbë, sikur kërkon t'i ketë sheqerka nëpër gojë.» T'ju them të drejtën, këtyre fjalëve s'u hyja brenda fare, fare.

Frroku vijonte të flasë me mësonjësen, por ajo e shihte aq me inat e i përgjigjej aq shkurt, sa kryetari mend tërbohej. Me një kamxhik të hollë që mbante në dorë rrihte çizmet e veta të ndriçme, kurse fytyra e tij prej sqimatari ndërronte pamje orë e çast.

Kaq herë mësuësja u kthye nga ne të fillojë mësimin: Pra, shkronja K është shkronja e katërmbëdhjetë e abetares...

Në këtë rast, kamxhiku i kryetarit lëshonte një «çif» duke u përplasur e mësonjësjë nuk dinte nga t'ja mbajë. Në një rast vështrimet tona u takuan, ajo ndofta që e tronditur e nuk më tha asgjë, por unë u ngrita e shkova te dërrasa e zezë.

— Shkronja K është...

Por fjala më mbeti në buzë, se përsëri — çif çif e çif, — kamxhiku i Frrokut e çirte erën dhe qetësinë e shkollës. E dëgjova kur ai i tha asaj:

— Urdhëroni fëmijët të dalin jashtë.

Ajo e vështroi me inat dhe s'iu përgjigj. Habitesha: «Përse ky njeri kaq i lig, që bën të dëshpërohet mësuesja, përse kërkon që ne të dalim jashtë?» Atëhere Frroku na u drejtua neve:

— Delni jashtë!

— Jo! — bërtiti mësuesja, duke u zbehur në fytyrë — Jo!

Lëshova shkumësin për tokë, lëshova edhe këmbëzën e lepurit, me të cilën fshinim dërrasën e zezë dhe renda te ajo. Të gjithë nxënësit mbanin frymën, dëgjohej veç gulçimi i Frrokut dhe kamxhiku i tij — çif, çif, çif! Gjyshi më pat thënë se unë duhej të isha mbrojtës i mësionjësës. . apo jo? E pra, ja rasti, ja çasti, ja Frroku, ja i ligu, ja. . .

Ajo fytyrë bukuroshi u bë për mua dhe për ne surrati më i egër, më i urryeri, më i shëmtuari. Unë e kapa përdore mësuesen dhe ajo me dorën tjetër qarkoi kokën time. Shpatullat e mia ishin ngjitas me trupin e saj dhe ndjenja që ajo dridhej. Nga frika jō, se unë isha atje, dridhej nga inati dhe urrejtja. Më në fund Frroku përplasi kamxhikun për tryeze, këmbët për dysheme, dorën për dere dhe bëri përjashta.

Në fshat filluan të flasin për këtë ngjarje.

— Frroku shkoi në shkollë e kërkoi që nxënësit të ikin!

Flitëshin edhe plot fjalë e hamëndje të tjera, por unë asaj kohe s'kuptoja dot më shumë. Veç një nate, kur ramë të flemë, mësuesja më tha:

— S'është çudi, ndonjë dite ai. . . mund të vijë këtu.

— Këtu? — Unë e kuptova se për cilin bëhej fjalë, aq sa kuptova që ajo e kishte zor t'i

përmendë emrin, por më shumë s'mund të merr-  
nija vesh. Atëhere guxova dhe e pyeta:

— Zonja mësuese, të lutem më thuaj, çfarë  
kërkon ai prej teje?

Ajo u skuq gjer në rrënjë të flokëve, vësh-  
trimi iu turbullua, diçka iu drodh në grykë dhe iu  
mbushën sytë me lot. Unë kuptova që e shkela,  
kuptova që kreuva një faj të rëndë, ula kryet si  
njeri i kapur në faj, si njeri që pyet diçka  
të rëndë e të papërshtatëshme, por në fund  
të arësyes sime prej fëmije, ishte një bosh-  
llëk që s'mund ta mbushnja, ngrihej një py-  
etje, për të çilën vrisnja mëndjen më kot dhe as-  
kush nuk më përgjigjej, s'mund t'i bija më të  
kursesi.

— Ai mund të vijë ndonjë ditë edhe këtu, por  
ti të mos largohesh.

— Po sikur ai të më përzerë çfarë duhet të  
bëj?

— Në një rast të tillë ti të më hidhesh përqa-  
fe e të më shtërngosh fort.

— Të të hidhem përqafe e të të shtërngoj fort?

— Po.

E çuditshme!

Një pasdarke, ka qënë vjeshtë, bashkë me  
mësonjësen rrinim afër zjarrit, nën dritën e lla-  
mbës së vajgurit. Unë pata mbledhur një qese me  
lajthi. Ç'them qese! Një torbë të madhe plot e  
përplot e jo lajthi të bardha nga ato që mezi kaj-  
thiten, por lajthi të arrira të pjekura, lajthi të ku-  
qe e të paqme si flori.

— Ti ndehim lart në ballkon që të thahen.

— Kur të vish në shkollë ta mbushish xhe-  
pin plot.



— Do të të sjell edhe ty.

— Do më sjellish, po, pa tjetër.

Mësuesja ishte përkulur përmbi fletoret tona dhe unë isha kureshtar të shoh çfarë notash shënonte. Kisha marrë thikën në dorë dhe po mprihnja lapsin tim. Ajo herë pas herë më vërente mua, nënëqeshte e më këshillonte ta fut gjuhën në gojë, sepse «për të mprehur lapsin mjaft të është thika», kur... krisi skoba e derës, gërvishti kanata mbi mendshet dhe nga errësira e koridorit nxori kryet Frrok Çali. Mbi fletoren që kishte mësuesja shkau një vijë e kuqe. Ajo më pat thënë se ai «mund të vinte ndonjë ditë këtu». Por ja, ai s'po vinte ditën, porse natën. Frroku kishte çizme të ndriçme, fytyrën të përskuqur, dukej zemërak nga pamja, kurse damari i ballit i kishte këcyer një gisht. Si dukej ai kishte hyrë atje si hajdut, duke kaluar nëpër dritaren e koridorit.

— Hej, si je, oj kokonë e Frrokut!?

Ai foli kështu e vu duart në bel, si njeri i ngeshëm.

— Delni jashtë! — bërtiti mësuesja ime e thirri aq fort, sa edhe unë këceva më këmbë. Ajo po e vështronte me një shikim të egër, tërë inat e mllef.

— Joo, — u përgjegj ai, — una s'kam ndër mend të iki, kam ardhë si mik, a s'prisni miq juve?

Po habitesha. Buzët e atij njeriu herë thaheshin e herë njomeshin. Vështronte me një lakmi të çuditshme, me një nënëqeshje që sot mund ta gjykoj si prej zuzari, me ca sy që i lëshonin xixa. Çfarë desh ai njeri prej nesh?! Ja, këtë unë as e dinja e as mund ta kuptonja.

— Pash Zotin qiteni çunin jashtë, — kërkoi ai.

«Oj... ky dashka që unë të iki! Pra, prej meje ky njeri me të vërtet paska frikë!» Mësuesja i përsëriti edhe një herë:

— Delni jashtë ose përndryshe...

— Po dale, o gocë, na mund të merremi vesh me të mirë,

— S'ka se çfarë të merremi vesh, delni jashtë.

— Po prit, o vajzë, të bisedojmë një herë.

Ai tha kështu dhe na u afrua më shumë. Atëhere mësuesja më rrëmbeu nga dora thikën, me të cilën mprihnja lapsin, u kërrus dhe me dorën tjetër kapi gurin në vatrë, ku unë thyeja lajthitë.

Mendova se ai ishte çasti kur unë duhet ta kapnja mësuesen përqafe, po përsëri mbeta mëdyzaj. Me ato që mbante në duar, ajo ishte gati për luftë, s'duhej ta pengoja. Pa të shohëm...

Mësuesja mbante ngritur dorën, ku shtërngonte thikën, por unë s'mund ta kuptonja, as e dinja, as e mendonja se nër ato çaste arma e saj më e fortë isha unë. Unë isha strukur pas saj dhe në shpinë ndjenja gjurin e saj që dridhej. Nuk e di, ndofta ndonjë farë nuhatje imja, e brendshme, më bëri të kuptoj se nuk ishte koha e mbrojtjes. Për mbrojtje nuk mbahej në duar as thika e as guri. Duhej sulm. Dhe s'e bëra të gjatë. U kërrusa një çast, mbusha duart me lajthi dhe iu vërsula atij njeriu të lig, një herë, dy, tri. Ai bëri të nënëqeshë dhe duart i kalonte mbi fytyrë, si erashka, për t'u mbrojtur nga lajthitë, pastaj fare pa pritur qelqi i llambës u thye nga

qëllesat e mia, por llamba nuk u fik. Ai ktheu kryet andej, kur përmbi kokën time fluturoi diçka e zezë. Kishte qëlluar mësuesja me gur. Ushtoi një zhurmë e fortë. Llamba e vajgurit ishte goditur e bërë copë-copë. Vajguri u derdh poshtë e mori zjarr. Unë renda te dritarja dhe bërtita:

— Babagjysh! O babagjysh!

Frroku u zhduk prapa flakëve, u përplas dera dhe krisën shkallët. Mësuesja tërhoqi shkor-sën e këndit dhe e hodhi mbi flakët. Ra errësira në dhomë, ndriste fare pak vetëm prushi i zjarrit.

Urrejtja e gjithë fshatit për Frrok Çalin ishte si helmi i një kupe, që sa vinte mbushej më shumë. Dhe urrejtjen më të papërmbajtur e kishim në fëmijët e shkollës. Dhe më duket se kur fëmijët urrejnë, ata e bëjnë këtë në heshtje, përkundër natyrës së tyre, pa i treguar askujt.

Pastaj ngjarjet muarnë një rrugë të papritur. Atyre ditëve fshati do të zgjidhte rojtarin e arave. Frroku ngulte këmbë të mbetj Hyseni, që kishte qënë edhe më parë. Fshati donte Hasanin, që ishte njeri i nderuar, kurse ai i pari ishte treguar jo vetëm hajdut, por edhe spiun i Frrokut. Por kjo çështje, e vogël në dukje, do të bëhej shkak që të shpërthente stuhia mbi atë kryetarin e komunes, që njerëzve ua kishte sjellë shpirtin në majë të hundës.

Në mes të katundit, afër shkollës, ishte një ndërtesë e gjërë, e ulët dhe e vjetër. Në kthinën e saj të parë punonte berberi e shpesh herë mbrëmjeve mblidheshin atje burrat e fshatit e bisedonin për punën e arave, për gjënë e gjallë,

për zullumet e Frrokut dhe të xhandarëve. Jo veç një herë dëgjoja të flisnin atje edhe për një luftë të madhe në mes të Afrikës, ku fqinjët tanë të përtejdetit kishin shkuar si miq të paftuar. Në kthinën tjetër të asaj godinës së vjetër ndodhej një dyqan i vogël, ku dyqanxhiu punonte edhe si kasap.

Asaj mbrëmjeje gjyshi më tha:

— Para s'kam, biro, po merr një vezë atje, në furrikun e pulës së bardhë e shko te berberi, ja jep të të qethë flokët.

— Kungullesh, o babagysh?

— Më mirë kungullesh se ja, shpejt vjen Shkurti, e atëhere s'vihet gërshërë në leshra.

Ishte dimër, muaji i Janarit, fshati që mbushur me dëborë, por frynte Juga e bënte bunacë. Unë shkova ku më dërguan, por kishte aq shumë burra atje brenda, sa më erdhi turp. Ja lëshova berberit vezën në dorë e ngadalë shkova te stoli. Atje, para meje, e kishin zënë vendin e radhën nja gjashtë shokë e meqënëse s'kishte vend për mua, hypa dhe u ula në pezul të dritares. Berberi i kishte hedhur mësallën mbi gjoks baba Tases dhe po ja shkumboste mjekrën me sapun. Sapo zura vend fillova të ngre kryet ngadale e papritur dëgjova një — çif, çif, çif. Ishte Frroku kapardisur në një karrigë, sapo rruar e kruar. Burrat pinin duhan, mendoheshin e rrallë herë hidhnin nga një fjalë. E kuptova që aty ishte një gjendje e rëndë. Do të ishte hapur sërish çeshtja e rojtarit. Frroku dukej i zemëruar e fliste me inat. Kundrejt tij ishte Ndreko Zotua, burrë nja tridhjetë e sa vjeç, që kishte një zanat pak të

çuditshëm. Ky hapte e ndreqte puse poshtë e lart Devollit.

— Këtu do bahet si them unë, se unë jam kryetar!

— Po ne, që duhet të bëjmë si thua ti, çfarë jemi ne zoti kryetar?! — Ky që pyeste ishte Ndrekua, veshur me rroba të zeza shajaku dhe me arna mbi gjunjët. Mbi kokë mbante një farë republike të vjetër, rrinte pak i kërrusur, sipas zanatit që kishte.

— Ju? Ju jini shtetas të naltmadhnisë së tij dhe unë jam këtu në emën të naltmadhnisë së tij! Vullneti i mbretit asht vullneti im dhe vullneti im asht urdhën për ju!

Ndreko Zotos po ja digjte gishtat bishti i cigares. E flaku për tokë dhe foli:

— Në fund të fundit, rojtari nuk emërohet, porse zgjidhet.

— Bukuri. Por edhe zgjedhjen e baj unë; unë zgjedh cilin të due dhe kur të due.

Ndrekua u skuq në fytyrë dhe s'desh të unjej;

— Ti, zoti kryetar, me sa di unë, këtyre kohëve të fundit, ke dashur të rregullosh shumë gjëra duke zgjedhur...

Frrokut diç i dogji dhe këceu përpjetë:

— Pasha zotën po t'i fluturoj trutë në hava! Fol çka kërkon të thuesh me ato fjalë, se besa zotit...

— Po, po. Unë jam prej atyre që s'kanë frikë. Ti jo vetëm fshatit po i bie shumë më qafë, jo vetëm po na ha ditë e përditë pula, raki, meze e byrekë, por edhe një mësuese që po na mëson

fëmijët aty, në shkollë, edhe atë s'po e le rehat, or Frrok Çali...

Ai u hodh përpjetë, duke përplasur këmbët në dysheme. Burrat të gjithë deshën të hyjnë në mes, se mos ndodhte ndonjë vrasje, kur Frroku, që i qe avitur Ndrekos, e kapi këtë për jake të xhaketës. Ashtu e tërhoqi pas vetes, desh ta shkundte, por gjeti shok të matet. Ndrekua po i mbante grushtet mbledhur, por tashti shokët e kishin larguar dhe s'mund ta harrinte; me gjithë këtë Frroku ulërinte:

— Ti je një kryengritës, ti je një fanolist, edhe ju të gjithë jeni fanolistë, prandaj më ka çue njiktu naltmadhnia e tij... ty, mor këlysh, do të të çoj në burg, në burg, në burg... Zëri i tij sa vinte ngrihej, sikur i thërriste një njeriu që ikte duke rendur.

Gjer këtu dhe Ndrekua s'mundi të durojë. Por i ndezur atje në qosh uturonte, përmbi të ishin drutë. Ndrekua rrëmbeu një kopaçe, nga ato që tereshin sipër e, sa të hapësh e të mbyllësh sytë ja këputi... Frroku bëri të mbrohet duke u ulur, por u godit... hundët iu përsheshën dhe i plasi gjaku në tëmth. Unë këceva nga vendi e isha gati të brohoras, kur Frroku shkuli revolverin dhe sa të qëllonte, dy, tre burra e kapën nga krahët; ai do të tërhiqte këmbëzën, kur një dorë panxhë dhe e shpejtë e kapi në noçkë... Krisma e revolverit gjëmoi dhe plumbi shkoi e goditi në tavan. Ndrekua u zhduk. Njëpër çurkat e gjakut, që i vërviteshin poshtë kryetarit, njëpër thirrjet e burrave, njëpër përmbysjen e fronave,

Frroku se ç'bërtiste e kërcënohëj, duke kujtuar naltmadhërinë e tij, mbretin e shqiptarëve!

Në ato çaste, unë mendoja se Ndreko Zotua ua mbathi këmbëve. Por jo. Ai vetëm se kishte shkuar në kthinën tjetër e u kthye në çast. Hyri si xhind me satërin e kasapit ngritur lart... e ngriti edhe më... mori hov dhe e lëshoi...

T'ju them të drejtën, këtu u struka kuspull atje te dritarja e prej vetiu sytë m'u mbyllën. Një çast prita zhurmën e asaj qëllesës së rëndë, kur koka e Frokut do të çahëj dysh, ose do të fluturonte si lakër... Por s'doli ashtu. Kur çela sytë edhe Ndrekos ja kishin mbërthyer dorën.

Nëpër bërtitje, zhurmë, thirrje e sharje she- rri u platit, por Frroku ishte gjithë gjak në fytyrë, në sy, në atë jelekun e modës, në ata flokët e zes që ja lëpinte macja e bile edhe gjer te ai zinxhiri në të kthyerat e pantallonave. Kishte hyrë në atë çast edhe Hysen pojaku, që mallkonte e betohej se do të merrte hak. Frroku po qëndronte t'ja lidhnin kokën me shami, kurse Ndreko Zotua i thirri vrapit në çast tutje, kurbeteve dhe më s'u duk në fshat.

Unë renda te mësuesja. Nuk e gjeta në shtëpi, ishte te motra ime. Por ajo e kishte marrë vesh çka kishte ngjarë. Sapo më pa ajo hapi krahët. Iu vërsula sipër dhe e putha, e përqafova, e shtërngoya fort e më fort... jo më për ta mbrojtur, por i bëra këto nga ai gazi i papërmbajtur që kisha, për atë kokën e Frokut, që iu thye kocka, krenaria dhe hunda.

## SHTËRGJET

*Vëllait tim, Thanasit.*

**A**utobuzat e linjës shkisin nxituar mbi asfaltin e rrugës, kurse plepat e mëdhenj frushullonin e lëshonin poshtë fletët e mëdha e të verdha. Hendeqet anash udhës ishin mbushur me tinë, tokat e arave qenë baltë e llucë, ndërsa shiu s'kish të pushuar. Njëpër kolltuqet e autobusëve udhëtarët kërcenin një çast e kopsitnin palltot e veta. Ndjenin të ftohni në ndër këmbë dhe lëviznin gishtat brenda këpucëve. Shoferi shtypi butonin në mes të timonit, ra buria: kalonte përpara një karvan i tërë, kuaj, mushka, gomarë, pas tyre nja pesëmbëdhjetë druvarë. Këta ishin shumica të mbuluar me tallagane të vjetra, kurse njëri mbante një kapotë ushtarake pa spaleta. Ngarkesat e kafshëve ishin të mbështjella me mushama, por aty këtu dukej bishti i ndonjë tigani, barku i ndonjë bucele.

Te kaptejtë ishin shtërnguar fort me litar kokat e sopatave. Druvarët iknin të kërrusur, duke fshehur fytyrat prej shiut dhe me bisht të syrit vërenin rrotat e autobusëve, që spërkatnin



ujin gjer tutje. Shiu binte dërç<sup>(1)</sup>, e nër vithet e kafshëve, saraposhët kullonin çurka uji.

Palua i Kiço Brojës ikte nga fundi i karvanit dhe sado që i mbështjellë trup e fytyrë, njëhej që vetëm ai ishte djalë i ri, nga përkuljet e shkathta të shpinës e nga përshkundja e nxituar e kokës. Ujërat i pikonin në pulpë, mbi çorapet e leshta dhe afshi i nxehtë, që formohej atje nga ngushtica midis llastikut të çizmës e noçkës së këmbës, zu e mërziste gjithnjë më shumë. Askush nuk shalonte kafshën e vet, sepse druvarët që nisën për «në qymyr» e quajnë si «një nxehe» udhëtimin prej pesë ditësh përpara punës vërtet të rëndë, që do të kryejnë gjithë dimrit në majë të Kërrabës, në pyjet e Ishmit apo në malet e Rrëshenit.

\* \* \*

Vasili i Kiço Brojës, asaj mbrëmjeje ishte kthyer shpejt në shtëpi. Por posa vu këmbën në trem, psherëtiu dhe vari hundët. Kishte vënë re sopatën e të vëllait, Palos, bërë gati aty te shkalla. Kjo ja kishte prishur fare terezinë. Të gjitha sa kishin folur në mbledhje të kryesisë patën që në fjalë të kota. I ati dhe i vëllai ishin nga të parët që do ta shkelnin...

Hodhi shallin mbi parmakun e shkallës dhe hyri brënda. I ati që kërrusur te buxhaku e po

---

1) fort, me gjyme.

mprihte një latore me limë. Për të mënjauar fjalët e të birit, u shti sikur e kapi kolla dhe nisi t'u mëshojë mushkërive me sa fuqi që kishte. Mëmë Sofia, me shaminë e zezë në kokë, para ndjeu sherrin dhe thërriti nusen e Vasilit. Asaj ja lëshoi mtinë dhe u fut në sobë. Atje askush nuk fliste, porse balli i rrudhur i Kiços dhe buzët e shtërnguara të të birit, tregonin se furtuna do të pëlciste. Mëmë Sofia u unj në gjunjë para zjarrit, mënjanoi nja dy drurë dhe futi dorën nën kënd; mori një masë koçane e i hodhi mbi perustinë. Zjarri bubullonte duke kërcëllitur, flakët lëpinin konduret prej lisi, kurse Vasili, ulur te sëndyku hundë e buzë bashkë, frynte e shfrynte si i xhindosur. Lima e çelniktë shkiste përmbi tehun e hekurt, lëshonte atë zhurmën e metalit kur hahet, grimcat e përhimta vezullonin një çast nën dritën e flakëve e pastaj platiteshin përmbi gurin e vatrës. Muzgu po binte përjashta, e brenda, po krijoheshin hie mbi faqet e kthinave. Pa prituri dera u hap dhe u duk i vëllai i Vasilit, Palua. Ky u lëkund e u luhet në prak; po s'kish si ja bënte, dha vaktin e hyri. Askush nuk iu përgjegj. Që jashtë dëgjohej zhurma e tundësit... «E, po, domosdo, im atë s'niset pa i mbushur kuptoret me gjizë!» — Kaq blloi me vete Vasili dhe iu shkreh të vëllait:

— E, mo Palo, të hoqnë për hundësh?

Palua s'arriti të përgjigjet, sepse i ati kërcëu nga vatra (bishti i latorës e goditi në fyell të këmbës, por nuk e ndjeu), zgjati dorën të rrëmbejë mashën, por sa e kapi... ajo e përvëloi. E përplasi në vënd, ashtu u përngrit, i madh e hierëndë me

shallvaret prej shajaku të zi, me dorën sa një panxhë:

— Ti mos na çaj kokën! Në s'ta mban të nishesh, mos ngul turinjtë, more vesh!

Mëmë Sofia hyri në mes:

— Amani, mosni! Vasil t'u bëftë nëna, mos me të thirrura, të merremi vesh me të mirë.

Vasili kryqosi duart në mes të kthinës dhe vështrioi të atin mu në sy. I dridheshin gjunjët nga inati, por shtërngonte buzët. Kiçua s'kish të pushuar:

— Çfarë të merremi vesh moj, nuk e sheh kokën e këtij! Që kur e zgjodhnë sekretar, s'i flitet me gojë!

Në trem, nusja e Vasilit u drodh një copë herë me grushtat mbi faqe, kurse bishti i tundësit lëkundej dhe i trazonte gushën. E pështeti mtinë te shkalla dhe hyri brenda me një frymë. Kishte vendosur të shuajë sherrin me mënyrën e saj:

— Baba Kiço, kazani i rakisë po rrjedh si çezmë e s'mbahet, im atë nuk di se çfarë t'i bëjë...

Kiço Broja kafshoi buzën, u lëshua të mba-thë këpucët, kurse nusja, e shpejtë dhe tinzare, duke ja shkelur synë së vjehrës, u lëshua vrap te i ati t'i shpjegojë...

I vjehri doli duke sharë dhe mallëkuar, kurse të dy vëllezërit mbetën ballë për ballë me t'ëmën në mes. Vasili vinte më i shkurtër, por më i ngjeshur, kurse Palua, megjithëse më i vogël, kishte hedhur tepër bojë dhe i ulur mbi sendyk dukej më i gjatë se i vëllai, që rrinte në këmbë.

— Domethënë t'u mbush qypi, do nisesh.

— Po, do nisem. Ndonjë turp nuk bëj, për punë shkoj, para do sjell.

— Ashtu? S'qënka turp! E di ti ç'do me thënë të ikësh nga fronti?

— Këtu s'kemi ndonjë front, unë s'dëgjoj të kërcasë gjë.

— Ohu, po të ishte me të kërcitur ti do t'jau mbathje me ik të ikëm.

— Ç'thua, xhanëm!

— Sigurisht, ti po i bën bisht luftës me tokën! Ne po luftojmë këtu që të mos u lypim bukë të tjerëve, kurse ti, si ata sarafët që tregojnë, kërkon të mbushësh vetëm xhepin tënd.

— Posi, posi... na mbushe mëndjen! Këtu, or vëllaçko, puno sa të duash, po aq do të marrësh, kurse atje në Kërrabë, po i re sopatës më fort, fiton më shumë.

— Të paska fryrë paq baba Kiçua. Po a e di ti more, se ç'thotë Nasja? Agronom më i mirë se ai nuk gjëndet, ta them unë ty: «Bjeri tokës — thotë ai, — hapja damarët, plehroje, shkrifoje se ashtu lëshon sa të duash e ke çfarë të duash!» Dhe ne këtë do të bëjmë. E shoh që ti e ke vendosur. Prapa diellit të veç! Në fund të fundit, çdo luftë ka dezertorët e vet. Ti je një nga ata, nisul...

Vasilit iu kujtuan fjalët e një të huaji. Ai pat ardhur në fshat disa muaj më parë, ishte shkrimtar dhe fliste gegërisht. Pra, ai gega, pasi që çuditur një copë herë me këto katundet e Devollit të sipërm, pasi që çuditur me këto kitara, ballo e zakone të rinisë, krejt ndryshe nga disa katun-

de të veriut, kishte folur diçka mbi mërgimin dhe mërgimtarët. Ai thoshte se përveç nevojës, disa kurbetllinj iknin nga vëndlindja edhe për një farë aventure. Këto fjalë e kishin vënë në medime Vasilin. «Edhe vëllai niset në këtë farë kurbeti i shtytur edhe nga dëshira për». Por tashti Vasili s'mund t'ja përshtaste ato mendime bisedës së vet, duhej menduar akoma!

— E, po domosdo, — ja ktheu Palua, — je sekretar tani!

— Jam si jam unë, është punë për mua. Babait në fund të fundit edhe mund të mos ja vemë re, dyfek i plasur ai, kurse ti, djalë i ri, si s'ke turp xhanëm! Më vjen ndoht që të kam vëlla. Kam kaq ditë që të flas dhe ti drugën tënde. Ikë, ore, ikë, nisu me shtërgjet edhe ti...

Zjarri kërciti në vatër, po digjej një kërcu me zgërbonjë. Disa thëngjij u rrëkëllyen gjer në shkorsë; mëmë Sofia u kthye rrotull, provoi mashën, ajo ishte ftohur, e mori nër duar...

Vasili u mbush me frymë, çpërveshi buzët, e duke zbrazur gjoksin me një psherëtimë, doli përjashta. Edhe mëmë Sofisë sikur iu varën supet më poshtë, kurse Palua te peskuni (1) me duar e këmbë njëra mbi tjetrën, vështronte përdhe. Pa pritur një fjollë tymi po çohet prapa mëmës. Palua përpëliti sytë. Një thëngjill kishte mbetur diku te shkorsa. Ishte, digjte, thellonte dhe nxirrte tym. Kur u afrua Palua thëngjilli kishte çelur një brimë nën cergën, po digjte thekërishten, por flakë s'kishte dhënë akoma. Djali s'deshi të trembë t'ëmën, prandaj e mbuloi thë-

---

1) Fron i madh

ngjillin me shputën e këpucës gjersa, nga mun-  
gesa e ajrit, kokrra e prushtë u shua.

Kishte rënë nata, kur Palua doli në rrugën e  
madhe të fshatit. Nxori thikën nga xhepi dhe  
filloi të tundë zinxhirin e saj. E dridhte e çpër-  
dridhte mbi tregonjësën, zu vërshëllente ngada-  
lë. Ishte terr i plotë. S'dukej sikur të ta fusnin  
gishtin në sy. Dhe vesonte një shi i hollë. Dëgjo-  
hej një zhurmë e fortë ujërash; ato teptisnin nga  
kadet e hidrocentralit të katundit dhe prandaj,  
llambat elektrike vendosur rrallë e rrallë nëpër  
udhët e fshatit, ndrisnin më shumë. Dhe nën dri-  
tën e secilës llambë, Palua vinte re shiun, që  
rridhte me ato mijëra e mijëra tela të hollë, që  
hepoëshin kur i trazonte era. Te Çezma e ma-  
dhe, nën hajatin e saj mbuluar me llamarinë, një  
grup djemsh po këndonin. Kishin edhe një kita-  
rë. «Paskan vënë tel mi prej telefoni», mendoj  
ai për shokët e vet. Ai dëgjoi me qejf refrenin e  
këngës, që vetë e kishin kompozuar duke koba-  
shitur poshtë e lart mallin e botës:

«Kjo dashuria jote, mua më ka hyrë në  
zemër...»

Palua bëri mënjanë, nuk u foli fare shokëve  
dhe vijoi më tutje, gjersa iu desh të qëndrojë di-  
ku e të vërshëllejë në një mënyrë tjetër e hollë-  
hollë. Shkelte tashti jo në kalldrëm, por në tokë  
të njomur, çapet i fundosnin dhe i kish këmbët të  
lagura. Një vajzë doli nga një deriçkë dhe ata u  
takuan në errësirën, që bëhej edhe më e zezë.  
Ishin te dardha e madhe, që akoma s'desh të lë-  
shojë fletët. U futën nën strehët e shtëpisë. Pas  
murit, mbi dy kunjat ngulur në të, ishte vendo-

sur një parmëndë dhe një zgjedhë. Shpina e vajzës u ngjesh fort pas plorit të hekurt, kështu bënë më tutje.

Pasi kaloi ndonjë orë, ajo psherëtiu. Palua qëndronte ngjeshur pas saj dhe ja mbante fytyrën mbështjellë në duart e tia.

— Mos ikë, mos, — i pëshpëriste ajo dhe duart e veta të mbledhura në grusht i rëndonte mbi gjoksin e djalit, — mos ikë, përse të ikësh? Edhe këtu duke punuar nxjerr, pastaj punoj edhe unë, pse bëhe tamaqar? Dëgjomë mua...

Uturoi që larg era. Në fillim kapi majat e drurëve, pastaj u ul më poshtë, rrahu me tërsëllëm muret e shtëpive, fishkëlloi nëpër hatullat, u pështuall pas trungjeve; u rrëzuan disa tjegulla, kërcitën, një maçok mjaulliti fort. Vajza fërgëlloi dhe me dorën e djathtë uli fustanin, që ja ngiste era. E sa mbaroi valanga e parë, një rrapëllimë më e fortë ja dha sulmit tatëpjetë. Frynte një verë i rreptë. Një degë plepi rënkoj dhe u thye si një presh kreko, frushulloi duke rënkuar dhe erdhi të përplasat te dardha e madhe. Përmbi çiftin u derdhën një mori kleçkash, bisqe dhe fletë.

— Mos ikë, he, dëgjomë mua, Palo, mos të keqen, Palo!

Ai mërmëroi:

— Kam dhënë fjalën, — dhe psherëtiu. U dëgjua kënga e shokëve. Ata ishin afruar edhe sepse e dinin që Palua ishte diku atje afër. Dhe doemos, për inat të atij ata këndonin:

«Burrë do ikësh, mua ku do më lesh...»

Tashti duhej të ndaheshin. Afronte agimi

dhe nuk i vinte mirë të nisej ditën nga fshati. E mori vajzën në krahë dhe e ngjeshi pas gjoksit të vet, sikur desh ta shtrydhë. Ajo duroi, duroi shumë dhe nuk kuptoi dot nëse lotët i shkuan nga ndarja, apo nga ai shtërngim aq i fortë. Një fletë plepi u shkau nëpër fytyrë, pastaj dy fletë, tri. Era grindej akoma dhe tundte muret e shtëpive. Ai e lëshoi vajzën, duke psherëtitur aq fort sa u gëlltit. Ashtu u ndanë.

Mezi i hidhte çapet në errësirë, mezi çapitej nëpër atë truall kopshti gjithë baltë. Doli në rrugë. Shiu binte gjithnjë i hollë dhe i dendur, shi vjeshte që të lag fort e dot s'e kupton.

Por të gjitha këto ngjanë të djeshmen. Tash-ti, Palo Broja shkjeponte në fund të karvanit, vetë këtu e mëndjen larg, prapa, në Devoll, te dar-dha e madhe, që s'donte të lëshojë fletët.

Në mbrëmjeherë qëndruan anës liqenit, nën xhade. Kafshët i lidhën nëpër gëmusha që të përtypnin fletë, ndezën zjarre që të ngrohen e të tëren, nxorën bukën ta përzhitin. Shkëmbenin ndonjë fjalë. Te zjarri që ndezi Kiço Broja, përveç të birit ishin edhe Vani Tinka e Ilo Tajua. Përbënin një katërsh që gjithë dimrit në Kerrabë do të banonin në një konak. Shokët e karvanit u shpërndanë edhe ata anash liqenit, nëpër zjarre të tjerë. Ishin të lodhur, të rrahur nga era, të lagur nga shiu. I mori gjumi më të parë. Burrat ngriheshin herë pas here, të zgjuar nga zhurma e motorave në xhade, hidhnin hunjë në zjarr e trazonin urët. Palo Broja u zgjua vetëm afër agimit. E nuk kuptoi dot nëse u zgjua ngaqë u ngop me gjumë, nëse u zgjua nga shqetësimi që kishte përbrënda,



apo nga dallgët e liqenit, që tani zhurmonin më fort. I ati flinte përmbys me duar hapur e sikur desh t'i ngulë në tokë, njërën këmbë shtritur e tjetrën thyer në gju, sikur gatitej të zvarisej apo të hypte mbi ndonjë mur. Zjarri i madh kishte zënë një kore hiri të bardhë. Dukej sikur qe fikur krejt. Ilua u zgjua, gulçoi dhe u kthye këtej, duke kruar me thonj gjoksin leshtor e të thinjur, gogësiu e mërmëroi diçka që s'u kuptua.

— E, mo kapedan — i foli Palos, — si ndjehesh?

— Mirë, xha Ilo.

— Domethënë i hodhe prapa brought e djalërisë! Kur isha si ti, shkonim një herë për kurbet në Athos, eh si isha unë atëhere, pikë e vrer, hë?

Kiço Broja kërceu menjëherë në fjalë:

— Ama ç'na çan kokën edhe ti Ilo, unë kam hallin e kalit, që e mora pas të patredhur, ti...

Sytë e Ilos xixëlluan, e gjithë fytyra e tij qeshi, desh të bënte një krahasim midis kalit dhe djalit... por s'ja mbajti. E megjithqë nuk e tha me gojë, Kiçua e kuptoi dhe iu shkreh përsëri: — Ama ç'na çan kokën... të lutem shumë, djalën mos ma ngacmo në do që t'i kemi punët mirë, jo përndryshe... s'kam djalë prej atyre që mendon ti, more vesh?

Liqeni ushtoi fort, u dëgjuan klithmat e zogjve të zinj të gjolit, një perçe uji fluturoi lart, i spërkati druvarët, doemos edhe vatrën midis tyre. U ngrit lart një avull i nxehtë, u dëgjuan thëngjij, që pëlcisnin. Zjarri i platitur ruante përbrenda shpuzë e thëngjij të ndezur. Më në fund ata u nisën përsëri. Por sa vunë rrugën ndër

këmbë, ja nisi shiu. Shi dhe erë e ftohët dhe lare pa pritur shiu filloi të trashet, pastaj nisi të zbardhet, u kthye në dëborë. Pllaskat u dëndësuan, vinin të bardha e të lagështa, që larg nga malet e Mokrës.

— Hajde, se s'është gjë — i fliste Kiçua të birit.

— Pse flet kështu, baba? Unë s'ankohe!

— Jo, po që të kam fjalën, se këto ruan ai prapa e nis e na çan kokën. Sot pasdite kapërxejmë qafën e Thanës, andej është ngrohët, pa le pastaj në Kerrabë, andej është behar fare... mbliidhen portokallet, ullinjte...

Por, «ai prapa» i dëgjoi këto dhe s'e la rastin t'i shkojë kot:

— Si fjala e Papa Llazarit, o usta Kiço: pas skëtërrës vjen parajsa!

Kiçua s'deshi ta zgjatë dhe e hodhi fjalën gjetkë:

— Sonte gjithë natën kanë shkuar përmbi ne tufa me pata. Po shkëmbehemi me patat, ne shkojmë ato vijnë.

Por Ilo Tajua përsëri drugën e vet:

— Ashtu vërtet, ne ikim me shtërgjet, usta Kiço, dhe shtërgjet marrin pas edhe një dallëndysh...

— Ama, ç'na çan kokën edhe ti! Më duket se po e bën si ajo dhelpra bishtprerë, s'të erdhi yt bir e kërkon...

\* \* \*

Pas gjashtë ditësh, ata ngritën konakun midis dy kodrinave në një shpat të malit të Kërra-

bës. Druvarët e tjerë u shpërndanë poshtë e lart, kurse Palua ishte me të atin, me Ilo Tajon e Vani Tinkën. Filluan nga puna e zakonshme dhe e rëndë. Prerje drush, mbartje në shpinë nëpër rrëzime, zjarre nëpër kamina. Pas tetë ditësh, të katër ishin të zinj si lugetër. U zbardhnin veç dhëmbët dhe sytë. Palua shihte për ditë ato fytyra si të llyera me blozë dhe herë pas here shkonte te burimi poshtë dhe lahej. Por më vonë e pa që ishte punë e kotë dhe, dashur pa dashur u mësua me zhulin e zi në fytyrë e në duar. Në rrugën e gjërë të Kërrabës shkonin e vinin me qindra automobila nga më të ndryshmit. Një ditë, Palua pasi lau fytyrën qëndroi në një ledh e i vështronte. Dikush ngriti dorën brënda një autobusi dhe e përshëndeti. Nuk e njohu dot cili ishte, ai dalloi vetëm një dorë ushtari. Cili ishte ai që shkonte me lejë në fshat?

U gdhi një ditë e kthjellët dhjetori. Kishin dy muaj që punonin atje. Baba Këçua e shpoi të birin në ije, djali u zgjua, psherëtiu, u shtriq dhe pastaj u ngrit. Mori torbën prej lëkure dhie e mbushi përgjysmë me elb dhe shkoi të gjejë dorin. Nuk u lodh, se tashmë kafsha qe mësuar, priste afër konakut. Doriu ngriti veshët puliq dhe rendi drejt të zotit. Palua ja shkoi lidhësen në kokë, ja përkëdheli perçen, zverkun, shpatullën e kuqe e të lëmuar. Kali shfrynte me kokë brënda në trajsë, kurse gomari mashkull i Ilos po gërzinte gjëmba më tutje.

Vani Tinka doli te dera e konakut, duke go-gësirë:

— Ah... po, që të kam fjalën, gomari është

gomar! Kali po ha tagjinë, veshëgjati kënaqet te gjëmbat.

— Kur ishim në Athos — ja ktheu Ilo Tajuja, — mendoja se gomari është budalla, por nuk është ashtu.

Ata nisën të hahen me fjalë, por s'mundën të vazhdojnë sherrin, sepse doriu i hazdisur, sapo Palua i qiti torbën, ja mbathi vrapit tatëpjetë.

— Na, dori, na!

Kafsha u tërbua më keq, zu turfullonte, zu kërcente kas, ja dha hingëllimës me të madhe, ndërta u frynte me duf flegrave të hundës. Vani Tinka, i doli përpara, në anën tjetër u hodh Ilua, pastaj Kiçua. Punë e kotë. Kali ja thirri vrapit tatëpjetë Kërrabës. Palua u lëshua pas tij. Aty këtu kafsha shkelte kapistrën me këmbën e vet, ashtu pengohej, përgjunjej, gati përplasej në hundëzaj...

— A thefsh kokën, o i paudhë, kam faj unë që të ve tagji!

Palos i vinte të pëlcasë, kur kafsha aty për aty mënjanoi të keqen e kapistallit. E ndërroi mënyrën e rendjes. Për t'i shpëtuar pengimit dhe për të hetuar të zotin që e ndiqte, i ngrinte hundët tepër lart, si një gjerafë, e njëherit e mban-te kryet anash. Ashtu, syri i madh e gështenjë (sy kali) vështronte çdo lëvizje të ndjekësit. Me një mënyrë të tillë kali vinte në dukje jo vetëm trupin e tij të zhdërvjellët, por dukej edhe më i bukur, më mospërfillës, më krenar. Kjo e tërbonte Palon, që rendte me sa mundte për të mos e humbur nga sytë.

«Hë, o i mallëkuar, në mos të shtënça në dorë! Ai xhambazi që na e shiti do ta ketë blerë në kryeqytet, me siguri që në Tiranë do më shpjerë ky i mallëkuar. Po ç'djall ka që nuhat për tokë si zagar! A, në të shtënça në dorë!

Pa pritur, në një qarrishtë afër Ibës, u dukën dy fshatarë me qeleshe në kokë.

— O shokë, priteni! O burra!

Ata rendën me duart përpjetë, njëri rrëmbeu një hu dhe bërtiti:

— Ej toskë! Dil nga e majta ti, dil nga e majta!

Te përroi u dukën edhe tre fshatarë të tjerë me qeleshe në kokë. Ishin me shata ndër duar e rendën këtej, ja prenë udhën doriut, e trembën, i bërtitën. Por kali ishte i papërmbajtur. Me një guxim për ta patur zili, e përkuli zverkun një çast dhe u derdh në mes të njerëzve, si i xhindosur. U vërvit tatëpjetë duke hingëllitur me të madhe. Ishte tashti fitimtar mbi toskë e gegë dhe gati fluturonte. Palua qëndroi. Nga vrapin dhe lodhja i dridhej kupa e gjurit të djathtë.

— Më falni, o shokë, më ndjeni se ju shqetësova.

— S'ka gja — ja kthyen ata.

— Po shih një ktu — shtoi një plakosh, — në Orman të Arbanës e mban vrapin ky biçim kali!

— Në Arbanë? «Është më të ky plakosh»? E pse në Arbanë? Jo, jo, në Tiranë do ta mbajë vrapin.

Palua u lëshua përsëri tatëpjetë, pyet këtu, pyet atje, diku shihte gjurmën e doriut, diku e shihte nga larg dhe pas kaq orësh vrapin, në një

mriz fshati afër një togu me shtëpi, ai pa një kopë kuajsh. Tre çuna koloviteshin në një degë lisi të çapluar. Me të parë të huajin ata iu afruan.

— A erdhi këtu një kalë dori?

— Qe, mre, qe... i joti asht?

Doriu turfullonte nëpër kopenë me kuaj e mëza; e ndjeu frikën nga prania e të zot, por s'kishte ndër mend të ikë më tutje. Palua e kapi dhe e shaloi.

— Oj toskë, po lene kalin mre, lene se e kullostim na...

Me të perënduar të diellit Pali me 'doriun u gjendën te konaku. Kafsha ishte e mbytur në djersë, i shquheshin njolla të murme në bark nga qëllesat që pat ngrënë prej djalit, kur ky e ngjiste me vrap përpjetës së Ibës. Djali e lidhi fort kalin me kapistër, pas një kumarike, kurse i ati duke sharë e mallëkuar e kashaiste. Ilo Tajua e Vani Tinka hidhnin romuze e tallethin. Qenë shtruar mbi ledh dhe pinin duhan.

— Kur ishim në Athos, — filloi Ilua, — kësh-tu na e ka bërë një taj, por e zumë shpejt, se sa i shpejtë është kali, aq edhe budalla...

— Që të kam fjalën, nuk është ashtu, dhe ta dish, na plase me këtë «kur isha në Athos».

Ata rifilluan sherrin, që kishin lënë përgjysmë atij mëngjesi. Nisën të përfliten. Palua ishte shtritur afër konakut dhe s'ua kishte qejfin se ishte i lodhur... Ilua desh të provojë thëniet e tij, u ngrit dhe hoqi këtej gomarin e vet mashkull, e la te sheshi dhe vajti të marrë samarin në konak.

— Ja, shikoni, — Palua u ngrit përgjysmë.

Ilua ngriti samarin mbi kafshën e vet, kur menjëherë gomari u mbush thellë me frymë dhe e bëri barkun si daulle. Ilua e qëlloi me gju në bark, që kafsha ta shfryjë, e qëlloi përsëri, bërtiti, e kanosi. Më kot. Gomari e mbante barkun gjithë njëlloj. Ilua ja lidhi oputën e qenglës te tre këndëshi i hekurt në samar dhe bëri disa çape më tutje. Atëhere gomari e shfryjti barkun dhe uli kryet.

— E shikoni? — bërtiti Ilua, — e shihni të paudhin mëndjendritur? Tashti mund të ecë dhe barkun ta ketë çlirët...

Prova ishte e pakundërshtuarshme. Ilua po afrohej te shokët, duke tundur kryet e duke vështruar nga Palua: — Kështu është or shokë, kështu, por mua më ha malli gjetkë, ja, fjala vjen, përse nga një herë njeriu bëhet më gomar se gomari. Kur ishim në Athos...

— A, ç'na çan kokën, — u hodh Kiçua, — e ç'kërkon të thuash me këtë?

— Vërtet ama, mirë të thotë. Që të kam fjalën, unë them përsëri se edhe kali është i zgjuar, po pse, do të thuash ti. Po ja, ore, gomarët tanë qëndrojnë këtu, se i kemi dy, të na rrojnë, dhe kanë nga një shok, kurse kali është i vetëm... është i vetëm dhe krisi iku.

Ilua ja dha të qeshurës.

— Aman, më qafsh, o Vani, më qafsh ore, se ma solle lepurin mu në dyfek. Ashtu është, gomari rri me gomarët, kali me kuajtë, kurse ky çapkëni ynë rri këtu majë Kërrabës me ne shtërgjet... ha ha ha...

Këtë herë Kiço Broja nuk desh të unej dhe iu vërsul Ilos:

— A, po ç'na çan kokën shumë ti? Çfarë kërkon të nxjerrësh mo kokë paçe? Kërkon shokë apo kërkon të rrëmbej hurin e të të hyj dorë... oj ky, si ay që këput majën e plepit për të ngarë gomarë. Ama të kam duruar shumë. Nëqoftëse do sherr, më thuaj se ta ndreq unë ty.

Palua tashti vetëm dëgjonte thirrjet, që lëshonte Vani, për të ndarë të atin nga Ilua, sepse ndjehej i mërzitur dhe që futur nën plafin e vet.

\* \* \*

Kaluan ditë të tjera, erdhën letra nga fshati. Afër mbrëmjes ata u mblodhën te konaku dhe medoemos hapën zarfat. Palua kishte tri letra, dhe për këtë Ilo Tajua e shpoi Vanin në ije, po pa guxuar të ngrerë zërin. I druhej një zënke tjetër me Kiçon. Djali lëshoi përdhe njerën letër dhe i ati nisi ta lexojë. Ishte nga Vasili për të vëllanë. Ai i shkruante: «Katandise në një ari-xhi, që bredh poshtë e lart me çadëren pas. U bëre shpirt rob, saraf i parasë, s'bëhe merak për ekonominë e gjithë fshatit, po vetëm për qesenë tënde, për botën tënde të vogël...»

Kiço Broja pështyu me inat dhe mërmëroi: — Tamam, artikull për në gazetë...

Palua nuk e dëgjoi fare, as që e kishte mëndjen. Lexonte letrën e asaj. Këtu kishte më pak qortime, por plagët që lëndonte letra e vajzës atij i dhimbnin më shumë. «Fjalë të tilla të urta, të qeta, pa sharje, pa qortime, sikur të therin me pambuk.» S'e bëri të gjatë, u fut nën plafin e vet dhe mbuloi kryet. Era fishkëllonte në-



për gardhin e konakut, kurse zjarri kërciste aty në mes. Kotej, por e dinte se gjumi nuk kishte për ta zënë, fërkonte fytyrën dhe mendimet i iknin në fshat. «Për vitin e ri kishim një festë të tërë, vallëzuar gjer në mëngjes, sa mirë sikur të ishte edhe ti. Yt vëlla, Vasili erdhi më mori tri herë për të vallëzuar, unë e pyeta për ty, por ai s'ka marrë fare letër prej teje. Nuk bën mirë që sillesh kështu me vëllanë, shkruaji. Kemi dimër por tashti nuk bie më dëborë. Punojmë nga Kopaçi; ne vajzat qërojmë dëborën përsipër, djemtë thellojnë qilizmë. Pastaj kolovitemi me saje...» Palua psherëtiu nën plafin e vet, pastaj kuptoi që nuk bëri mirë që e lëshoi atë psherëtimë, sepse Ilua u kollit me djallëzi. Përsëri përfytyrimi i tij shkoi në fshat: «Gryka e Kopaçit gumëzhin nga thirrjet dhe britmat. Duken veç pemët dhe lisat e zinj nëpër fushën e bardhë mbuluar me dëborë. Bunacë dhe erë e jugut. Njerëzit punojnë. Një zhurmë e njohur afrohet nga fshati. Janë fëmijët. Mbaruan orët e shkollës dhe me saje e korita rendin këtej. Është koha kur punëtorët kthehen në fshat. Por të rinjtë jo. As vajzat. Disa çunakë nisin e qajnë, sepse djemtë u marrin sajat e koritat me premtimin se do t'ua kthejnë përsëri.

— Mos qaj, eja se të marr përpara. — Po mua? ndërhyt një vajzë me flokët e shprishura në fytyrë dhe me sytë plot xixa. — Ti?... zvarosu pas meje. — S'jam mësuar të zvarosem. — Atëhere kapu pas supeve të mi, ose ulu ti në saje dhe kapem unë pas supave të tu... — Ç'thua xhanëm, qënke i zgjuar! — Zhurmë, thirrje, të qeshura të forta, gërvima të sajeve, që shkasin

mbi masën e bardhë dhe mbi akuj, rrëshqitje me vërtik nëpër tatëpjetën e gjatë, gjer te shëlgjet e përmbysur. Pilua kërkon të sajojë një shuk, përkulet, dëbora është e shkrifët, si një farë sheqeri i trashë, bën të qëllojë vajzat; ato përkulen, qeshin, bërtasin, i kanosen: — Mos Pilo, mos se to të them një fjalë! I patremburi Pilo, si i zënë në faj, lëshon krahët poshtë.» Po mua a më kujton njeri kur shkojnë andej nga Kopaçi? Mbase pyesin Vasilin. Po a vërtet më quajnë një të ikur nga fronti? Këtë fjalë ma tha im vëlla dhe kur ma thotë ai, ç'pret nga të tjerët, pastaj. «I ikur nga fronti!» Hej, djall o punë. Fjalë e helmuar, e rëndë plumb, s'e duroj dot. Po përse u bëra shkak që të ma hedhin fytyrës? U dashka që të shijosh një helm që të dish sa i hidhur është? Por ata kanë të drejtë? Për ca para u bëra shok me shtërgjet... Ku shkojnë shokët e mi e ku shkoj unë... Ata janë ngritur dhe punojnë për të mirën e të gjithëve, kurse unë mendova t'i bëj bisht detyrës, mendova vetëm për veten time. Dashur, pa dashur unë mbeta pa shokë, shokët e mi janë shtërgjet... Po sikur të kthehem në fshat? A do të më pranojnë shokët? A do më quajnë «i ikur nga fronti»? Sidoqoftë këtë s'mund të ma thonë sapo të vete, po në qoftë se, kushedi, ndonjëherë kur të përfli-tem me njeri... mbase do ma kenë në majë të gjuhës: ikë ore ti... ti... i ikuri nga fronti, ti shoku i shtërgjeve...»

U gëlltit që të ndalojë një psherëtimë dhe u kthye nga ana tjetër. Në sytë e mëndjes i doli Rina. Ashtu dalloj trupin e saj, duart, supat me atë formën e bukur atje ku fillojnë krahët, bile ai i

pa edhe nallanet në këmbët e zbathura, fustanin e gjelbër me pikëlat e bardha...

Palua lëshoi tutje imagjinatën e vet, sa fytyra i mori zjarr, në një çast kafshoi me dhëmbë gishtin tregonjës, përpoqi këmbët sikur dikë shkëlmonte dhe, duke zbrazur frymën me duf, u ngrit.

Ishte mesnatë kur, i brengosur, i lodhur nga mendimet që i gërryenin trurin, u vodh nga kornaku dhe me sopatë në dorë bëri tatëpjetë. Doli te një vis, përmbi xhadenë e gjërë. Ishte natë e thellë. Motorët e kamionave të rëndë grindeshin dhe gjëmonin grykave të Kërrabës. Dritat e tyre lanin pllajtat, përrenjtë, majat, ngriheshin me gulshe të gjërë drejt qiellit e përsëri binin poshtë. Ai rrinte gërmuq, me gjunjët qarkuar nga krahet. Shihte targat e makinave: Tr. Ko. Tr. El. Ko. Tr. Ko. Ja një skodë që ka rimorkuar një të dytë. Makina e dytë e mban të parën ndën vurratën e bardhë të dritës së vet. Duket ngarkesa në karrroceri: haliçë për asfaltim. Cikërimë plehrash bien nga spondet e makinës së parë, sikur i lëshon poshtë një shoshë e padukur.

«Tashti ose kurrë. Po vallë si do më presë im vëlla? Me të tallur? Ndofta s'mund ta bëjë veten, po një thumb do të ma hedhë. Po le ta hedhë, në fund të fundit ai është më i madh, pastaj e kam vëlla. Po babai ç'do mendojë? Se iu tremba punës? Sidoqoftë, ai e di se për çështje pune mua s'ma ka ngrënë kurrë qeni shkopin. Do përflitet me Ilo Tajon. Ky do t'ja nisë me një «Kur ishim në Athos», Vani do t'ja kthejë me një «Që ta kam fjalën», babai do t'u vërtitet me një «A ç'më çani kokën», kurse unë... kurse unë nesër mbrëma në

këtë orë do të jem në fshat, midis shokëve, në shtëpinë time, në frontin tim».

Palua u ngrit, e kapi sopatën me të dy duart dhe, si ta kishte ushtë, e flaku tutje drejt konakut. «Ta kam falur, o baba, shtërg nuk jam, prej punës frikë s'kam, por...më mirë me kazmë në fshat e me shokët, se sa majë Kërrabës, si ari-xhi.»

— O Palooo, — dëgjohej thirrja e mekur e Kiço Brojës, që nga lesa e konakut.

Valët e ajrit dridheshin nga zhurma e motorëve, brigjet oshëtinin sikur kalonin aeroplanët, kurse zëri i baba Kiços sa vinte bëhej më i dobët. Mezi dëgjohej.

## PARA BURIMIT, KUNDREJT FSHATIT

**A**i ndjeu zhurmë përpara dhe u fsheh pra-pa ferrës, u kërrus menjëherë dhe gati u bë njësh me tokën. Diçka e gërvishti në llërë. Priti. Dikush çapitej aty, çaplente bisqe, thyente degë, këpuste fletë, fërkohej pas koçkorëve. Njeriu nguli sytë nëpër labirintet e rrënjëve, që vareshin te rrëzimi. U duk një këmbëzë e vogël, një thundër e çarë, pastaj një e dytë: një capok ngjyrë hiri, me mjekërzë të hollë përçapej me ngut. Por i fshehuri nër drizat ishte i mëndjes që as capoku të mos e shihte.

I panjohuri nuk ngiste rrugën e gjërë si kush-do tjetër. Po i qasej vëndlindjes, duke kaluar pyjeve si kaçak. Lart në mal kish parë barinjte, pastaj loparët, më poshtë rojtësin, kishte shkuar afër stanit, por kudo ai ishte mënjanuar, kudo ishte fshehur, kishte ndërruar udhë. Ai nuk po kthehej në fshat që të hynte aty.

«Jo, jo, qoftë larg ajo punë. Një njeri të vetmuar do ta gjej diku, një grua ose një plak. Dashur pa dashur atij apo asaj do t'i çfaqem, do

t'i lutem të më nxjerrë një certifikatë të lindjes në gjëndjen civile. E përse të mos më ndihin. Përkaq gjë! Në fund të fundit... Po sidoqoftë në fshat nuk do të hyj, në shtëpi më s'do kthehem. E te kush? Të më rronte nëna, disi do t'ja bëja, sa ta përshëndesja. Ajo qenë grua, sa më shkanë këmbët, mori çupën dhe krisi në derë të vet. C't'i bësh?»

Çote Larja u çua. Llëra i dogji, e vështroi, i rridhte gjak. E pllakosi me duhan. Capoku ishte kacavirur pas lajthishtes me dy këmbët e para mbështetur në trungun me qukëza të bardha. Kafsha ktheu sytë nga Çotja, përçapjen s'e ndaloi, ndihej gërzitja e fletëve në gojë të kafshës, lëngu i gjelbër i rridhte nga goja e të kujton-te pranverën. Capoku hetoi të panjohurin. Çotja ishte gati ta ulte kokën për tokë, capoku teshtiu si me garaz, kërceu me këmbët e para për tokë e u largua. I riardhuri psherëtiu dhe shkoi dorën në ballë. U ngjit edhe më pas luginës, kaloi tumbën e aheve, nëpër Përruan e Madh sërish e çori llërën pas kullumbrive. Doli te koria afër Çukës. Këtu, fshati iu ndeh përpara... nën sy kishte vendlindjen. Tre vjet që e kishte ëndërruar: shtëpitë e ngjeshura njera pas tjetrës, tumbat e kumbullave rreth tyre, lëminjtë ku tashti po shinin, grurin, çunat që ndiqnin kuajt, gjelbërimin e thellë të kopshteve, kërcenjët e kungujve varur nëpër gjerdhe dhe... njerëzit. Malli për njerëzit iu ndez i papërmbajtur. Mërmëroi: Veç ai që ka vojtur, veç ai e njeh këtë përmallim!

Shëtiti vështtrimin nëpër fushë: «Në mes të arave një lëmë tepër i madh, stiva e grumbuj me kashtë e duaj, stiva me thasë, kombajna nxjerr

tym mavi, që davaritet bashkë me bykun. Njerëzit nxitojnë, punojnë, rendin si dikur».

Çote Larja kthehej nga burgu. Tri ditë u bënë sot që kurse e liruan. Dhe tre vjet kishin kaluar nga dita kur e kapën duke vjedhur në depon e kooperativës. Kur e kapën me presh në duar, ai ishte shtangur, kishte filluar t'i vështrojë rojet me njëfarë buzëqeshje prej budallai. Kur erdhi polici e mori, Çotja qe bërë si i shastisur, hidhte sytë kudo, por jo mbi sy të tjerë, kishte shtrirë duart, polici ja kishte lidhur kryqazi me zinxhir, pastaj e kishte kapur zinxhirin me një «Titius» të verdhë e marsh për në komandën e policisë. Procedime, hetime, pyetje, qortime, «na turpërove, na nxive faqen», gjyqi, burgu, gjyqtari, prokurori (ky kishte folur shumë ashpër) avokati, fjalë, fjalë, të pyetura, të vërtitura poshtë e lart. Vendimi: Gjashtë vjet privim lirie me punë të detyruar! Kishte punuar në një minierë. Pas tre vjetësh e kishin liruar. Drejtori i burgut i pat thënë: — Kur arrihet dardha, bie. Edhe ti Çote Larja, hap sytë, me këto duar, me këtë vullnet, me këtë zëmër të mirë që ke... Dhe kishte tundur dorën në shënjë qortimi: — Hap sytë!

Çotja psherëtiu dhe ndjeu nevojën të fërkojë faqet me pëllëmbë. Nër arat e grurit njerëzit vërtiteshin, të shumtë dhe të nxituar. Nga parcelat me misër rrallë tek dukej njeri duke vaditur. U nis për nga misëroret. Te qershia vishnjë ishte lidhur pas kapistre një gomar, qe munduar të zhgrryhej dhe samari i kish prjerë. Çotja vështroi qark dhe ja ngriti samarin kafshës. Prapa ferra-

ve një njeri po zbathte çorapët. Çotja e njohu me të parë. Plaku po gatitej të vadisë misëroren përpara. Çotja fërkoj fytnin, uli kokën dhe iu drejtua:

— Mirëdita, xha Mano!

Plaku e vështroi që përmbi rrathët e gjyzlykëve prej teli.

— Oj, ti qënke? Ku je, o Çote?

E përqafoi, e puthi, i rrahu supin, e qortoi veç me gishtin tregonjës, që e tundi si sovajkë.

— Hajde bir, si dole asaj shkollë?

Të ishte këtu e ca vjet më parë, kësaj shakaje Çotja do t'i qe vërsulur me një «si të të pëlcastin», por tashti ai vinte nga burgu, u druhej njerëzve, shesheve, arave, staneve, barinjve, bile edhe capokëve.

— Mirë, mirë...

Bënë toka, plaku buzagaz tundte kokën, duke përpjekur gjuhën pas qiellzës, kurse Çote Larja shihte diku në opingat e Manos.

— Dhe me shëndet qënke bukuri, pa shiko? Dikur hapsanikët ktheheshin në fshat të verdhë, si prej lëngjyeri, ti... ti si bakër e ke fytyrën.

Por Çotja nxitohej. Bisedës i ra shkurt:

— E di si e kam punën, xha Mano?

— Të më thuash, pa ta di.

— Unë s'kam ardhur për t'u kthyer në shtëpi.

Plaku hapi duart dhe mblodhi buzët.

— Po më duhet një çertifikatë e lindjes, ti do ma bësh këtë nder. Ja, pullën e kam sjellë, të lutem të shkosh gjer në lokalitet. Sa të kthehesh ti, unë do vadit arën. Veç të më betohesh: askujt të mos i tregosh që ndodhem këtu.

Plaku ndejti sërish në ledh e hodhi sytë në



vijë. Ujët edhe s'po vinte. Toka e hendekut qe e ndriçme, kuq e verdhë. Plaku e qëllonte lehtë me majën e shatit e dheu i butë pritej thela-thela, si hallvë e shkrifur.

— Domethënë ti kërkon të shpërngulesh për gjithnjë?

— Do ik, s'kam si ja bëj. Do punoj në një minierë, andej nga veriu.

— Po fëmijën? Po gruan?

— Gruaja s'është më imja. Me gjithë atë zhurmë që bëri ajo, si do të jetë gruaja ime?

Plaku i zgjati kutinë e duhanit.

— Gabim e ke, o Çote! Ndofta ajo u rrëmbye, por tashti mund të merreni vesh, është fëmija në këtë mes.

— Më tutje fëmijën edhe mund ta marr.

— E merr po s'ta japin.

— Pse? Ajo është imja!

— Vërtet, por mos harro, qengjin nuk ja japin ujkut. Ti ujk nuk je, por po ta mahisësh punën me inate, jot shoqe... Sidoqoftë ti më dukesh i nxituar. U bë si u bë, tashti i hedhim plloçën sipër. Ktheu në shtëpi dhe fillo radhë të re.

— E kam vendosur, nuk vij dot.

— Po pse nuk vjen? — kërceu plaku, — s'vjen se nuk e do gruan, apo se ke gjetur ndonjë tjetër, asaj ane?

Çotja mohoi me kokë.

— ... është e kotë, nuk vij.

Buzët iu drodhën dhe i kafshoi që t'i përmbajë. Një këmborë dashi tringëlliu më lart. Tingulli i saj (tingull bakri) jehoi nëpër arat me misër.

Plaku heshti. Tashti e kuptonte brengën e

këtij njeriu. Sytë e tij të përunjur, ai zë i ngadalshëm, ai afrim prej hajduti... Plaku desh të gjejë një mënyrë si ta kthejë Çoten në shtëpi.

— Është mallëkim të ikësh nga vendlindja, biro. Ju të rinjtë jini si hunjët e gardhit, ne pleqtë jemi si shufrat. Për shufrën që hiqet mund të vesh një tjetër, kurse për hurin e shëndoshë që hiqet...

Por Çotja desh ta kthejë bisedën, desh ta nisë plakun për në fshat.

— Nuk e kthen njeri jo... (Befas plakut iu picërruan sytë) Punë e njeriut është si punë e ujit. Kur niset nga shtrati, uji niset me vrull, me gurgullime, niset që të arrijë shpejt e shpejt. Por rruga është e thatë, e vështirë, i dalin përpara kërteçina, brima, gjeratore. Rruga i hap punë ujit, ashtu sikurse jeta i hap punë mendjes së njeriut. Prandaj edhe ti, biro, duhet të mendohesh, të mendohesh mirë dhe si i thonë fjalës, plakut fjalët ja dëgjo... Tashti unë e kuptoj ku të dhemb e ku të shemb. Ti ke turp të kthehesh në shtëpi, por unë jam plak e di më shumë se ti. Ai që ka droje dhe turp, ai njeri ka cipë, është i mirë. Pa m'i trego duart? Ja dhe uji erdhi...

Çotja hapi pëllëmbët.

— Ja, duar që të nderojnë, duar punëtori.

Kazma dhe lopata në tre vjet e kanë kruar dhe larë çfarëdo të keqe që kanë patur këto duar. Ti i duhesh fshatit tënd, i duhesh vajzës. Sa e bukur është bërë ajo qenushe, veç ta shikosh! I duhesh dhe gruas, u duhesh edhe motrave të tua, fëmijëve të tyre.

— Jo, xha Mano, — përsëriti Çotja duke psherëtirë. — Nuk mundem.

Rrinte kuspull me duart qarkuar mbi gjunjët. Plaku çeli me shat një vragji të re dhe lëshoi ujin atje.

— Të ndjek një hie e keqe, Çote. Më duket sikur ke një zhabë të ligë në bark, jo në bark, por në grykë të ka mbetur, nxirre, hidhe tutje, dëgjomë mua! Po deshe t'i sjell gjer këtu motrat, fëmijën, gruan, të merreni vesh. Do rendin me mall këtu.

— Jo, jo — ja ktheu Çotja i lemerisur, — nuk kthehem, por a do më ndihësh për atë që të thashë?

Plaku s'u përgjegj. Doli nga vija, lëshoi shatin dhe këputi një dorë me lëpusha; me to fshiu këmbët nga balta, mbathi çorapët, opingat. Mendohej.

— Si të duash, — i tha më në fund, — nema pullën këtu.

— Dhe mos trego që erdha, ta mbash besën.

— Ti prandaj erdhe te unë.

Çotja vu dorën në xhep, dora e plakut dridhej.

— Unë do të vadis sa të kthehesh.

I riu nxori këpucët, çorapet dhe hyri në vijë. Ujët ja gudulisi pulpët, i shkuan të ngjethura në trup, por i pëlqeu.

«Tre vjet që s'kam vaditur» dhe u gëlltit i ngashëryer.

Nga ujët e përzjerë me llucë e baltë kërceu një bretkocë e u hodh në ledh. Çotja ngriti shatin pas saj.

— Jo atë, — ndërhyri plaku, — jo atë...

Shata mbeti në erë, prej saj rrodhën currila me tinë, për një çast vezulloi në diell disku i hekurt i veglës. Plaku u nis. Pas çapeve të tij u ngrit një fjollë pluhuri. Ai çante nëpër plisat e thatë të ugarit, e, mbi krye të tij, Çotja pa ethet e zhegut që loznin valle nënë saqin e diellit.

«Zor që plaku t'i bënte shërbim gjithë këtij uji... nga larg punët duken më të thjeshta».

Çotja nxitoi krahët, pantallonat i ngriti gjer mbi gju. Toka thëthinte ujin me llokoçitje si një derr i etuar që gërrit i paglindur.<sup>1)</sup> Plasaritjet e tokës humbisnin nën masën e lëngshme, fletët e misrit fërkonin njëra tjetrën, me një fëshfërimë që veshi ka qejf ta dëgjojë. Te hieja e goricës Çotja pa një kërcell të gjelbër: «Misër i njomë! Ja, edhe mustaku nuk i është shkrumbosur, misër qumështor». Çotja ndjeu më shumë mall për ta pjekur, se sa uri për ta ngrënë.

«Të pjekësh misra të njomë, në mbrëmje pas lumit, me një zjarr bubulak, me një shkop të gjatë në dorë, të jesh i ri, dhe të jetë ditë e diel. Vajzat dhe fëmijët afrohen që lart, nga gryka e lumit, duke kënduar, kalojnë nëpër manaferrat, nëpër bar, gonxhet e tërfilit u përkëdhelin pulpët... të jetë, të jetë... por që të ndodhë kështu duhet të jetosh në fshat, duhet të jesh fshatar që ta kuptosh, fshatar që ta gëzosh, fshatar që ta ndjesh këtë mall... kurse unë...»

Fryu era, xhufkat e misrit lëshuan pluhur të verdhë. Një kungull lëkundej mbi ujë. «Pra, këtu toka u ngop». Ngriti shatin më tej, kur pa

---

1) I paglindur = I pa ngopur me bukë.

pritur një zë njeriu që nga mezhda e bëri të dri-  
dhet. Dikush doli që prapa ferrave, por aq pa  
pritur! Çotja desh të fshihej, por s'qe e mundur.

— Ooo, xha Manoooo, as gjysmën e normës  
s'e ke bërë, domethënë... të paska lënë plaka pa  
gjumë...

Brigadier Lilua çakariti sytë dhe i doli për-  
para. Çotes iu duk se brigadieri hapi anash katër  
duar, sepse i riardhuri kishte edhe zhalonin<sup>1)</sup> në  
pëllëmbë.

— Ti? Çote? Mirëseardhe vëllaçko! Hajde, e  
shkuar qoftë!

Lëshoi zhalonin, ky ra për tokë, mbi të ra  
bishti i shatit. U përçafuan, ishin moshatarë. Çotja  
vështronte gjunjët e shokut, kurse shoku s'ja ta-  
konte dot sytë.

— Ngre kokën de, unë s'i kam sytë ndër  
gjunjë!... Erdhe më në fund. Të shkuara të ha-  
rruara, domethënë, si nuk më tha njeri në fshat?  
Pasje dalë, domethënë, drejt në punë. Domethënë  
kryetari të dërgoi?

Një vërshim të tillë Çotja e preu pak si thatë.

— S'kam ardhur për të ndenjtur në fshat,  
Lilo dhe nuk vij...

— Je në vete? Ç'janë këto?

— .....

— Kaloi ajo, edhe plagët zënë kore, dome-  
thënë. Ne këtu...

— Jo, Lilo, është e kotë nuk qëndroj këtu.

— Po më habit! Atëhere, domethënë kur

---

1) Zhalon = vegla e matjes që mbajnë brigadierët.

ngjau çështja, nuk ta pashë drojen dhe turpin e sotmë...

— Ndofta ashtu është, kam punuar dhe mësuar shumë këtyre vjetëve. Kur i ve hekur kokës, s'ke ç'i bën, edhe do të punosh edhe do mësosh.

— Domethënë ma bëj groshin kacidhe...

— Ja, që fjala vjen, kur ngre armën dhe vret një njeri, kryen një vepër të ligë, të pështirë pa fjalë, por je gjakprishur, akoma s'e ke kuptuar mirë çfarë gjëme i dhe rrugë. Po pastaj kur sheh atë lëngun e kuq që derdhet, zalisesh, të ze gjaku, më keq kur kallin kufomën në varr, edhe më liksht kur lebetiten gratë... më kupton?

— Po mirë, nuk të zu malli për fëmijën? Gjithnjë më ndjek pas e më thërret: — Xhaxhi Lilo, xhaxhi Lilo, do më sjellësh bukë lepurushi nga arat? — Domethënë malli për motrat, domethënë edhe gruaja...

Lilua e preu fjalën në mes. E kuptoi se po hidhte ujë në gëlqere. Sikur të vijonte më tej, Çotes do t'i pikonin lot. Ai dridhej dhe bënte të fërkojë gjunjët, për të fshehur ethen e duarve.

Në ferrat aty më lart, fëmijët mblidhnin manaferra në poça prej llamarine. Ata as e kishin mëndjen te ara ku vaditej misri, as te njerëzit që ishin aty, por Çotes iu duk sikur sy grash e përgjonin nga drizat, iu bë sikur pa një linjë të bardhë. «Burrat me zor mund t'i takoj, po gratë, çupat?!»

Bëri sikur ndjeu keq përcëllimin e diellit dhe ndërroi vënd, duke kthyer shpinën nga manaferrat. Lilua e pasoi.

— Gjithë këtyre vjetëve, si një hie e ligë, turpi më ka ndjekur pas...

U duk plaku përfundi arës. Çotes i muarr tëmthas zjarr. Xha Manua kishte përdore një fëmijë. Çotja s'e njohu, por e mori me mend. «Sa qënka rritur!» Harroi të përgjojë mos vinte edhe dikush tjetër, harroi të shohë fletën, që plaku mbante në dorë. Manua rrahu këmbët për tokë e i foli vajzës së vogël:

— Ja, ky është yt atë, zere për qafe, dhe ti o Çote zgjidh e merr tashti: ja vajzën, ja kartën...

Çupa u afrua me sytë përdhe. Ngriti doçkat dhe përqafoi të atin. Ish veshur me një grykashkë sateni të zi, mbante sandale me rrypa kauçuku, por çorape nuk kishte. Çotja shtrëngoi vajzën ndër duar «Sa shumë qënke rritur!» Vajza nuk fliste dot. «Sa keq që nuk munda t'i sjell gjëkafshë...»

Por Çoten nuk e zinte vëndi. Kishte frikë se mos vinin njerëz, kishte turp se mos lëshoheshin atje gra dhe vajza, kish droje se vinin motrat. «Lajmi është si flaka e kashtës, — pat dëgjuar dikur — sakaq merr fushat». Por tashti Çotja ndjente një dëshirë të thellë, të pamatur, një dëshirë prej prindi që të mbajë të bijën në pëqi. Dashuria për të bijën dhe turpi për vjedhjen! Të dy këta virtyte përfytyeshin në shpirtin e Çotes. U mundua që ta bëjë vajzën të flasë, e pyeti disa herë me radhë, por ajo nuk përgjigjej. Plaku dhe Lilua e nxitnin, por ajo heshte gjithnjë. Por më fund brenga që kishte zënë vënd në zemrën e saj të vogël, dha krye. Ajo guxoi dhe i pëshpëriti të atit:

— Babi, babi, mua, mua... një shoqe më thotë,... ti Nida s'ke baba!

Çotes iu lëkund nofulla e poshtme.

— Këtu më ke, Nida, ja ku jam, por më vonë unë do të vij të të marr, tashti duhet të ik.

Vajza s'mundi të përgjigjet, dhe ai s'mund ta shihte në sy. E puti fëmijën, bëri toka me burrat, mori fletën që solli Manua dhe u nis.

— Mos kështu Çote, e ta dish nga plaku, edhe mushka më xanaxare vete ku vete e prapë te strumbullari kthehet.

Çotja u nis.

— Mirë thonë, — i pëshpëriti Manua Lilos, — hapsanikëve u merren këmbët. — Lilua përçapi nëpër gojë një «domethënë», psherëtiu e kapi për dore Nidën.

— Eja me mua Nidë, eja.

Çote Larja kaloi përfundi arës. Ujërat e lëshuara nëpër vrragat kishin teptisur mbi ledh. Mbi patozin e rrugës dukeshin kumbulla të zeza ngjyer me pluhur të verdhë. Ai u kërrus pas kullumbrivet e kaptoi Kodrën e Vogël, vështroi shelgjet te Përroi i Madh. I merreshin mëntë, i vinte trazi. Qëndroi te Burimi i Zallit. Që këtu dukej fshati si në pëllëmbë të dorës!

Burimi kish një lëpushë në vend të lugut; rrjedha trokëllinte mbi zajet e kuq, i lante, i fërkonte, i lëkundte nga vëndi. Rreth e qark kish-te thërmia gjize, buke, bishta qepe. Më tutje bar skrips me kërcej të blertë, të blertë në formë borige. Një kone e vogël po qasej këtej, me gjuhën e kuqe qitur përjashta. Kur takoi të panjohurin, ajo u spraps e bëri për te gardhi më tej.



Çote Larja ra më gjunjë te Burimi i Zallit. Ashtu vështroi fshatin përballë. Pastaj, sikur të falej, u përkul para burimit kundrejt fshatit. Kupëzat e gjunjëve iu ngacmuan nga zajet, sikur iu gudulisën, pastaj një nem i hollë ia freskoi. Çkoptisi gjoksin, kopsa e dytë i mungonte. Mbushi dorën me ujë, spërkati parzmin si dikur. Fërgëlloi. «Sa mirë...» mendoi. Dihati fort dhe psherëtiu. Mbi kokë, harabelat e kthyer nga stërnishtat, prisnin ikjen e Çotes që të shuanin etjen. Ai i ndjente këmbët si të prera. Vu pëllëmbët në tëmtha.

Dy virtutet vijonin të ziheshin te ai. Turpi për atë që koha e la prapa, dashuria për njerëzit dhe vëndlindjen, që kishte përpara. Zëmra i rrihte me vrull. I dukej sikur një dorë e njohur aty, brënda në gjoks, e qëllonte me këmbëngulje dhe e ngucte të mos ikë.

Dëgjoi zhurmë çapesh. Çotja u mëshoi gjunjëve dhe u ngrit. Dikush afrohej. Nëpër disa kërcej manaferrash ai njohu Lilon me Nidën për dore. Brigadieri e ngriti zërin me të fortë:

— Ama, e di sa hajvan që bëhe! Hajde, ore, mbushe kokën... s'të le të ikësh... nuk të le...

Çotja që ulur në ledh e kish ulur kryet. E bija i hyri në mes të gjunjëve. E kuptoi që Lilua e nxiste të bënte ashtu. Fëmija dridhej. Çotja më shumë e kuptoi këtë, se sa e pa. Flokët e fëmijës ja gudulisnin buzët.

— Babi...

Ajo deshi të thoshte diçka, por më shumë nuk mundi. Lilua me gur në dorë po mbërthente një peronë në zhalon. Guri ishte si shtufë; gërryhej

dhe lëshonte cikërima, pa pritur u thye copë-copë... Lilua kërceu përpjetë, duke sharë e bërtitur. Tregonjës in e lëpinte me gjuhë. E kishte vrrarë. Dashur, pa dashur, Çotja rendi te ai...

— A të dhemb?

— Për të dhembur ç'e pyet?

Lilua vej e vinte, sillej rrotull, kërcente dhe çalonte sikur të kish vrrarë këmbën.

— Dale të ta lidh; t'u gjakos?

— Jo, kur nuk gjakoset dhemb më shumë.

Lilua ndehu dorën. Shoku ja vështroi:

— Nga goditja të qënka bërë mëllër në thua.

— S'është gjë, do të kalojë me kohë.

Lilua ja lëshoi zhalonin Çotes, ky e vari në supin e vet; me dorën tjetër mbante vajzën.

Dhe të dy u nisën tatëpjetë.

— Mbledhim lajthi gjer në mbrëmje e pas-taj zbresim në fshat.

Çotja nuk u përgjegj, por çapin s'e ndaloi.

## P E N D I M

**N**ë qetësinë e thellë të natës, zilja e sahatit tringëlliu fort. Roksana ishte e zgjuar.

— Fle, o burrë? — i foli ajo të shoqit.

Atij i kishte dalë gjumi, por s'u përgjegj; nguli më fort fytyrën pas jastëkut dhe u struk pas së shoqes. Kish filluar të mugëtijë, aqë sa ndër xhamat e dritareve shquheshin sumbulla të imta, si djersë avulli. Në kalldrëmin përjashta kalonin atá, që ngjiteshin në mal për shkarpa të thata. Çapat e njerëzve nuk ndiheshin fare, sepse djemtë ishin kaluar, por dëgjohej rrëmuja e thundrave të gomarëve.

«Janë të pa mbathur, — mendoj Panoja i strukur pas së shoqes — por këtu s'ka gjë se, fundja fundit, rruga e pyllit është e butë dhe balta e mbrytur... kurse ai imi duhet mbathur domosdo. Pse? do thuash ti! E po asaj rruge të gjatë s'i delet ndryshe...

— E moj grua, ja ktheu vonë së shoqes, e ke parë ndonjë ëndër sonte?

Që të merrte hak, ajo s'iu përgjegj.

— Grua!

— Folë.

— Një krodhë bukë desha, sa për ta thyer...  
— dhe Panua zgjati dorën dhe mori çibukun në buhar.

— Ngreu dhe merr vetë, je mësuar si ndonjë kral, çdo gjë të ta japin në dorë.

— Ama edhe ti, mua më punon mëndja për mirë, ti...

— Mëndja të punon, por duart në vënd, si dembel s'ke shok, s'di nga të shtrihesh gjithë ditën.

— Mos më hyr në hakët Roksanë, ç'ti bëj përdhesit unë?

— E di, e di, të njoh.

— Kam vendosur të shkoj asaj Kërrabe me gomarë, do bëj transport drush, ca pare do t'i nxjerr.

Gruaja mori zjarr menjëherë, kërceu në shesh dhe filloi të lidhë shaminë e kokës:

— Përsëri të mori koka erë! Gjithë fshati është lëshuar pas mbjelljeve, ti kërkon të ikësh.

— E po, ta kam thënë, për qilizmë s'jam unë. Pse? do të thuash ti. Po si pse! Puno sot e parat në lëmë! Unë do të nisem këto ditë.

Gruaja e mërzhitur, e nxituar ja ktheu:

— Shtrohu këtu si njeri, pa po ike ti, po fute pesë groshë në qese, do t'i lësh kafeneve...

— Shkoi e vate, s'ma urove një herë rrugën e mbarë.

— Unë të them t'i shtrohesh punës, nesër pasnesër do të duhesh të mbash duaj me gomarë. Rri të futëm bukën brënda pastaj thyej qafën. Në kohë të lëmit mund të vesh ca mëditje. Është turp të ikësh tashti.

— Ata të kryesisë s'më pengojnë, ti...

— Çfarë të të bëjnë? Ta hoqën fillë. Me kë të merren vesh? Me ty?

— Unë do shkoj. Po pse do thuash ti. Si pse? E përse të thyej krahët unë, kur kam kurrizë e gomarit? Pastaj për punën e lëmit?! Dëgjomë mua ti, si ata që kreshmojnë, si ata që s'kreshmojnë, pashkën njëloj e festojnë!

— Për llafe s'ta del njeri ty. Të kishe duart si ke gjuhën...

Pa pritur një zë i fortë çunaku ushtoi mu te dritarja!

— E mo Pano, ç'thotë ajo «shpanjollka»?

Ata që shkonin për dru e qesëndisnin Pannon gjithnjë, ai qe mësuar, po e shoqja iu kthye:

— Të kanë marrë nëpër këmbë edhe kalamajtë, mor shoshë e prishur!

— Nem një kafshitë bukë, të them, leri llafet!

— Jepii, Pano! — ushtoi që nga jashtë.

Ai po qëllonte me masat e xixat përhapeshin nëpër dhomë, përplaseshin në mure, në tavan e gjer në dritare mbi rrugë. Roksana nuk pushonte.

— A, ç'më çan kokën, o grua, — dhe kapi me nxitim atë copëz eshke, që kishte marrë një syth zjarri. U ndër një erë e mirë, përzjerë erë e stërhallit me atë të eshkës, pastaj mbajti erë leckë.

— Na dogje, or u djegsh lugat!

Ajo hodhi tutje plafin me thekë, diku u duk një si grimë shpuze, ajo ngjeu gishtin në gojë dhe e fiku xixën.

— Hajde, ngreu!

Ai psherëtiu fort.

— E, po shpejt është de, lermë të pi rehat një çibuk dhe... daç Perëndinë nëm një kafshitë, sa ta thyej.

— Do të të jap, por ta dish, sot t'i kemi fjalët përpara. Do shkosh në Progër të më sjellësh gëlqere, se ndryshe... Dëgjove? Dua të lyej shtëpinë.

— Mirë, de, mirë.

— Pooo, kështu thua ngahera ti, pastaj vete shtrihesh hieve. — Biseda dhe grindje të tilla midis Panos dhe Roksanës ngjisnin gjithnjë dhe i dinte gjithë fshati. I qanin hallin Roksanës, dikush i thoshte të ndajë Panon, dikush i jepte zemër, një tjetër kërkonte muhabet:

— Ç't'i bësh, o Sane! Fati i gruas nuk dihet, u rrukullis tenxherja e mirë, e ra në një kapak me vrimë, hajde dhe e gjej ti tashti!

Pano Nagallja mbahej si dembel i fshatit. E dinte edhe vetë hakun e tij dhe kur e ngacmonin fort, e kishte në majë të gjuhës:

— Unë jam ca i rëndë në punë, vërtet. Po pse do të thuash ti. Po e kam një cen, por edhe Rokšana s'lind fëmijë. Kabull njëri tjetrin. Apo s'e kam mirë?

Panua mbaroi çibukun, kurse e shoqja doli në oborr, hyri në haur, mori Balashen për kapistre dhe e qasi këtej. Përmbi policën tringëlliu një zhurmë teneqeje; ajo mori mastrapanin. Lopa shfryu, viçi kapi njërin thith, Rokšana tjetrin, kurse i shoqi, duke dëgjuar gumëzhitjen e qumështit, që binte në enë, u tulat nën levenxen e ngrohët.

Ajo u vërtit një copë herë nëpër shtëpi, ndezi

zjarrin, trashi qumështin; ai nëpër gjumë ndjente çapet e saj në odat lart dhe, sipas kërcëllimës së lehtë të trarëve, ai merrte me mend:

«Roksana është në sobalkë e po merr djathë, tashti hyri në sobë, tashti po merr torbën në sergjen, ja, po zbret shkallëve...»

— Dëgjove? Kur të thërresë lopari, të lëshosh Balashen. Viçin lere nëpër oborr, hidhi ca krënd nga shelgu. Paret e gelqeres t'i lashë mbi shkallë... .

— ...Shto edhe ndonjë lek për rrugës.

— S'ke ç'i do.

— E, po do ta pi një dopjo atje në Progër.

— Farmak, thuaj...

Panua ndjeu fërkimin e kanatës me kllapën, Balashja pëlliti lehtë, e shoqja ishte nisur në punë.

Ai ishte gjysmë i zgjuar, kapakët e syve ja përcëllonte një dritëz e vogël e ai s'e kuptonte dot në se Roksana kish lënë ndonjë shkarpë të ndezur në vatër, apo kuqëlonte mëngjezi në xham. Sidoqoftë, ai u kthye në anën tjetër, e ja mori edhe një herë një copëz gjumi të shkurtër, por të ëmbël sheqer. Do flinte kushedi sa, por gomari ja buçiti që nga hauri me një pallmë zulmë-madhe, sa e shkundi Panon me gjithsejt.

— Hej, gjetsh belanë, i mallëkuar!

U ngrit, u shtriq një copë herë, kërcëlliti kyçet e duarve, gogësiu fort sa i kërcitën edhe kockat e nofullës. «Më vjen nga të pangrënët, — mendoj-se sa për gjumë, u ënjta paq...»

Kur doli dielli u nis. Shaloi gomarin te Guri Xip, ja ngjeshi me dobec në vithe e:

— Hajt, na daltë mbarë! — tha.

Gomari e nisi rrugën nxituar, se mizat edhe s'e kishin pikasur, por më tej zu rrihte bishtin, zu tundte veshët e shkundej me gjithsejt. Më të dalë të fshatit Panua shtrëmbëroi buzët. Dikush ktheu qoshen përpara dhe nuk i foli.

«Oh, dhe ky, më mban mëri, nuk më flet me gojë, ja punë, ja... dhe është kryetar i frontit i biri i botës, dhe përse pa; për punën e gomarëve». Ishte biseduar që të mbanin vetëm gomarë për punë, sepse njerëzia ishin lodhur së dëgjuari ato potere dhe gurgule, ato pëllitje zulmë-mëdha, që tundnin fshatin që nga themelet. Po hajt e u merr vesh me Panon. Nuk pranonte në asnjë mënyrë të shesë gomarin mashkull e të merrte një femër. — S'më bëhet puna, thoshte, nuk më bëhet dhe mbaroi. — Po merr një mushkë të vogël, një mushkë lope po deshe, të ndihmojmë edhe ne. — Jo, s'dua, mushka do punë ndryshe, bëhet xanxare dhe gjej belanë. Unë s'jam i zoti, s'më le rehat përdhesi. Pse do thuash ti. Po një gomaricë është gjysma e gomarit, në forcë pune ta ngas fjalën...»

— Ush, o i shkretë!

Nga inati i kryetarit të frontit, Panua iu kthye me dobec gomarit të vet e ja bëri vithet copë. Po veshëgjati zu turfullonte pas llokaçeve të verdha, zu ngrinte turinjte nga qielli, gjersa mori hov e ja lëshoi pallmës së tij të zakonshme!

— Ush, o i mallëkuar!

Por ai s'desh t'ja dinte. Ik e pall, rend e gjëmo!

Po kalonin anës një are sapo lëruar. Duke-shin plisat e njomë, shtritur radhë-radhë si jashtëkë. Më tutje tymonte. U kishin kallur zjarrin



kopaneve të vjetra të rrënjëve të fshesave. Një djalë i ri doli te mezhda me hosten në dorë, vu buzën në gaz e shkundi këmbët me opinga kau.

— Puna mbarë.

— Mirse erdhe. Po mos, o Pano, se ja bëre lëkurën copë të gjorit.

— As po jashari, qeni, s'do t'ja dijë, — dhe s'ja zgjati djalit. Këtij s'i erdhi mirë, e s'e la pa thumbuar:

— O Panooo! Po kur rendje ti pas «shpanjollkës», kush të ndiqte me dobec?

Panua nuk desh të dëgjojë kusurin dhe ja ktheu me një «ç'më çan kokën». Ja ngjeshi gomarit me thembër në bark, si ta rrihte me mamuz. Kishte kaluar kufirin e arave të fshatit, arriti në grykë të Qafës, ktheu kokën pas:

Tutje, pas tymit të oxhaqeve, dukej fshati; më këtej, gra e burra varg nëpër ara; dy traktorë veinin e vinin nëpër fushë, duke uturuar herë më shumë e herë më pak, se frynte erë, dukej kopeja e derrave pas lumit. «Ja, edhe ai shejtani, që më kujtoi «shpanjollkën»!

I binin dëndur më qafë Panos për këtë të fundit. Kjo ndodhte sepse, kur Panua vinte më qejf, qoftë në dasmë, në përshpirtje apo në vigje, tregonte historinë e zemrës:

— Kur hanja kurbet në Moré, kisha të dashur një «shpanjollkë». Kjo «shpanjollka», more shpirt, ishte një çupë për kokë të saj. I kish pulpët si të lyera me vaj.

Te klubi i Hoçishtit, Panua hodhi kapistrën e kafshës në hekur të dritares, u dha ngjatjetën nja dy burrave atje dhe thirri pas banakut:

— Ore Dhimitraq! Mbushmë një dopio.

Dhimitraqi doli këtej, duke fshirë duart me përparësen. Në gjoks të përparëses i dukej një shenjë gjaku.

— Bën edhe kasapllëk, o usta?

— Jo more, po... «më solli zagari një lepur» e po gatuaj një tavë.

— Pse nuk thua që do t'ja shtrojmë?

— S'është për ty, vëlla Pano. Ti ikë ku je nisur, se po i hyre valles këtu, do të mbetesh pa gomar.

Dhimitraqi nuk ja zgjati më tutje, i mbushi dopion, mori paranë e hyri nga pat dalë. Panos ja gudulisi hundët një aromë piperi të zi e pshe-rëtiu.

— Ç'kemi atij Devolli lart? — e pyeti një nga burrat atje.

— Ç'të kemi? Ja, sot, lavdi Zotit, kohë e mirë.

— Na kalbi misrin ai djall shiu, neve na dëmtoi edhe breshëri. Po andej nga juve mori reja?

— Budalla që bëhesh, — ja ktheu Panua si pa të keq, — thuaj shyqyr që jemi kooperativë, se me gjemën e breshërit, të qënkëshin individë, do mos na zinte gjumi motn' e tërë.

— Dy të tjerëve u mbetnë kupat në hava.

— Je esëll, Pano, apo si e ke punën?

Por Panos iu kujtua Roksana, Progëri, gëlqerja, udha e gjatë, e zvarrë-zvarrë bëri përjashta. Doli nga Hoçishti. Gomarin e ngiste anës udhës e mendohej.

«Mirë se tashti jam hypur, por kur të kthehem? Ush, o i shkretë». Iu afrua urës së madhe. Gomari u praps një herë, por Panua ja ngjeshi me thembër në bark. Lumi ishte akoma i fryrë prej shirave, që kishin rënë. Hieja e Panos zgjatej

tutje ujërave, hieja e tij me të gomarit bashkë. Thundrat e kafshës nëpër pllakomat e urës lëshonin një zhurmë, që Panos i kujtonte atë që lëshon arra, kur e kajthitim<sup>1)</sup>.

«Për të ardhur e zgjata rrugën këtej nga ura, se jam hypur. Po kur të kthehem? Sa shumë zgjat kjo rrugë nëpër urë! Eh, këto djall shira!»

Në Progër e gjeti depon e gëlqeres pas gjurmëve. Udha, sa vinte bëhej më e bardhë. E lidhi kafshën në një gardh, i vu përpara një krah me bushka, sa të gërzitej e iu qas shitësit. Ky ishte i bardhë me vetulla, flokë e rroba, si të kish dalë nga poti i miellit. Panua vështroi gëlqeren një copë herë, priti sa mbaruan blerësit e tjerë, pastaj u qas me gjithë gomar.

— Ore mik, ta afrojmë kafshën dhe ma hidh gëlqeren brënda në kasonat. Kush rri shkarkon tashti, le që jam edhe i nxituar.

— Ki mëndjen, — ja ktheu shitësi, — kur të shuash gëlqeren ta ngopësh mirë me ujë, se të shurdhohet. Na nxori gëlqere të mirë kjo furra e fundit, apo të thatë... barut, për besë!

Më të dalë të Progërit, Pano Nagallja qëndroi të shtrëngoje oputat dhe psherëtiu. «Gjithë kjo rrugë më këmbë!» Po ec e pi duhan, ec e vështro gjithë atë mizëri njerëzish lëshuar arave, ec e hidh këtu një «puna mbarë», atje një «mirserrini», më tutje një «ju bëftë mirë».

— Mjeshtër të tokës këta devollinjtë e posh-

---

1) Kajthitje — a = heqja e lëvezhgës së arrës dhe lajthisë.

tëm. Po pse do të thuash ti. Si ore, pse? Ta punojnë këtë tokë sikur do të mbjellin borzilok.

Panua çvari torbën nga kocaqja e samarit dhe hapi «magjen» si thoshte vetë.

— Apo nikoqire e mirë ajo Roksana, besabesën, shaje sa të duash, po jepi hakën; po pse do të thuash ti...

Në bohçen ku qe mbështjellë buka ai gjeti një fetë djathë të bardhë, nxjerrë drejt e nga napa, e bardhë dhe e butë. Aty, këtu shquheshin pikat e murme të kripës, pastaj një masë gjalpi mbështjellë me fletë pjergulle.

— Ka hak, e varfëra grua. Po pse do thuash ti. Po ja, ka hak të qahet me një Pano të këtillë, si jam unë. Po ç't'i bësh? Ja, kështu jam: I mirë, i dashur, i dhëmbur, i fjalës, i muhabetit, i kupës, i shakasë, por më tutje mos shko... për punë mos më thuaj, kështu u preva, kështu do të grisem.

Te Krekat e tylbesë Panua u gjend në udhëkryq. Anë e qark punonin gra dhe vajza shpërndarë nëpër fushën me panxhar.

— Çunksh, o veshëgjatë, çunksh, o i shkretël!

Gomari qëndroi. Panua me këmbët në kum të lagur, afër lumit, zu të mendohet:

«Të shkoj nga ura e madhe? Mirëpo duhet nja gjysmë ore rrugë akoma, rrugë e tepërt. Këtu, në lumë, i bie më të prerë...»

Hoqi gomarë më tej, kaptoi nja dy si ferra, si kullumbri, kaloi një tumbë me shelgje e doli buzë lumit. Këtu kishte dritë më shumë, e Panua s'e mori vesh përse iu desh të mbushet me frymë.

Në bregun e tejme dukeshin ca si rrrathë, si vija që patën lënë ujërat kur pakësoheshin.

«Ja ku ka qënë lumi pardje, ja dje, ja ku ka qënë sot në mëngjes. Po, sot në mëngjes, aty ishte ai shelgu çatall, i thatë si alipsan e nuk dukej fare. Ujë s'qënka krejt i turbullt, as i kulluar jo, por sidoqoftë njihet shtrati përfundi; s'paska shumë ujë, gjer nën gju. Nëpër dallgët e vogla ja ku njihen fiye bari e bisqe rakite...»

Panua kishte mbështjellë kokën e gomarit me krahun e vet. Kafsha, me buzët e saj të buta si kadife, ja përkëdhelte pëllëmbën Panos. Por era e mirë, drita e fortë, përtesa dhe dëshira për të shkurtuar rrugë, i dhanë Panos kurajë që të marrë një vendim. Hoqi opingat, zbathi çorapet e leshta, ngriti pantallonat gjer mbi gju dhe e ngau gomarë nëpër lumë:

— Ush, o i shkretë!

Gomari, tundi kryet sikur falej, desh ta ulë gjer mbi faqen e ujit, por kapistra, shtrënguar shkurtër në kaptell, nuk e lejoi. U nis.

— Ush, hajvan!

«Hë more, se s'ka shumë ujë». Fërgëlloi nga ujërat e ftohta dhe u përshkund. Shkonte pas gomarit, njëren dorë lart e tjetren në vithe të kafshës.

«Mirë jam, mirë».

Shkelte përmbi haliçë, përmbi gurë, përmbi plloça. Pulpët iu skuqën dhe qimet e këmbëve iu ngjitën pas mishit.

— Ush gomar, ush xhan!

Pa pritur kafsha u zbraps.

— Ush de, ush!

Gomari bëri të sulet përpara, por u lëkund më fort. Panua ja ngjeshi me dobec midis vitheve e stelës së samarit.

— Ush, o i mallëkuar!

Dhe e shtyti sikur t'i japë ndihmë. Në një çast kafsha kërcëu mbi këmbët e para, diçka kërciti në thundrat e tij, bishti po i futej në ujë. Panua u lemeris. Një nga këmbët e pasme të kafshës qe ngulur në një vrimë, ose qe mpleksur në një rrënjë.

«Rrënjë, kërteçinë, apo gjeratore? Dreqi e merr vesh...»

Panua u lëshua anash t'i këputë qenglën, por në atë çast ngjau gjëma. Kafsha e fortë bëri një sulm të fundit. Dësh të çlirojë këmbën medoemos. Nga vrulli i saj, Panua u godit prej arkës dhe u zbraps, por këmba e gomarit nuk u shkull dot, ai u përplas në lumë me gjithë barrën e vet. Në çast, ujët për rreth mori pamjen e qumështit të prerë, pastaj u dukën ca fllucka të mallëkuara. Kafsha mundohej ta mbajë kokën përmbi ujë, por... mirë pat thënë ai shitësi në Progër, gëlqere barut!

I pazoti të bëjë gjë, Panua u hodh gjer në breg dhe filloi të bërtasë e të kërkojë ndihmë. Tashti në mes të lumit dallohej një farë vullkani i vogël, që lëshonte tym dhe lavë të bardhë nëpër llokoçitjet e gëlqeres, që thëthinte e s'ngopej dot me ujë.

Një tufë çupash, që prashitnin panxhar, re-ndën andej. Por tashi çdo ndërhyrje ishte e kotë, e pamundur. Gomari i fortë mund t'i shpëtonte gjëmës, me përpëlitjet e tij qengla mund të këputej, por kafsha u përvëlua nga ndezja e gëlqeres.

Çupat iu mblodhën për rreth Panos, ato ishin të panjohura për të, por e pyesnin, i qanin hallin, i jepnin zemër, i përsëritnin se tashti çdo gjë kishte mbaruar në mes të lumit. Edhe Panua e kuptonte këtë, por ishte bërë si i shastisur. E humbi toruan e nuk dinte nga t'ja mbajë e çfarë të kërkojë. E morën Panon në mes dhe e ftuan te hieja, ku po hanin drekën. Pikë e vrer, Panua i ndiqte pas; herë pas here kthente kryet pas. I vinte për të qarë, por u mbajt. Iu kujtua tregimi popullor, e shkoi ndër mënd:

- «— Kam patur baba unë, moj nënë?  
— Ke patur.  
— Po ç'u bë?  
— U mbyt.  
— Ku u mbyt?  
— Në lumë.  
— Po pse?  
— Se nuk shkoi në urë, por i ra lumit më të prerë.  
— Po pse nuk shkoi në urë?  
— Se përtonte.  
— Por po të shkonte në urë do të mbytej?  
— Jo.  
— Po atëhere mirë ju bë...»  
E pyeti një nga vajzat:  
— Nga të kemi o shok?  
— Nga lumi të më marrë, — dhe ktheu sytë nga lumi.

— Mos u bë merak, ç'ti bësh njeriut, pa kafsha vihet në vend.

Atij iu kujtua Roksana, mendoi edhe çdo thoshte fshati, kur ta merrte vesh. «Prit e dëgjo

tashti. Fjala e parë: Mirë t'u bë. E dyta: Pse nuk shkoje nga ura? E treta, këmbët në një këpucë. O burra, merr kazmën.

Çupat e vunë të ulet pranë një tepsie. Atje ishte një lakror i gjysmuar, një copë e përmbysur. Njihej e poshtmja e lakrorit, kërce e kuqe si bakër, lyer me gjalpë. Por Panos nuk i vihej gjë në gojë. Rrinte duarlidhur e gojëkyçur. Balua i grigjës lehu me të madhe diku pas lumit. U dëgjuan fort tringëllimat e këmborëve. Delet, të trembura nga ai farë kushtrimi, që lëshoi qeni, lanë kullotën dhe u mbloodhën grumbull. Disa të huaj po kalonin anash arave, kishin çanta ndër duar. Pastaj u dukën disa çupa me flokë të gjatë, veshur me pantallona.

— Janë aktorë, — foli një nga punëtorët, — vijnë nga qyteti.

— Çfarë? — pyeti një tjetër.

Panua desh të ndërhyjë, u bë gati të thosh «palaçot», por u vrejt dhe uli kokën sërish. Te kthesa doli një çunak me një gomar të ngarkuar. Gomari nxitonte, pastaj pa ditur gjë për fatin e shokut të vet, ja dha pallmës. Panos i sëmboi në zëmër dhe i shkau një lot.

Një vajzë e ndaloi djaloshin.

— Ç'ke sjellë kështu?

— «Matrial» për shkollën.

Vajzat vështronin Panon, u vinte keq; u dhimsej ai njeri i panjohur, që rrinte galiç me duart e lidhura pas gjunjëve.

— Mos e lësho veten, bëhu burrë!

Ai ngriti kryet dhe vështroi një për një sytë e vajzave. Ndjeu se iu mbloodh diçka në grykë.



«S'më njohin, nuk e dinë fare se cili jam, e megjithatë u lënduan nga fatkeqësia ime.

Ai çoi dorën mbi qafë, ngriti kësulën dhe kroï kokën.

«Po tashti, si do t'ja bëj pa gomar!? Dhe këto vajza që po më qajnë hallin, këto që po më japin kurajo, këto vajza punëtore, që po më mbajnë me fjalë të mirë... sikur ta dinë çfarë dembeli jam unë...»

Dikush po vinte që nga rrugica anës lumit. Ai përkuli tufat e rakitave, largoi me dorë disa kulpra dhe u duk. Ishte brigadieri me zhalon nër duar e gaz në buzë. Ai desh t'i merrte me shpoti vajzat, që patën lënë punën, por kur pa njeriun e huaj u afrua. Dhe me t'u afruar ai, që e njihte Panon, bërtiti:

— Pano Nagallja! Dembeli më i dëgjuar dhe më i pacipë që mund të gjendet.

Panua u kuspullos edhe më keq dhe futi fytyrën midis gjunjëve.

— Ky? Dembel?...

— Po, po, ky. E shoqja kaqe herë i ka thënë: Pano, më mirë hidhu në gropë të gëlqeres se sa të rrosh i gjallë...

— Po këtij iu dogj gomari nga gëlqerja, ja aty në mes të lumit.

— Të ishte djegur vetë!

Vajzat nisën të largohen dhe e shihnin tani Panon me habi, me inat, me përbuzje.

Dhe Pano Nagallja, pa guxuar të ngrejë kryet, s'dinte ku të fshehë fytyrën, s'dinte ku të futë duart dhe i dukej vehtja e vogël dhe e pështirë si një krimb dheu.

**...KAM TË BËJ ME TOKEN, ME BUKËN E  
NJERËZVE**

I shte mëngjes dhe Xhako Xhaferi zbriste tatëpjetë pyllit. Xhaketën e kishte hedhur në sup dhe valixhen e mbante në dorë. Gjunjët i dridheshin nga tatëpjeta e rreptë dhe nga shkarjet nëpër fletët e thata. Fytyrën ja përcëllonin bisqet e njomë dhe fletët e gjelbra të ahut, që edhe s'ishin çpalosur mirë. Ai dëgjonte me dëshirë cicërimat e shpendëve, qëllesat e qukapikëve, shihte bujashkat e vogla, që rrëzoheshin nga drurët dhe e merrte me mënd se ishin ketrat ata që këcenin degë më degë. Doli në një padinë në mes një korieje; ahet e mëdhenj përqark lëkundeshin ngadalë, kurse poshtë bari i dendur dhe i trashë ishte fare i paprekur. Ai dalloi burbuqe të bardha luleshtrydhesh dhe papandehur i këceu në kokë një dëshirë. Nga djersitja, duke zbritur nëpër driza, balli i qe mbushur me pëlhura merimange... ai u kërrus, lëshoi valixhen, xhaketa i shkau poshtë; ashtu futi pëllëmbët në tufat e trasha të barit, i përdrodhi ato dhe vesa iu shtrydh nër duar.

Ashtu lau fytyrën, llërët, fërkoi edhe parzmin e përskuqur dhe përsëri u vu në rrugë.

Dikur, këtyre pyjeve ai ruante bagëtinë me një shkop thane nër duar, pastaj u rrit, shkoi në shkollë vjete e vjete me radhë. Tashti Xhako Xhaferi kthehej në vend lindje agronom, valixhen mbushur me libra dhe kokën plot me plane e hamëndje.

Ecte dhe shihte veç ndonjë copë qielli, kurse dielli rrallë herë dukej nëpër degët e rënda të drurëve. Pa pritur ai dëgjoi zëra të largët! Mos vallë ishin fishkëllimat e flladit nëpër gjiret e gëmushave? Qëndroi, desh të dëgjojë mirë. Vu veshin, por një tufë harabelash e këputën nga një zgërbonjë dhe çanë qetësinë e pyllit. Por sa hodhi edhe disa çape, ai u bind se dëgjonte zëra njerëzish. Kaloi disa filiza të njoma lajthish, drurët u rralluan: përpara kishte një arë të vogël mali, Në mes të saj ishin tri vajza, që rëmihnin me bela. Në krye mbanin kapele të mëdha kashte, ishin kërrusur pas punës dhe ai s'mund t'u shihte fytyrat. Në fund të arës ishte një zjarr i vogël; dukej i ndezur me kondurë frashëri. Djaloshi mbeti në përgjim e kryqëzoi duart mbi gjoks: Te vatra dukej hiri ngjyrë plumbi, pastaj prushi i kuq, flakët e verdha, tymi mavi si prej dru frashëri... dhe të gjitha këto si të ngjitura pas një qilimi të gjelbër.

«Bukuri të tilla... sa shumë ka këtyre anëve të mia, sa shumë kam parë kur isha i vogël. I shihnja dhe nuk u vija rëndësi, më kalonin ashtu kot; por jo fare kot, më janë ngjeshur në kujtesë dhe mund t'i kujtoj sot një për një...»

Vajzat qeshën e kukurisën, diçka rrëmbyen nga toka dhe rendën nga zjarri. Xhako Xhaferi e kuptoi në të parë. Ajo ngastër e ngushtë toke pat qënë mbjellë me patate; këto ishin vjelë vjeshtës, por aty këtu kishin ngelur. Xhakua e dinte se patatet e mbetura dimrit në tokë, janë të ëmbla dhe të buta. Psherëtiu se iu kujtua koha kur mblidhte patate të dimrit me një kaçile ndër duar dhe vështrci për tokë. Atje ishin teshat e vajzave, kosorë, povelje leshi, sandale prej kauçuku dhe thasë. «Me siguri, kur kthehen në shtëpi, vajzat, sipas zakonit i sjellin thasët të mbushur me bar; kanë lënë këtu sandalet, punojnë me nallane, sepse hekuri i belit... po pa shih, ajo në mes qënka Edija e Salos. Nuk i mëshon fare belit me shputën e këmbës; me ato llërë që ka ajo...»

Plisat e tokës ishin me faqe të njoma, të lagështa, të buta, dielli sapo kish dalë dhe ata avullonin. Secili plis kishte të vulosur formën e faqes së belit. Xhakua doli në shesh dhe ato pa e njohur rrudhën ballin dhe u panë sy ndër sy. Po pastaj e njohën.

— Xhakua i Xhaferit, — bërtiti Esmaja dhe të tria u derdhën drejt tij.

Ajo që e njofti e para e përqafoi, se e kishte kushëri të largët, kështu bëri edhe e dyta, kurse Edija e Salos i dha dorën të pathyer në bërryl.

«Sa shumë qënka rritur kjo! Ngjet nga fisi i s'ëmës, faqet gjithë gjak e shëndet, me një gërshet të trashë».

— Puna mbarë, vajza!

— Mirseardhe, Xhako!

Ato vunë re një ndryshim në të folur të tij; ai i quante vajza, si në qytet.

— Hë Xhako, ti do rrish përgjithnjë në fshat?

— Po... natyrisht.

Përsëri ato vunë re që ai përdori një fjalë tjetër.

E afruan te zjarri. Jo për t'u ngrohur se pranvera ishte nderur. Ato deshën ta kënaqin me patatet e ëmbla. Xhakua ecte në mes të tyre dhe i dukej sikur gjithshka rreth e qark lëvizte, këcente, hepohej, përkulej apo fluturonte.

«Natyrisht shpeshët po fluturojnë, drurët e pyllit përkulen lehtë, fletët shushërijnë, kurse gurët qëndrojnë në vend. Mos më duket mua se gjithshka lëviz, sepse brofin vajzat? Mos vallë sepse çapet e vajzave në lëndinë kanë vetitë e atyre ecjeve çapkëne, që mban me vehte mosha e re? Ecim dhe pllazet e këmbëve të zbathura përplaseh me shtrojen e nallanes, përplasen me një zhurmë që më pëlqen ta dëgjoj».

Xhakua pati dëshirë të marrë nër duar belin e Edijes dhe ashtu bëri. Me majën e veglës rëmi-hu tokën e pyllit. Po, delte një farë toke e shkrihur, me rrënjëza të holla; ai ishte plehë pylli, plehë fletësh ngjyrë kafeje. Mund ta krahasoje me kum, veçse ky e kishte ngjyrën të mbyllur dhe cikërimat e holla dukej sikur ishin ngjyer me lyrë.

— Sikur kësaj toke t'i kishit hedhur këtë plehë, që e ka këtu pranë...

Ato ngritën supet, kurse kushërira e largët i përkëdheli krahun.

— Ku ta dimë ne, na dërgoi kryetari këtu për të rëmihur dhe erdhëm. . .

«Po, ç'ndodh kështu? Këto të dyja më shohin drejt në sy, kurse Edija e Salos jo.»

Vërtet. Ajo nuk e përballte dot në vështrim,

vetëm sikur ja përkëdhelte sytë me vështrimin e saj dhe pastaj në ças shikimi i saj zbriste si i trembur e kalonte nëpër plisat e njomë, e gjer në pullat e bardha të aheve.

Më në fund ai kapi valixhen dhe hodhi xhakëtën në sup; ato e përcollën gjer në mes të pyllit dhe u kthyen.

Duke zbritur, Xhakua takoi një karvan, që ngjitej përpjetë. Kali i parë, ngarkuar me bidona qe dirsur, sa një damar i trashë i kërcente anash barkut. Kapistrën e kish të shtrënguar fort në kaptell e zverku i tij ishte kthyer si kokë tevlugu. Pas kuajve, tre katër burra me shkopinj të gjatë. Mbi shpatulla kishin hedhur shkopinj të duart i kishin përdredhur mbi ta. Xhakua u përsëndosh me ta.

— Si duket je nisur më darkëherë nga qyteti.

— Ashtu vërtet. Më mori malli, u bënë kaq muaj.

— Mbarove fare?

— Po, edhe shkollën, edhe praktikën.

Njëri i rrahu shpatullat, tjetri e qëlloi në gjoks me kurrizin e dorës, tjetri e përfshiu për qafë, por kuajt u larguan.

— E po na ndje, na iknë hajvanët, do shihemi përsëri.

— Po shpiem qumësht në baxho.

— Ashtu? Ju lumtë.

Kur të kthehemi do ngarkojmë bereqet.

— Mirupafshim. Rrugën e mbarë.

— Sonte do ta thërë Xhaferi manarin.

Xhakos iu lodhën gjunjët nga tatëpjeta, sikur iu dërmuan.

— Djall o punë, kjo tatëpjetë të mërzit, s'më pëlqen fare. Më mirë të ishte rruga përpjetë, për besë, po. — Iu kujtua një fjalë e urtë: «tatëpjeta për pleq, përpjeta për djem». Fërkoji ballin, se përsëri iu ngjit një pëlhurë marimange.

«Karvani do sjellë bereqet nga qyteti. Kështu ka ndodhur brez pas brezi ndër ne. Ka ndodhur nga padituria.»

Ai hodhi sytë pllajave, çukave, vështroi rrëpirat, livadhet.

«Vend i ashpër, vend për gjë të gjallë. Po te kjo padinë fieri qënka rritur një bojë njeriu. Këtu është vend për thekër. Po sikur ta mbjellim grurë në pranverë? Mundet.»

Xhakos iu kujtua gruri i verës.

«Po sikur të më quajnë mëndjemadh! Midis pleqve do të ketë asish që do më shajnë e mallëkojnë, medoemos. Kam për të dëgjuar shumë, por unë do t'ua mbush mëndjen. E di. Njerëzit e mi janë mësuar të më shohin të vogël, Xhakua i Xhaferit e asgjë më shumë. Sa keq kur rritesh në sytë e tyre e ata s'e dallojnë dot se si u rrite kaq shpejt. Mos të kisha ardhur asnjëherë gjatë këtyre vjetëve, më mirë do të ishte. Pra, duhet që puna ime të më rritë. Po si më foli ai shoku në qytet? «S'është zotësi të ngresh folenë në majën e një lisi, jo. Më mirë shko në vatrën tënde, atje zer vend, puno, nguliti rrënjët thellë në tokën që të njeh e bëhu lis ti vetë. A mund të bëhesh lis? . . . Po, mundesh, sepse në fund të fundit lisi mbin nga një lende fare e vogël.»

Xhakua qëndroi te vidhi çatall, la rrugën e hyri në pyll. Këtu fletët e thata ishin të lagura, të qullura. Një rrjedhë e padukshme humbiste kushedi se ku. Ai e gjeti burimin fshehur nëpër kaçubet. Pikonte ngadalë si një çerkë paguri, sikur lotonte ajo zhubra e kafenjtë e tokës. Heshtje, qetësi. «Pa dale, ç'është kjo shushërimë e hollë sa mezi e kap veshi? As era s'fryn as ujëra s'vërshojnë, po përsëri shushërin...» Xhakua vu buzën në gaz dhe u mbush me frymë. «Është shushurima e lëngut, që lëvrin damarëve të drurëve e fehzave të fletëve». Pastaj dikush filloi të ecë nëpër pyll, dikush i afrohej. Ktheu kryet andej, s'dukej njeri. «Mos ndonjë egërsirë?» Diçka u rrokullis tatëpjetë. Xhakua u ngrit dhe eci andej. U kujtua dhe e gjeti. Një breshkë e vogël tek kalonte drizave, kishte shkarë te një rrëzim i vogël dhe kish-te ngelur më shpinë. «Kështu ngordhin breshkat» — iu kujtua Xhakos. E mori gjënë e gjallë dhe e vendosi mbarë. Iu afrua burimit e ra përmbys mbi të. Vuri pulset e duarve mbi ujin e ftohët. Ashtu ndenji fare pak. Ndjeu zemrën t'i rrahë fort pas tokës, por uji i ftohët ja mpiu mollëzat e duarve, ashtu uli fytyrën mbi ujë e vu buzët mbi të. Si nëpër mugëtirë shihte sytë e vet e qerpikët tek rrihnin ëmbël e ngadalë nga kënaqësia e gllënkave.

Tashti u vu në rrugë përsëri, i vendosur të mos qëndrojë më. Pasi kapërxeu Përruan e Madh, i doli përpara fshati i vet.

«Përse vallë stërgjyshërit tanë e ngritën këtë katund këtu majë shkrepave?» mendoi Xhako Xhaferi. U mundua t'u japë të drejtë pleqve, duke



shkuar ndër mend pushtimet e huaja, ndjekjet, luftrat. Nën rrëpirën e një pllaje ishte fshati. Ishte përhapur atje në formën e një pëllëmbë, që dukej sikur kishte ngulur gishtat në një tokë të zbardhëlyer prej humbe.

«Ky është djepi im, kjo është Rakita ime, si e përhumur mes pyjeve. Jep bylmet e gjë të gjallë dhe sjell bereqet që nga fushat, kur fieri këtu rritet më nge e gjen shesh të bëjë përshesh».

\* \* \*

Në mbledhjen e fshatit Xhakua ia tha troç kryetarit:

— Unë s'dal përpara njerëzve hypur mbi atë skenën, që kini ngritur atje në sallën e leximit.

— Po qysh atëhere?

— Nga ana e skenës le të rrinë njerëzia, ne, nga ana tjetër.

— Domethënë të vendosemi së prapi.

— Ç'ka të bëjë?

Korieri i fshatit kishte shkuar derë më derë e kishte përsëritur në çdo portë:

— Mbledhje me rëndësi, do flasë djali i Xhaferit. Nga çdo shtëpi të vijë një mashkull dhe një femër, domosdo! Muart vesh?

Xhakos i vinte era e bylmetit dhe e shajakut të dhirtë. Përpara ishin vajzat e gratë, dritareve rrinin djemëria. Këta të gjithë e vështronin në sy. Por nga rrjeshtat e fundit ishin pleqtë, kërrusur mbi kërrabat e tyre, tymosnin duhan dhe shihnin për tokë. Xhakua u nënqeshte të rinjve.

Disa syresh s'kishin vënë brisk në faqe; disa dukesh që ishin vonuar ta bënëin këtë. Edhe Edija e Salos ishte atje afër, por s'e shihte dot në sy.

Xhakua nisi të çpalosë planet e tij, filloi të flasë sa më shtruar e sa më thjeshtë. Kujtoi tokën e pushtuar nga fieri, foli për goricat e mollecinat e pyjeve, që duhet të shartoheshin, kur... një farë psherëtime, si rënkim, erdh e ja prishi terezinë. U gëlltit dhe nguli sytë nga fundi i sallës.

— Xha Resul, unë të kam në vend të gjyshit, Ti përse rënkon ashtu? Folë, trego mendimin tënd dhe unë jam gati të të dëgjoj.

Ai shkundi çibukun pas kërrabës dhe ja pat pa e vështruar në sy:

— Këtu kemi tetë muaj dimër djalo... kemi vend për gjë të gjallë. Bujku këtu s'ka punë. S'jemmi në Devoll, o djali i Xhaferit. Ne s'na duhet agronom, ne na duhet një hajvan doktor e vetëm kaqë, more vesh? Po ti je djalë, ke të drejtë, mere më shtruar, dëgjomë mua.

Xhakua u përcëllua, por nuk u dha. Desh t'i përgjigjej, kur dikush u ngrit nga rreshtat e djemve.

— Mos ja ver veshin, shoku Xhako. Në pleqëri dora ngathet e goja shkathet!

Plaku kafshoi buzën e poshtme me një vrull prej djali dhe çibuku i shkau nga dora. Një shoku i tij u kërrus e ja mori, diç i pëshpëriti dhe megjithse nuk u dëgjua, Xhakua e mori me mend. Moshatarët e tij i jepnin hak Resultit. Ai e dinte, bile kishte qënë i sigurtë se pleqtë do ta kundërshtonin. Por për një gjë ai s'ishte i sigurtë. Rinia vallë a përuken para pleqve?

Për dyshimin që kishte ai sapo dëgjoi një përgjigje. Prandaj mori zemër e filloi të flasë përsëri. Kujtoi plehun e pyjeve, kërkoi që kopetë të flenë ugareve, dha sigurime për tokën që «sa më shumë t'i biesh, aq më shumë lëshon», për qilizma.

Xha Resuli, kur dëgjoi fjalën e fundit sikur nënqeshi dhe Xhakua vendosi të matet me të aty për aty:

— Mos u druaj, xha Resul, ai djali s'bëri mirë që ta preu më kaq. Folë, unë do të të dëgjoj. Ta thashë, të kam në vend të gjyshit, më mirë sahanet pa kapak!

Plaku u ra mustaqeve me kurrizin e dorës, një herë këtej, një herë andej, po kryet nuk e ngriti. Filloi të flasë duke vështruar jo më për tokë, por diku në shpinë të një djali:

— Këto që thua ti, mor bir, më duken si oshmare me ujë. Këtu ndër ne, në të shpëtoftë fara nga dimri, të vërvitet breshëri e të gërryen. Pse, si thua ti? A s'kemi provuar ne? Kemi provuar, biro, por gjë s'kemi marrë. Toka është fukara, e gërryejnë shirat e rrëketë.

Xhakua tashi e mori veten më mirë, ai u përgjegj më i çlirët, më i kujdesur, fjalët i zgjidhte një për një. «Edhe jetesën do ta bëjmë më të mirë, bukën do ta korrin këtu në tokën tonë, kur të kthehen karvanet nga qyteti të mos sjellin më bukë, por të sjellin... orendi, mastrafe, si i quan xha Resuli. Mos flemë për tokë, se i shkurtojmë vjetet e jetës sonë».

Por xha Resuli tashti e ngriti kryet mirë, tashti iu duk Xhakua më i rritur, iu bë se, me të

mund të matej pa u turpëruar në sy të shokëve:

— Ti, o djalo, thua që njerëzia këtu t'i lënë vjetët e jetës në qilizmë. Pastaj thua që mos flemë për tokë. Ti nuk e di se toka na lind e toka na mer? Ja, fjala vjen, pulat nuk flejnë për tokë, por flejnë më të lartër, trarëve, e mirë po... kur u bje kolera pulave i rrëmben tufa-tufa...

Njerëzia nisën të qeshin. Edhe Xhakua vetë nuk u mbajt dot, kurse Nurçe kryetari vuri një dosje përpara fytyrës e qeshte prapa saj. Një djalë i rritur, me vështrim të rreptë, u ngrit lulëkuq në fytyrë. Ai nuk qeshte:

— Këtu s'ka gjë për të zbardhur dhëmbët; ua them unë juve. E ç'prisni nga xha Resuli? Ai hyri shul e doli lloz nga kjo dynja. Ai është tamam anadollak. Xha Resuli është si tersi i Pojanit; po të thuash, po, ai domosdo do përgjigjet jo. Provoni të thoni s'duhet bërë kjo e s'duhet bërë ajo dhe ai do përgjigjet të kundërtën. Ne, or shokë e shoqe, shkojmë përpara, si puna e karvanit...

Nurçja e vuri përsëri dosjen para fytyrës dhe i pëshpëriti Xhakos:

— E kemi bandill këtë sekretarin, hë, ç'ja theu hundët paq!

Xhakua çeli krahët anash si shenjë se do t'i fliste akoma. Ai tha disa fjalë, që i dhanë zjarr gjithë mbledhjes. Duke folur, ai hodhi sytë nga dritarja e tregoi me dorë meranë aty afër.

— Më duket e çuditshme kur toka jonë më e mirë rri djerrë këtu, në mes të fshatit, e përse? Për një mendim të mykur, për një mbeturinë në mëndjet e disa pleqve. Do t'i futim damalugun,

ta kthejmë, ta punojmë. Është mëkatë, gati një hektar tokë...

Por këtu Xha Resuli s'mundi të mbahej. Këceu nga vendi, ngriti lart dorën bashkë me çibukun:

— Mos shko aqe tutje, e ta dish, po ngrihem vetëm unë, po s'jam vetëm unë... vakëfi është vakëf, mos! Hap sytë, se do t'i kallësh zjarrin gjithë fshatit. Këtë tokë e kemi ruajtur brez pas brezi si vend të shenjtë, ti...

— Joo Resul, jo, zjarrin nuk ja kallim fshatit. Ajo që do t'i kallim fshatit është një sasi më e madhe buke, mos ki merak as ti, as...

Si ta kishin bërë me fjalë u ngritën edhe të tjerë, bile disa nuk ishin pleq, por e mbronin mendimin e Resultit. Xhakua ishte i zënë duke u dhënë përgjigje, duke u munduar t'i shtrojë, t'i bindë dhe nuk vinte re se salla ca nga ca po zbrazej. Agronomi vështronte kundërshtarët, që flisnin me zjarr, që kërcënonin në emër të meleqëve, që tundnin duar e këmbë, që përplasnin grushtet mbi banka; kur... dikush, që hyri brenda, u kërrus te xha Resuli dhe diç i pëshpëriti në vesh. Plaku këceu sikur ta kish kafshuar gjarpëri.

— Obobo! E prishmë fshatin me dorën tonë, obobo!!!

Xhakua s'po kuptonte gjë. Njerëzia u lëshuan të dalin përjashta, disa nëpër derë, të tjerë hidheshin që nga dritaret, të moshuarit mallëkonin, disa çuna qeshnin, dikush lëshoi një fishkëllimë të fortë.

— Ç'po bëhet, o Nurçe? — pyeti Xhakua.

— Ç'po bëhet? A nuk shikon?

Që nga dritarja dukej toka e gjërë e merasë dhe nëpër atë lëndinë. ku mërzenin ditë e për ditë manaret dhe kuajt e sëmurë, nëpër atë tokë ishin lëshuar nja pesëdhjetë vajza e djem dhe po e çanin. Kazmat ngriheshin lart, qëllonin me duf e ngriheshin përsëri. Plisa të mëdhenj ktheheshin përmbys, duke treguar kështu një tokë të zezë e të shkrifur, një tokë të trashë, që lëshonte një erë bari e plehu, si ajo e pyllit. Ajo tokë po shihte dritën e diellit për herë të parë. Meraja oshëtinte nga thirrjet:

— Bjeri Liçooo!

— Bjeri më fort, o t'u thaftë dora!

— More, ç'tokë e zezë, tokë për thekër!

Khakua rendi andej, u fut midis tyre, rrëmbeu një kazmë edhe ai. Në një rast, ai e gjeti të nevojshme të ndërhyjë:

— E ke gabim Zake, këtu s'bën të mbillet thekra, sepse ajo do rritet aq shumë, sa do bjerë, e do shtrihet për tokë. Vitet e para këtu do mbjellim misër me fasule, ujin për vaditje e kemi, më vonë mund ta mbjellim grurë.

Grupi i kundërshtarëve, me Resulin në krye, ishte aty, me vetullat të unjura, gjithë mëri e inat.

— Ja, tashti do na ngopë me bukë, sytë do na zërë zoti, sytë!

— Prisni ndonjë tërmet, a ndonjë zjarr!

— Prisni kur të na përmbysë ndonjë rreke!

— Sëmundje do na lëshojë Ay që lart!

Po Resulti nuk i rrihej në vend. Përsëri iu qas Xhakos:

— Ja ku po ta them sot. Do ta pësojmë! Po

ç'taksirat ne, sikur s'ke pllaja e lëndina përpjetë malit! Hapnje andej sa të deshe, njeri s'të thoshte gjysmë fjale.

— Edhe andej do hapim xha Resul, por ky ishte fillimi!

Djali u lëshua pas punës dhe nuk ja zgjati. Dikush bërtiti:

— Bjerini, o burra, se sonte kemi mbrëmje-vallëzimi!

Duke ikur Resuli lëshoi një: «... po... atje e kini mëndjen juve».

Nata i gjeti të rinjtë duke rrëmihur tokën e merasë. Xhakua i ndaloi dhe kërkoi që të mbli-dheshin përsëri të nesërmen. Por ata nuk largo-heshin. — Kemi mbrëmje tashti! — Po mirë, shkoi-më hamë bukë një herë e pastaj kthehem. — Jo, jo, hamë bukë një herë e mirë.

Dhe sa të vinte Hyska me fisarmonikën, Xhakua hyri në bisedë me të rinjtë:

— Ky ishte fillimi, vërsulja jonë e parë për tokën dhe për bukën. Vërsulja e dytë është te plehu. Kafshët, që i lëshojmë gjithë ditën poshtë e lart (e kam fjalën për ato të samarit), do t'i përdorim çdo ditë për të sjellë plehë pylli në-për arat. Vërsulja jonë e tretë është te ugaret. Do ta vendosim të shkojmë me radhë, natën, në-për ugaret, ku do flejnë kopetë e deleve. Ky është aksioni ynë, i rinisë...

Prapra derës së vatrës së kulturës u mblodh një kup i tërë me kazma. U ndezën dy llamba vajguri, që u varën në mure, fisarmonika ja filloi dhe rinia u ngrit.

Xhakua s'desh të fillojë i pari. Edija e Sa-

los ishte aty afër, ajo e vështroi disa herë me bisht të syrit, por ai u shti sikur s'e vu re. Një djalosh që mbeti pa damë erdhi u rrotullua afër Xhakos. Ky e afroi, i bëri vend, i foli: — E sheh sa e dobët drita e llambave? Ne me këtë rini që kemi, me këta njerëz punëtorë e zemërbardhë edhe një central për drita elektrike do ta bëjmë. Po, po, do ta bëjmë.

\* \* \*

Nuk kaluan shumë ditë, kur një natë, Xhako Xhaferi u nis për në arat e pyllit. Qeni i shtëpisë e ndoqi pas një copë herë, por ai e ktheu prapa. Murrua hungronte, dridhej e përdridhej, ulej pas tokës e s'desh të bindej, por Xhakua mendoi se Murrua mund të mbërthehej me qentë e grigjave e «hajt dhe e merr vesh».

— Tyt Murro, ktheu, tyt!

I vetëm, me një shkop në dorë ai kalonte korieve, duke shkelur karthjet e drizat. Këto thyeheshin në çast e çapet e djalit fundosnin butë nëpër fletët e thata. Ecte dhe mendohej, pëlhura marimange i plekseshin në ballë dhe ai shkonte dorën mbi fytyrë. Diku përpoqi kryet pas një minjolle. Lart, që nga tehu i malit po delte hëna e madhe sa një lëmë dhe e kuqe flakë. Tashti ai ecte nëpër një shteg të ngushtë. Mbi krye degët e kumbullave formonin një farë kubeje. Këtu qielli s'dukej fare, as hëna. Ish terr i plotë dhe veç ndonjë yll xixëllonte një çast, gjersa më tutje regëtinte një tjetër.

«Kumbullat e egra; prej këtyre ka dalë e del gjithnjë rakia e dasmave, e sherreve, e dolive.»



Ai ngriti krahun pas kumbullave. Duke ecur, ndihej trokëllima e shkopyt pas trungjeve, si një rakatake. Që lart u derdhën qentë duke lehur me të madhe; ai u bë gati të mbrohej kur një zë i ashpër djali, zë i fortë e kërcënonjës, bëri që qentë të prapsen gjithë duke lehur, por jo me vrullin e parë. Disa fiçorë fishkëlluan në erë, u rrokullisën disa gurë, një qen angulliti, pastaj zëri i djalit:

— O Xhako! Ngjitu pa frikë, ngjitu! Merua po të pret.

Xhakua nuhati erën e grigjës, dëgjoi blegërimat e deleve dhe pastaj provoi atë ndjenjën e ëmbël, që ke kur hyn në tufë. E gjeti Meron afër zjarrit. Në fillim dalloi veç këmbët e tij, pastaj u duk guna e dhirtë, thika e brezit, kurse fytyrën e kishte në errësirë.

«Po përse ky qëndron kështu? As shtritur, as ndenjtur?»

Xhakua dalloi barkun e hekurt të një këmbore. Ajo ishte e madhe sa një bucelë, e kapur me një kular druri. Kur Xhakua kapërxeu zjarriin shqoi më mirë: Merua kishte përpara një kup me këmborë.

— Ulu te zjarri. Behar, po këtyre anëve tona bën ftohët.

— Ç'po bën kështu?

Por Merua e kishte humbur tragën pas zileve, mezi u përgjegj.

— Hë? Më ndje, çfarë the?

— Pyes çfarë bën.

— Besa-besën, s'e kisha mëndjen. Ja, po provoj këmborët. Janë të reja. Ca kohë më parë,

një hajvan doktor (Merua lëshoi një të sharë që s'shkruhet) bëri emër që t'u hiqen këmborët bagëtime. Urdhëri urdhër. Të më besosh se të flas me dorë në zemër. M'u nxi jeta. E ku është parë kjo? Grigjë e gjë e gjallë pa këmborë! Më dukej tufa si me lugetër e jo me gjë të gjallë. «U prishet gjumi, u prishen nervat, shterojnë qumështin»... Merua përqeshte kështu të panjohurin, që kishte dhënë urdhërin dhe helmi e mllefi i zërit të tij sikur përmbanin masën e dëshpërimit, që kishte kaluar. Xhakua mendonte se sa kujdes duhet të ketë njeriu që t'i zbatojë të dhënat shkencore, në përshtatje me kushtet e vëndit. Ta lësh tufën pa këmborë në këtë vend malësi ta çan edhe ujku!

— Tashti erdhi një urdhër i mbarë. Ja, kryesia vetë na bleu këmborë, pa shih...

Bariu, me një dëshirë e gaz të përgjëruar po lëmonte këmborët, i afronte të veshi, tundte njerën, pastaj tjetrën afër saj. E ndërronte të dytën, merrte të tretën dhe e provonte në zë me të parën. Pastaj e ngriti peshë gjithë grumbullin me këmborë, u ngrit edhe vetë, i tundte, i dëgjonte, mbante gojën çelur sikur të dëgjonte edhe me atë.

— Ja, kështu më ngrohet shpirti, për besë!

Ai lëshoi këmborët dhe mori bucelën të pijë ujë. U përhap një aromë e fortë si prej pishë. Xhakua e mori me mend se bucela ishte sajuar me dru dëllinje. Më tutje u dëgjua një zhurmë e njohur. Djali i bariut po milte delet. Dëgjohej gumëshitja e qumështit tek binte në gavetë. Xhakua u kthye andej. Vinte era e ugarit dhe e gjësë së gjallë. Nënqeshi. Ai vetë kishte dhënë urdhër që kjo grigjë të

vinte këtu, te ara, ku asaj dite vajzat rëmihnin me bel dhe piqnin patate t'ëmbra.

— Hej Xhako, — i foli djali i bariut, — të pëlqen? Era e tufës të jep shëndet e të skuq faqet. Ata që vuajnë nga lëngjyeri. . . këtu gjejnë shërim.

Hëna ishte ngritur lart e shihte që përtej aheve. Përroi poshtë shkiste përmbi gurët e shtratit, përplasej brigjeve me tinë, llokoçiste nëpër gjeratore e kërteçina. Ishte një natë e bukur plot mall e dhëmshuri për djalin e ri, që sapo ishte kthyer në vatrën e vet. Pa dale, se Merua po flet:

— Kam edhe një dert, — foli bariu duke psherëtitur, — ajo këmbora e madhe nuk dëgjohet fort mirë.

— Jo, xha Mero, dëgjohet fare mirë.

— S'është ashtu, i zoti e di ku i pikon shtëpia. Kam gjetur një kobure të vjetër, masatllie, e ka dorezën prej argjendi. Do ta shkrij dorezën dhe gjuhëzat e këmborëve do t'i ngjyjej me argjënd, ashtu kumbojnë më bukur, më ëmbël, e di Merua vetë. . .

Merua e djali deshën ta pinë qumështin pa zjerë, por Xhakua nuk i la. E vunë enën mbi zjarr.

— Ç'është kjo? — pyeti Xhakua i çuditur.

— Mos ki gajle, është e paqme. Gavetën e ruaj për të mjelë. Kjo mbi zjarr është helmetë gjermani. Gjejmë dendur këtyre anëve.

Ata ranë pas bisedës, folën për planet e djalit, për tokat e reja, folën për gjënë e gjallë e për gjithë fshatin, gjersa kuvendi u platit. Por edhe djali i Meros desh diç të thoshte, pa e tepëroi:

— Mirë, o Xhakua i Xhaferit, boll na fole, po nuk më thua, ndonjë syzezë nuk e gjete atij qyteti?!

Merua hungroi dhe ngriti dorën:

— Tyt, or ti laro! ç'të duhet ty ajo punë? Ja, ja, ja! Ç'ke ti? Do dru? Pa shiko! Oj ky!... — Dhe pas një pushimi të shkurtër, kur Xhakua qeshte dhe i lutej Meros të mos e shajë djalin, Merua tundte kryet dhe ja shkrepri:

— Dukme pasur zoga në shtëpi, e pse të blejmë mish në pazar?

Ata do të qeshnin akoma, kur helmata mbi zjarr e gufoi lart qumështin, shkuma ra mbi zjarr dhe kundërmoi era e bylmetit të djegur.

Nata po kalonte, kur Merua i dha Xhakos gunën e vet.

— Merre pa frikë biro, e kam «të kripur».

Djali u mbështuall me të, por gjumi nuk e merrte. I dukej sikur që larg vinte një zhurmë e çuditshme.

— Mero!

— Folë Xhako, të dëgjoj.

— Më duket sikur larg, diçka buçet.

— Po. E drejtë, matanë malit tonë është një motor, ngulin turjela në tokë, kërkojnë hekur, a ku di unë... Do largohem ca, do kthehem shpejt. Po lehin qentë si për ujk, do vete t'u ve xipat qenve.

Në dritën e mugët të zjarrit Xhakua pa kularët e hekurt me xipa, që Merua mbante nër duar.

— Na, Balo, na! Na, Murxho, na!

Dhe Merua u zhduk nëpër errësirën e natës dhe këmborët e ziles tringëllinin të shqetësuar. Qentë lehnin me të madhe, djali i Meros po i fuste pushkës fishekun në gushë.

— Hë, Xhako, ti nuk m'u zemërove, se ba-  
bai...

— Nuk zemërohem unë, jo, mos ki merak. Të kam shok, pa çka se ti je ca më i vogël. Domosdo, ne të dy edhe për vajza do flasim, apo jo?

Sytë e djalit xixëllonin në errësirë. Larg, në errësirën e natës zhurma e sondës bëhej më e fortë, më e mprehtë, pastaj zëri i saj zbutej. Xhakua e merrte me mënd: turjelave u hidhnin glinë të bardhë e të butë.

«Ja, ata atje tutje, veshur me xhupa të ngjyera me naftë, punojnë dhe natën, gërmojnë thellë në- për llagëmet e tokës. Edhe ata janë djem me familje e me shkollë, edhe ata janë djem të atdheut e të shkencës, duan t'i shkëputin pasuritë nëntokës. Ka të tjerë që rendin deteve e oqea- neve. Unë këtu kam të bëj me tokën, me koren e tokës, me bukën e njerëzve, me gëzimin e tyre.»

Tashti Merua ishte kthyer, po s'kishte ndër mënd të flerë. Përsëri mori fyellin. Kuptohej se ai kishte një brengë. Dësh të provojë edhe një herë si shkon vallë kënga e fyellit me tringëllimat e këmborëve! Tingujt e gëzuar e rrëmbyen përsëri. Xhako Xhaferin, e përkëdhelën, e nanurisën, e ngritën peshë. Sytë e tij venin e vinin nëpër qie- llin e pafund, mbushur plot me yje, pastaj e mori gjumi. Dhe në gjumë iu bë një ëndër e çu- ditshme, iu bë sikur në pyllin aty pranë Naimi me Çajupin, me feste të bardha në krye, ja kishin marrë shqiptarçe e këndonin «me të thënë e me të prerë», për blegërimat e grigjave, për tringëlli- mat e këmborëve, për shtrungat e staneve dhe për kullotat me bar të njomë.

TRYEZA E LENDES

	Faqe
Legjenda e ujit .....	5
Nënkryetar Nexhipi .....	15
Kur merrnim fluturim .....	40
Shtëpia e Sherifit në majë të gërshit .....	54
Mulliri i trimave .....	75
Kur hynte drapëri nër ara .....	82
Intervistë me një turist .....	107
Larasqina .....	118
Te shkronja K e alfabetit .....	136
Shtërgjet .....	154
Para burimit, kundrejt fshatit .....	175
Pendim .....	189
Kam të bëj me tokën, me bukën e njerëzve .....	191

42022

IBRILITEKA E SHITEK  
GJURKARIEP

150,000